



## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

**Raport përfundimtar mbi auditimin e ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE, BB dhe Donatorëve të tjerë**

# **RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI**

**“MBI AUDITIMIN E PËRPUTHSHMËRISË NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË  
FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E BE, BB DHE  
DONATORËVE TË TJERË”**

**Tiranë, shkurt 2025**

<b>NR.</b>	<b>PËRMBAJTJA</b>	<b>FAQE</b>
<b>I</b>	<b>PËRMbledhja Ekzekutive</b>	<b>3-10</b>
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	5-11
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	11-13
<b>II</b>	<b>HYRJA</b>	<b>13-18</b>
1.	Objektivat dhe qëllimi	13-14
2.	Identifikimi i çështjes	14
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	14
4.	Përgjegjësitë e audituesve	14-15
5.	Kriteret e vlerësimit	15-16
6.	Standardet e auditimit	16
7.	Metodat e auditimit	16-17
8.	Dokumentimi i auditimit	17
<b>III</b>	<b>PËRSHKRIMI I AUDITIMIT</b>	<b>18-91</b>
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin.	18-20
2.	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.	20-78
2.1	1. Vlerësim mbi përputhshmërinë e aktivitetit të Drejtorisë së Zbatimit të projekteve të BB dhe Donatorëve të tjerë: - Mbi përputhshmërinë e kryerjes së planifikimit të prokurimit, zbatimi i procedurave të tenderimit, vlerësimi i ofertave si dhe kontraktimi final; - Monitorimi i zbatimit të kontratës, kryerja e pagesave dhe menaxhimi financiar të projekteve të BB dhe donatorëve të tjerë; - Vlerësim mbi raportin e progresit të zbatimit të projekteve për efekt të raportimit dhe konsolidimit të treguesve fiskal.	20-34
2.2	2. Vlerësim mbi përputhshmërinë e aktivitetit të Drejtorisë së Menaxhimit të Prokurimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së: - Mbi përputhshmërinë e kryerjes së planifikimit të prokurimit, tenderimit, vlerësimit të ofertave si dhe kontraktimi final; - Monitorimi i kontratës, administrimi, pagesat në bazë të kontratës dhe kontabilizimi i tyre; - Procedurat e raportimit pranë FK për kërkesë për fonde, planifikim i fluksit të parasë, dhe menaxhimi i llogarive bankare; - Monitorimi dhe kontrolli i ecurisë së kontratave, auditime dhe trajnime të kryera; - Vlerësim mbi raportin e progresit të zbatimit të projekteve për efekt të raportimit dhe konsolidimit të treguesve fiskal.	34-78
<b>IV</b>	<b>REKOMANDIME</b>	<b>78-92</b>

## **I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

### **a. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin**

Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE, Bankës Botërore dhe Donatorëve të tjerë (në vijim CFCU), është krijuar me VKM nr.596, datë 05.09.2007 “Për Ngritjen e Strukturave dhe Përcaktimin e Autoriteteve e të Përgjegjësive për Zbatimin e Instrumentit të Parazgjerimit”, si strukturë brenda Ministrisë së Financave. Në vitin 2018, me VKM nr.299, datë 23.05.2018 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Financimeve dhe Kontratave për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorë të tjerë”, CFCU ka ndryshuar nga Drejtori e Përgjithshme në Ministrinë e Financave në Drejtori e Përgjithshme në varësi të Ministrisë së Financave me një numër prej 34 punonjësish.

Organizimi i brendshëm i saj është miratuar sipas Urdhrit nr.88, datë 13.06.2018 të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve dhe Fondet e BE- së, BB-së dhe Donatorëve të tjerë” për periudhën deri më 26.08.2022. Marrëdhëniet e punës së punonjësve rregullohen në bazë të dispozitave të legjislacionit për nëpunësin civil.

Në vitin 2020, me Urdhër të Kryeministrit nr.21, datë 03.02.2020 CFCU ristrukturohet dhe totali i pozicioneve të punës shkon në 35 vende. Ky Urdhër pasohet me Urdhrin nr.46 datë 05.03.2020 “Për një ndryshim në Urdhrin nr.21 datë 03.02.2020” ku shkurohet pozicioni “përgjegjës sektori” dhe shtohet një pozicion “specialist” por numri total i punonjësve nuk ndryshon.

Me Urdhër nr.142, datë 26.08.2022 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve dhe Fondet e BE- së, BB-së dhe Donatorëve të tjerë” i ndryshuar me Urdhër nr.166 datë 04.10.2022 përcaktohen rolet dhe përgjegjësitë e sektorëve/drejtorive të ndryshme në Drejtorinë e Përgjithshme të Financimit dhe Kontraktimit të BE-së, BB dhe fonde të tjera të donatorëve, ristrukturohet CFCU dhe totali i pozicioneve të punës shkon në 36.

Për periudhën nga 04.10.2022 e në vijim struktura është rregulluar me Urdhër nr.59 datë 18.04.2024. Urdhër i cili ka ndryshuar numrin e punonjësve në 48 punonjës në total. Ky ndryshim ka ardhur si pasojë e kërkesës datë 30.01.2024 me shkresën nr.83 prot. ku CFCU i drejtohet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë duke iniciuar një propozim dhe argumentim për disa ndryshime në strukturën organizative të institucionit. Sipas këtij propozimi, kërkohet që numri total i punonjësve për vitin 2024 të arrijë në 48 veta nga të cilët 38 të dedikuar për projektet e financuara nga IPA ndërkohë që numri i punonjësve për menaxhimin e projekteve të financuara nga BB dhe donatorë të tjerë të jetë 10.

Misioni i kësaj Drejtorie është të sigurojë një menaxhim efektiv administrativ, financiar dhe teknik të projekteve të miratuara, në përputhje me Marrëveshjet Financiare me Komisionin Evropian e donatorë të tjerë. Funksionet kryesore të saj janë:

1. Tenderimin e fondeve.
2. Ndjekjen e procedurave të Vlerësimit dhe Kontraktimit.
3. Monitorimin mbi zbatimin e kontratave.
4. Kryerjen e Pagesave.
5. Siguron zbatimin korrekt të rregullave të menaxhimit financiar të kontratave.
6. Kryen Kontrollin e Nivelit të Parë të shpenzimeve të deklaruara nga Projekt-partnerët shqiptarë përfitues të Programeve të Bashkëpunimit Rajonal.

7. Raportimin periodik të riskut dhe parregullsive në DFK dhe strukturat IPA në ministrinë e linjës.
8. Siguron kontrollin e funksionimit e sistemit të menaxhimit dhe kontrollit në Drejtorinë e Financimeve dhe Kontraktiveve (DFK) dhe në strukturat IPA në ministrinë e linjës.
9. Siguron cilësinë e dokumentacionit të procedurave të prokurimit, nëpërmjet zbatimit të parimit të “katër syve”.
10. Kryen funksionin e Zyrtarit Autorizues të Programit, nëpërmjet Drejtorit të saj.

#### **b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij**

Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontratave për Fondet e BE-së, BB-së dhe donatorë të tjerë ka si mision të sigurojë një menaxhim efektiv administrativ, financiar dhe teknik të projekteve të miratuara, në përputhje me Marrëveshjet Financiare me Komisionin Evropian e donatorë të tjerë. Në mbështetje të planit vjetor të vitit 2023, miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, është kryer auditimi i këtij institucioni duke kontribuar kështu në realizimin e vizionit të KLSH-së për rritjen e përgjegjshmërisë, transparencës, dhe përmirësimin e shërbimeve publike.

#### **c. Qëllimi i auditimit**

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme e Financimeve dhe Kontratave për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorë të tjerë, për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2021 deri më 30.06.2024, nëpërmjet evidentimit të devijimeve nga standardet e pranuar, të shkeljeve të parimeve e të ligjshmërisë, të menaxhimit financiar, me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga ana e subjektit të audituar.

Nëpërmjet kryerjes së këtij auditimi KLSH synon të promovojë:

- Transparencën, duke ofruar raport të besueshëm për fondet nëse janë mbledhur dhe administruar sipas një procesi të rregullt dhe është respektuar kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi.
- Përgjegjshmërinë ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor e rregullator, në mënyrë që të mund të merren veprime korrigjuese dhe personat përkatës të përgjigjen për veprimet e tyre.
- Qeverisjen e mirë, duke identifikuar dobësitë dhe duke vlerësuar rregullshmërinë aty ku kuadri ligjor rregullator rezulton i pamjaftueshëm dhe/ose i papërshtatshëm, si dhe duke marrë parasysh riskun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë.

Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësimin me synim marrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga subjekti i audituar.

Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

1. Vlerësim mbi përputhshmërinë e aktivitetit të Drejtorisë së Zbatimit të projekteve të BB dhe Donatorëve të tjerë:

- Mbi përputhshmërinë e kryerjes së planifikimit të prokurimit, zbatimi i procedurave të tenderimit, vlerësimi i ofertave si dhe kontraktimi final;
- Monitorimi i zbatimit të kontratës, kryerja e pagesave dhe menaxhimi financiar të projekteve të BB dhe donatorëve të tjerë;
- Vlerësim mbi raportin e progresit të zbatimit të projekteve për efekt të raportimit dhe konsolidimit të treguesve fiskal.

2. Vlerësim mbi përputhshmërinë e aktivitetit të Drejtorisë së Menaxhimit të Prokurimeve dhe Kontraktiveve për Fondet e BE-së:

- Mbi përputhshmërinë e kryerjes së planifikimit të prokurimit, tenderimit, vlerësimit të ofertave si dhe kontraktimi final;
- Monitorimi i kontratës, administrimi, pagesat në bazë të kontratës dhe kontabilizimi i tyre;
- Procedurat e raportimit pranë FK për kërkesë për fonde, planifikim i fluksit të parasë, dhe menaxhimi i llogarive bankare;
- Monitorimi dhe kontrolli i ecurisë së kontratave, auditime dhe trajnime të kryera;
- Vlerësim mbi raportin e progresit të zbatimit të projekteve për efekt të raportimit dhe konsolidimit të treguesve fiskal.

#### **d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes së të dhënave**

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku. Metodatat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit, në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testimeve të kryera, me qëllim arritjen e objektivave të auditimit në bazë të vlerësimit të riskut.

Në këtë auditim janë përzgjedhur metoda, metodologji apo teknika auditimi dhe shtrirje të procedurave të auditimit, për të dhënë siguri të arsyeshme për arritjen e konkluzioneve të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodatat dhe teknikat e mëposhtme:

- Intervistimi - duke komunikuar dhe marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse;
- Raporte dhe informacione - shfrytëzimi i raporteve, informacioneve relevante dhe që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht me drejtimit e auditimit;
- Teknikat me ndihmën e kompjuterit - për procedura të programuara, për të bërë testimet ose për nxjerrjen të dhënave për testim të mëtejshëm;
- Verifikime transaksionesh – me përzgjedhje të çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;
- Të kombinuara, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti.

#### **e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve**

Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën objekt auditimi paraqet problematika dhe mangësi në disa drejtime të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 26 gjetje dhe rekomandime, nga të cilat 22 masa organizative dhe 4 masa për masa për eliminimin e paligjshmërive në administrimin e fondeve publike dhe menaxhimin me ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet të fondeve publike.

#### **f. Paraqitja e gjetjeve kryesore**

- Nga auditimi konstatohet se në kontratat e projekteve të BB në objektivat e parashikuara janë reduktuar objektiva, pa u argumentuar nga përfituesi. Nga ana e strukturave përgjegjëse të CFCU nuk rezulton të jetë identifikuar, raportuar apo të jenë marrë masat lidhur me këto mangësi të konstatuara gjatë kësaj kontrate.

- Nga grupi i auditimit konstatohet se materialet dhe detyrat të cilat konsulentët duhet të përgatisin dhe të implementojnë kërkohen të jenë vetëm në gjuhën angleze, në kundërshtim me VKLA Nr.4, datë 19.6.2017.

- Nga grupi i auditimit konstatohet se në disa projekte të BB nuk dokumentohet listëprezenca e pjesëmarrësve më nënshkrimin përkatës.

- Nga auditimi është konstatuar se pavarësisht se projekti i “Zhvillimit të kontabilitetit në Sektorin Publik”, ku përfitues është Ministria e Financave dhe Ekonomisë, i cili ka filluar procedurën e prokurimit në 17.05.2018, është parashikuar të përfundojë në 30.06.2020, por është shtyrë me amendamentin nr.615, datë 20.10.2021 dhe ka përfunduar në dhjetor 2022, për të cilin janë lidhur gjithsej 5 kontrata ku implementimi i tyre ka përfunduar brenda vitit 2022, përgjatë fazës së auditimit në terren (dhjetor 2024), **rezulton se ende nuk ka një produkt final për implementim dhe zbatimin në praktik të Standarteve të Kontabilitetit në Sektorin Publik.** Nga ana e strukturave përgjegjëse të CFCU nuk rezultojnë të jenë identifikuar parregullsitë për mungesën e realizimit të produkteve të pritura, apo të jenë adresuar dhe eliminuar pengesat që ka ndikuar në dështimin e implementimit të Standartit të Kontabilitetit në Sektorin Publik.

- Nga auditimi i strukturës organizative të CFCU rezulton se, Drejtoria e Menaxhimit të Prokurimeve dhe Kontraktiveve për fondet e BE-së operon me 14 punonjës më pak dhe Drejtoria për Zbatimin e Projekteve të Bankës Botërore dhe të Donatorëve të tjerë me 1 punonjës më pak.

- Nga auditimi i dosjeve të projekteve nën fondet IPA, konstatohen mungesa në dosjet e procedurave të dokumentacioneve të stafit të përzgjedhur si pjesëmarrës, qoftë në grupet për përgatitjen e dokumentacionit, ashtu si dhe në Komisionin Përzgjedhës sa i takon jetëshkrimeve (CV) që duhet të dorëzohen.

- Nga auditimi i dosjeve fizike të projekteve të përzgjedhura nën programet IPA dhe atyre të BB dhe donatorëve të tjerë u konstatua se në tërësi këto dosje mbartnin parregullsi në mënyrën e mbajtjes së tyre, si dhe mungonte fleta e inventarit për çdo dosje respektive.

- Në 1 (një) nga projektet e përzgjedhura për tu audituar, konkretisht në kontratën e binjakëzimit “Mbështetje për Institucionin e Avokatit të Popullit dhe promovimi i të drejtave të njeriut në Shqipëri” rezultoi se, në raportin narrativ final komponenti “numri i nëpunësit civil të trajnuar si trajnerë” nuk është realizuar. Ky mosrealizim objektiv, nuk është shoqëruar me zbritjen e ditëve të punës respektive të dedikuara për të dhe rrjedhimisht nuk është pasqyruar në raport.

-Në kontratën e tipit grant “Fuqizimi i organizatave të mbrojtjes së konsumatorit në Shqipëri” vihen re mungesa të theksuara të cilat janë dhe në formën e përfshirjeve të shkresave që vërtetojnë kryerjen e aktiviteteve të cilat nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me projektin si p.sh.: Course II “Potential and challenge of integration in a troubled Europe”: Eu enlargement and regional cooperation in Western Balkan.

Course III “Albania and the trends of European Integration” : Covid 19-s impact on the Welfare state and EU enlargement and regional cooperation in WB.

- Në 1 (një) nga projektet e përzgjedhura për tu audituar, konkretisht në kontratën e binjakëzimit “Mbështetje për Administratën Doganore Shqiptare në lidhje me zbatimin e kodeve doganore europiane dhe rritjen e kapaciteteve operationale në fushën e mallrave të falsifikuara” konstatohet se duke krahasuar kontratën me raportet e ndërmjetme dhe raportet finale, ndërthurur me Planet Roll Up 1 dhe 2, janë evidentuar aktivitete të cilat nuk janë të paraqitura në raportin final apo të mbuluara me ditë ekspert. Gjithashtu, nga krahasimi i ditë ekspert sipas kontratës dhe ditë ekspert sipas raporteve, vihet re angazhim me më shumë ditë për aktivitete të caktuara dhe angazhim më i ulët në të tjera, sipas parashikimit në kontratë, referuar edhe Planeve Roll Up 1 dhe 2. Për më tepër, konstatohet se angazhimi i ndryshëm nga kushtet e kontratës nuk është përkthyer në ndryshim të

objektivave apo komponentëve të aktiviteteve, pavarësisht se ka aktivitete që nuk janë mbuluar me ditë angazhimi sipas progres raporteve, përpos 6 Side Letters përmes së cilave është rialokuar buxhetin ndërmjet zërave, si aktiviteti 1.1.1 dhe aktiviteti 2.4. Për këtë kontratë ka patur 6 side letters për rialokime buxhetore brenda zërave të buxhetit në vlerë totale 33,599.33 EUR ose 8.93% të vlerës totale të kontratës. Këto ndryshime nuk janë evidentuar nga CFCU përgjatë monitorimit të implementimit të kontratës së binjakëzimit, apo nga monitorimi i pagesave financiare.

-Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me kontrollin “on the spot”, u konstatuan mangësi në realizimin e tyre sipas planifikimit dhe ky proces nuk është ezauruar në konceptin e plotë dhe shterues të tij përgjatë periudhës objekt auditimi. Plotësimi i check-listave në rastet kur nuk ka kontroll në terren, por takim në zyrë, nuk përfshin në mënyrë të plotë dhe shteruese kontrollin në të gjithë konceptin e tij.

-Nga auditimi u konstatua se, sa i takon miratimit të raporteve narrative, në rastet e granteve të përzgjedhura për tu audituar, miratimi nga njësia IPA (MEPJ) i raportit përfundimtar narrative, nuk shoqërohet bashkangjitur shkresës përcjellëse, duke operuar kështu jo në përputhje me nenin 7, pika d të Marrëveshjes Operacionale IPA II midis NIPAC, Njesisë IPA dhe CFCU.

- Nga auditimi konstatohet se për shkak të vonesave në procedurat e aprovimit të raporteve finale narrative periudha për të cilën ishte planifikuar pagesa shtyhet për vitin e ardhshëm, duke sjellë si pasojë thyerje e afateve të pagesave kontraktuale (për shkak të ndryshimit në kohën e miratimit të raporteve narrative) krahasuar me kushtet/afatet kohore të paracaktuara në kontratë; djegie të fondet të TVSH-së për vitin sipas së cilit janë buxhetuar, kjo pasi, në rastet kur këto pagesa nuk realizohen sipas planifikimit të duhur, digjen fondet (të planifikuara në nivele më të larta krahasuar me faktin), duke krijuar kështu bllokimin e fondeve të cilat mund të ishin përdorur për pagesa apo investime të tjera.

- Nga auditimi mbi pagesat e kryera (parafinancim dhe financim final) rezulton se, në 5 (pesë) nga 10 (dhjetë) rastet e përzgjedhura (të cilat kishin përfunduar pagesat në të dy fazat), vlera e kërkuar për pagesë finale nga ana e përfituesit ishte më e vogël se sa ajo e parashikuar në kontratë. Në asnjë rast nuk rezultonte prania e një analize apo argumentimi të identifikimit të shkaqeve të kërimit të këtyre vlerave më të ulta. Nga ana e sektorit për monitorimin e kontratave, nuk rezulton të jetë kryer një analizë / apo vlerësim mbi impaktin në outputin final, se si është arritur ai (nëse është cënuar apo jo) në zbatim dhe reflektim të ndryshimeve të ndodhura krahasuar me zërat e parashikuar. Përthithja më pak nga kontraktimi (vlera e parashikuar në kontratë) mbart në vetvete riskun e mos kryerjes së plotë të aktiviteteve sikundër parashikuar.

- Në 1 (një) rast nga 10 (dhjetë) rastet e përzgjedhura për tu audituar rezultoi se, nga ana e CFCU-së është miratuar përdorimi i fondit të kontigjencës, fond i cili është përdorur për të mbuluar kostot shtesë të fluturimit të RTA drejt vendit përfitues, në kundërshtim me Twinning Manual, paragrafi 6.2.10 dhe 6.1.2 dhe 2.4

- Nga auditimi mbi pagesën e kryer për efekt të projektit AI/IPA2017/06 (CSO si avokat për implementimin e legjislacionit mjedisor horizontal në nivel lokal-Vlorë, me institucion përfitues ICLA), në 9 (nëntë) raste në zëra përbërës të buxhetit u konstatua tejkalim i vlerës krahasuar buxhetit fillestar, në total vlera e validuar është më e vogël se vlera e parashikuar në buxhet. Në vijim të konstatimit, nga ana e përfituesit nuk rezulton të jetë argumentuar nevoja për rialokim në moszbatim me pikën 2.1.5 të Manualit PRAG. Referuar raportit financiar, rezulton se linja buxhetore 5.7.5.2 e cila lidhej me aktivitetin 3.2.2 ka rezultuar me kursim në nivelin 83.3% apo në terma absolute 1,000 Euro kjo për shkak se aktiviteti nuk është kryhej nga personi i kontraktuar por grupi punës. Nga ana e CFCU është kryer pagesa e ekspertit për 7 ditë pune, megjithëse largimi i tij ka thyer kontratën e lidhur mes palëve.

- Nga auditimi rezultoi se, për dy projekte ka ndryshim të projekt menaxherit të Drejtorisë së menaxhimit të fondeve të BE, të cilat riskojnë realizimin e suksesshëm të projekteve dhe përdorimin e fondeve në mënyrë efektive, kjo pasi ndryshimi i shpeshtë mund të shkaktojë humbje të vazhdimësisë në menaxhimin e projekteve dhe në koordinimin ndërmjet palëve të përfshira; humbje të njohurive dhe eksperiencës të grumbulluar nga menaxherët e mëparshëm; dhe vonesa në ekzekutimin e aktiviteteve të projektit, për shkak të nevojës për kohë për t'u njohur me projektin dhe përshtatur procedurat dhe planifikimet e mëparshme.

- Nga auditimi u konstatua se, në 2 nga 8 rastet e përzgjedhura për tu audituar (përfunduar cikli i plotë i pagesave) transfertat bankare është kryer më vonë nga afati i paracaktuar prej Fondit Monetar në shkresën e aprovimit, duke bërë që fondet të mbahen në llogari për më tepër se 24 orë dhe rritur kështu riskun e krijimit të interesave.

-Nga krahasimi i vlerave të parashikuara nga CFCU mbi nivelin e pagesave në nivel projekti dhe përlllogaritjeve të TVSH-ve respektive si dhe nivelin e realizimit të pagesave faktike për TVSH e çdo projekti, rezulton se planifikimi i kryer nga ana e CFCU është jo realist, kjo për vet faktin se, nga njëra anë mbështetet mbi totalin e vlerës (në parashikimin e këtyre vlerave nuk është marrë në konsideratë vlera e zbritshme e pagesës së parafinancimit) dhe nga ana tjetër operohet në fazë të hershme, mbi një formulë matematikore që të nxjerr në vlera të përafërta.

- Nga auditimi rezultoi problematikë mbi parashikimin dhe më tej miratimin e vlerës së TVSH-së për kontratat e binjakëzimit.

- Nga auditimi mbi dokumentacionin mbështetës të pagesave të kryera për efekt të projekteve AI/IPA2017/06 (CSO si avokat për implementimin e legjislacionit mjedisor horizontal në nivel lokal-Vlorë, me institucion përfitues ICLA) dhe AL/IPA2017/8 (ECO friends miqtë e mjedisit dhe klimës operative, me institucion përfitues COSPE) rezultoi se, dokumentacioni justifikues i kryerjes së aktiviteteve është i pjesshëm si dhe në mospërputhje me deklaratat e paraqitura në “letrat e punës” të kryqëzuara mes eksperteve respektiv dhe grupit të punës.

-Nga grupi i auditimit konstatohet se janë ndërprerë dy kontrata të njëpasnjëshme pa realizuar detyrat e përcaktuara nga donatori për të marrë produktin përfundimtar nga përfituesi, i cili në këtë projekt është AMF, për të cilat është kryer likuidimi pas konfirmimit të marrjes së produktit të fazës së parë, sipas kushteve të kontratës për vlerën totale në shumat 10,051 \$ dhe 23,272 Euro.

-Nga grupi i auditimit konstatohet se në një prej kontratave të fondeve BB është parashikuar se klienti do t'i paguajë konsulentit për këtë shërbim shumë e cila nuk duhet të kalojë 72,030 \$, ku në këtë shumë do përfshihen të gjitha kostot dhe fitimet e konsulentit si dhe çdo detyrim tatimor që mund t'i lindë konsulentit. CFCU nuk ka bërë ndalesën e shumës së TVSH-së nga klienti, por e ka paguar jashtë vlerës së parashikuar në këtë kontratë, duke sjellë shpenzime pa efektivitet në shumë totale prej 14,436 \$.

Me qëllim zgjidhjen e problematikave dhe përmirësimin e situatës, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

#### **h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore**

- Strukturat përgjegjëse të CFCU të marrin masat për të garantuar që përfituesi të dokumentojë dhe të argumentojë qartë çdo ndryshim ose reduktim të detyrave ose objektivave midis kontratës fillestare dhe kontratave pasuese, për të garantuar që objektivat fillestare të kontratës të realizohen në mënyrë efektive dhe të shmangen mungesat ose mospërputhjet në dokumentacion.

-Nga ana e CFCU të bëhet dokumentimi i plotë dhe transparent i komunikimeve, duke siguruar që çdo vendim i marrë për zgjidhjen e një kontrate të bazohet në një dokumentim të plotë dhe të qartë të komunikimeve zyrtare me konsulentët.



- CFCU të sigurojnë ndjekjen rigoroze të afateve të përcaktuara në kontratë për raportimin e detyrave nga konsulentë dhe çdo vonesë të identifikohet menjëherë dhe të merren masa të përshtatshme. Në kontratat e ardhshme të parashikohen penalitete financiare për rastet kur konsulenti dështon të përmbushë detyrimet brenda afateve të përcaktuara, masa këto që do të inkurajojnë respektimin e afateve dhe do të shmangë vonesat.
- CFCU të sigurohet që të gjitha dokumentet zyrtare, përfshirë materialet dhe detyrat e përgatitura nga konsulentët, të jenë të disponueshme edhe në gjuhën shqipe.
- CFCU të sigurojnë zbatimin e rreptë të afateve të pagesave të përcaktuara në kontratë, ku pagesat të kryhen brenda 30 ditëve nga data e dorëzimit të materialit.
- CFCU të sigurojë që të gjitha detyrat dhe fazat e implementimit të projektit të përmbushen në përputhje me kushtet e kontratës, përfshirë dorëzimin e trajnimeve të specifikuara dhe dokumentimin e pjesëmarrësve.
- Për fazat ku kushtet e kontratës nuk janë përmbushur, siç janë ato të përmendura për fazën e dytë, të tretë dhe të pestë, rekomandohet që CFCU të ndërmarrë masa për t'i realizuar ato sërisht në përputhje me kërkesat kontraktuale, duke përfshirë dorëzimin e listës së pjesëmarrësve dhe nënshkrimin përkatës.
- Përfituesi, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të ndërmarrë masa të menjëhershme për të finalizuar dhe dorëzuar produktin final të projektit, duke siguruar që Standartet e Kontabilitetit në Sektorin Publik të zbatohen plotësisht dhe të implementohen në praktikë.
- CFCU, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, të marrë masa për plotësimin e vendeve vakante në strukturën organizative.
- CFCU të marrë masa për përditësimin e Rregullores së Brendshme të Institucionit, me qëllim përfshirjen e ndryshimeve të vendosura me urdhrat e brendshëm të institucionit.
- CFCU të marrë masa për përmirësimin e procedurave të ndjekura që nga hartimi i fishës së binjakëzimit deri në nënshkrimin e kontratës së binjakëzimit, me qëllim shmangien e vonesave në afate apo devijimin nga përcaktimet e Manualit të Binjakëzimit.
- CFCU të marrë masa për inventarizimin dhe numerizimin e plotë të dokumentacionit të dosjeve, si dhe arkivimin e tyre në përputhje me normat tekniko-profesionale, me qëllim ruajtjen e informacionit dhe gjurmës së auditimit në vijimësi.
- CFCU të marrë masa për monitorimin e plotë të aktiviteteve të përcaktuara në kontratë dhe në planet Roll Up, duke evidentuar qartësisht ndikimin e ndryshimeve të objektivave apo planeve përgjatë kohëzgjatjes së kontratës, si dhe plotësimin e dosjeve me të gjithë dokumentacionin justifikues të nevojshëm dhe të domosdoshëm.
- Drejtoria e Monitorimit të marrë masa për kryerjen e kontrolleve “on the spot” në mënyrë të plotë dhe pranë ambienteve përkatëse në terren, me qëllim garantimin e një kontrolli shterues i cili do të përmirësonte në tërësi monitorimin e ecurisë së kontratave dhe do të shërbente si indicie për evidentimin e problematikave apo mangësive të mundshme përgjatë implementimit.
- CFCU të marrë masa për kryerjen në vijimësi të trajnimeve kombëtare dhe ndërkombëtare për stafin lidhur me tematikat e procedurave të tenderimit dhe monitorimit të kontratës për fondet IPA, me qëllim rritjen dhe forcimin e kapaciteteve të stafit të angazhuar në këto procedura.
- Nga CFCU me qëllim rritjen e transparencës dhe efikasitetit në menaxhimin e granteve si dhe sigurimin e përputhshmërisë së plotë me kërkesat e legjislacionit dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, të zhvillohet një sistem monitorimi për të siguruar se procesi i miratimit të raporteve narrative është në përputhje të plotë me kërkesat e Marrëveshjes Operacionale IPA II dhe çdo parregullsi të identifikohet dhe korrigjohet në kohë.

- Me qëllim menaxhimin më efikas të fondeve dhe sigurimin e përputhshmërisë me afatet dhe rregullat kontraktuale, duke rritur efikasitetin dhe transparencën e procesit nga ana e CFCU për të arritur optimizimin e përdorimit të fondeve të merren masa që të zhvillohet një mekanizëm për të siguruar menaxhimin më me efikasitet të tyre, duke shmangur djegien e fondeve të planifikuara për TVSH dhe mundësuar përdorimin e tyre për pagesa dhe investime të tjera brenda periudhës buxhetore.
- Nga ana e CFCU, konkretisht sektori i monitorimit të implementimit, me qëllim sigurimin e përputhshmërisë me kushtet e kontratave dhe minimizimin e risqeve të mundshme për mosrealizimin e aktiviteteve dhe arritjen e outputeve të parashikuara, të kryhet një vlerësim i rregullt i impaktit që mund të ketë ndryshimi i vlerës së pagesës finale mbi zbatimin e aktiviteteve dhe arritjen e outputeve të parashikuara.
- Nga ana e CFCU të zhvillohet një mekanizëm për menaxhimin e riskut që lidhet me mundësinë e mos realizimit të aktiviteteve të parashikuara në kontratë, në rastet kur kërkohet një pagesë më e ulët se ajo e parashikuar.
- Nga ana e CFCU të sigurohet që çdo ndryshim në vlerën e kërkuar për pagesë të dokumentohet dhe të jetë i qartë për të gjitha palët e përfshira. Ky dokumentim duhet të përfshijë një përshkrim të plotë të arsyesimit për uljen e vlerës.
- Nga ana e CFCU, të merren masa për të siguruar që çdo përdorim i fondeve të kontigjencës të miratohet dhe të zbatohet në përputhje me kërkesat e Twinning Manual, veçanërisht për sa i përket justifikimit dhe procedurave të miratimit të kostove shtesë, në mënyrë të tillë që të jetë tërësisht i justifikuar dhe në përputhje me rregullat dhe parimet e caktuara.
- CFCU duhet të sigurojë që pagesat për ekspertët të bëhen vetëm pasi shërbimi i kontraktuar të jetë ofruar plotësisht dhe sipas kushteve të kontratës, duke përfshirë verifikimin e shërbimeve të ofruara përpara pagesës. Duke mos kryer pagesa për shërbime që nuk janë ofruar siç parashikohet në kontratë.
- CFCU duhet të monitorojë realizimin e aktiviteteve dhe kursimet e buxhetit, për t'u siguruar që çdo kursim është i dokumentuar dhe justifikuar në mënyrë të qartë.
- Nga ana e CFCU për rastet kur ndryshimi është i paevitueshëm të merren masa për të minimizuar ndikimet negative të këtyre ndryshimeve, duke mbajtur në konsideratë hartimin e një plani të detajuar të kalimit si dhe sigurimin e dokumentimit të plotë të aktivitetit, me qëllim përmirësimin e vazhdimësisë dhe efikasitetit të menaxhimit të projekteve dhe fondeve, duke siguruar një kalim të qetë dhe të organizuar të përgjegjësive dhe duke minimizuar rreziqet e mundshme që lidhen me ndryshimin e shpeshtë të menaxherit.
- Nga ana e CFCU të merren masa që transfertat bankare të kryhen në kohë reale me qëllim shmangien e riskut të krijimit të interesave të panevojshëm në llogari bankare, duke çuar në shpenzime shtesë që nuk janë të parashikuara në buxhetin e projektit. Ky interes mund të jetë i vogël, por në disa raste mund të jetë një shpenzim i panevojshëm që ndikon në alokimin e fondeve për aktivitete të tjera të projektit.
- Nga ana e CFCU, përkatësisht Sektori i Menaxhimit Financiar, me qëllim kryerjen e një procesi sa më real të planifikimit të pagesave të TVSH krahasuar me realizimin faktik të tyre, të merren masa për kryerjen e përlllogaritjeve sa më reale mbi vlerën e pagesave të kontratave, në mënyrë që të shmanget praktika e përfshirjes në pagesat e ndërmjetme edhe e vlerës së parapagesës që duhet të zbritet në faturat e periudhës objekt planifikimi, që rezulton edhe në rritjen e buxhetit të planifikuar për TVSh nga institucionet përfituese të projekteve.
- CFCU të përfshijë në të gjitha kontratat një seksion specifik që parashikon penalitete për mosrealizimin e detyrave dhe objektivave të kontratës sipas kushteve të përcaktuara. Këto

penalitete duhet të jenë të qarta, proporcionale dhe lehtësisht të zbatueshme, sugjerohet që kontratat të strukturohen në faza të ndërlidhura, duke vendosur që likuidimet për fazat e mëparshme të jenë të kushtëzuara nga përmbushja e plotë e detyrave të mëparshme dhe aprovimi i përmbajtjes së tyre nga donatori dhe përfituesi, CFCU të kryejë një analizë të plotë për të identifikuar arsyet e mosrealizimit të objektivave të kontratave dhe të zbatojë masa për të shmangur raste të ngjashme në të ardhmen. CFCU të shqyrtojë mundësinë ligjore për të vlerësuar efektivitetin e përdorimit të fondeve në vlerën prej 1,000 Euro.

- Nga CFCU dhe përfituesit e granteve me qëllim sigurimin e transparencës dhe minimizimin e riskut të abuzimeve dhe gabimeve në menaxhimin e fondeve, të merren masa që pagesat të bëhen vetëm pasi shërbimi i kontraktuar të jetë ofruar plotësisht, duke përfshirë verifikimin e shërbimeve të ofruara përpara kryerjes së pagesës.

CFCU të shqyrtojë mundësinë ligjore për të vlerësuar efektivitetin e përdorimit të fondeve në vlerën prej 9,625.22 Euro.

## **1.2. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit.**

### **OPINIONI I AUDITIMIT**

#### **Opinion i auditimit të përputhshmërisë.**

Ne kemi audituar zbatueshmërinë e akteve ligjore nën ligjore dhe rregullative (burimi i kriterëve të paracaktuara të vlerësimit), për veprimtarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të tjerë për aktivitetin e kryer për periudhën nga 01.01.2021 deri më 30.03.2024, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve në lidhje me përputhshmërinë e kryerjes së prokurimit, monitorimit të zbatimit të kontratës, kryerja e pagesave dhe menaxhimi financiar.

#### **Opinion i modifikuar/kualifikuar<sup>1</sup>**

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjeve të cilësuar në paragrafin e “Baza për opinionin e modifikuar/kualifikuar” subjekti i audituar, CFCU ka vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit (Ligji Nr.9840, datë 10.12.2007 “Për ratifikimin e Marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe komisionit të Komuniteteve Europiane për rregullat e bashkëpunimit për asistencën për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të instrumentit të parazgjerimit (IPA)”; VKM Nr.299, datë 23.05.2018, VKM Nr.719 datë 18.6.2009, VKM Nr.23, datë 12.1.2011, VKM Nr.541, datë 18.6.2015, VKM Nr.987, datë 09.12.2015, Udhëzimi Nr.10 datë 9.3.2015 “Për përcaktimin e procedurave për menaxhimin nëpërmjet fondit kombëtar të bashkëfinancimit të buxhetit të shtetit për projektet IPA” i ndryshuar me Udhëzimin Nr.26 datë 29.12.2016; Udhëzim Nr.8, datë 17.2.2003 Për evidencimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorët e huaj, Udhëzimi Nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; Rregullorja e Prokurimit të Bankës Botërore, e ndryshuar; Udhëzuesit e Bankës Botërore për prokurimin e mallrave, punëve dhe shërbimeve jo konsulente të financuara me kreditë dhe grantet e IBRD dhe IDA si dhe të udhëzimit për përzgjedhjen dhe punësimin e konsulentëve, të financuara me kreditë dhe grantet e IBRD dhe IDA), gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj.

#### **Baza për opinionin e modifikuar/kualifikuar:**

<sup>1</sup> Opinioni i modifikuar, i cilësuar/kualifikuar: Audituesi duhet të shprehë një opinion të cilësuar, kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalië apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura.

Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për përputhshmërinë.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për dhënien e këtij opinioni.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, subjekti i audituar CFCU, në disa raste nuk ka vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit. Shkeljet e evidentuara në disa çështje të audituara, janë materiale por jo të përhapura, referuar popullatave, nën popullatave të kampionuara dhe kampioneve të testuara, sipas përshkrimit të më poshtëm:

**Përshkrimi i çështjeve kryesore:**

- Nga auditimi konstatohet se në kontratat e projekteve të BB në objektivat e parashikuara janë reduktuar objektiva, pa u argumentuar nga përfituesi. Nga ana e strukturave përgjegjëse të CFCU nuk rezulton të jetë identifikuar, raportuar apo të jenë marrë masat lidhur me këto mangësi të konstatuara gjatë kësaj kontrate.

- Nga auditimi është konstatuar se pavarësisht se projekti i “Zhvillimit të kontabilitetit në Sektorin Publik”, ku përfitues është Ministria e Financave, i cili ka filluar procedurën e prokurimit në 17.05.2018, është parashikuar të përfundojë në 30.06.2020, por është shtyrë me amendamentin nr.615, datë 20.10.2021 dhe ka përfunduar në dhjetor 2022, për të cilin janë lidhur gjithsej 5 kontrata ku implementimi i tyre ka përfunduar brenda vitit 2022, përgjatë fazës së auditimit në terren (dhjetor 2024), rezulton se ende nuk ka një produkt final për implementim dhe zbatimin në praktik të Standarteve të Kontabilitetit në Sektorin Publik. Nga ana e strukturave përgjegjëse të CFCU nuk rezultojnë të jenë identifikuar parregullsitë për mungesën e realizimit të produkteve të pritura, apo të jenë adresuar dhe eliminuar pengesat që ka ndikuar në dështimin e implementimit të Standartit të Kontabilitetit në Sektorin Publik.

- Nga auditimi i dosjeve fizike të projekteve të përzgjedhura nën programet IPA dhe atyre të BB dhe donatorëve të tjerë, u konstatua se në tërësi këto dosje mbartnin parregullsi në mënyrën e mbajtjes së tyre, si dhe mungonte fleta e inventarit për çdo dosje respektive.

- Nga auditimi janë konstatuar raste të mos përmbushjes së objektivave, nuk është shoqëruar me zbritjen e ditëve të punës respektive të dedikuara për të dhe rrjedhimisht nuk është pasqyruar në raport. Angazhimi i ndryshëm nga kushtet e kontratës nuk është përkthyer në ndryshim të objektivave apo komponentëve të aktiviteteve, pavarësisht se ka aktivitete që nuk janë mbuluar me ditë angazhimi sipas progres raporteve. Këto ndryshime nuk janë evidentuar nga CFCU përgjatë monitorimit të implementimit të kontratës së binjakëzimit, apo nga monitorimi i pagesave.

-Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me kontrollin “on the spot”, u konstatuan mangësi në realizimin e tyre sipas planifikimit, dhe ky proces nuk është ezauruar në konceptin e plotë dhe shterues të tij përgjatë periudhës objekt auditimi.

- Nga auditimi konstatohet se për shkak të vonesave në procedurat e aprovimit të raporteve finale narrative, periudha për të cilën ishte planifikuar pagesa shtyhet për vitin e ardhshëm, duke sjellë si pasojë thyerje e afateve të pagesave kontraktuale krahasuar me kushtet/afatet kohore të paracaktuara në kontratë; djegie të fondet të TVSH-së për vitin sipas së cilit janë buxhetuar, duke krijuar kështu bllokimin e fondeve të cilat mund të ishin përdorur për pagesa apo investime të tjera.

- Nga auditimi mbi pagesat e kryera konstatohet se vlera e kërkuar për pagesë finale nga ana e përfituesit ishte më e vogël se sa ajo e parashikuar në kontratë. Nga ana e sektorit për monitorimin e kontratave, nuk rezulton të jetë kryer një analizë / apo vlerësim mbi impaktin në outputin final, se si është arritur ai (nëse është çenuar apo jo) në zbatim dhe reflektim të ndryshimeve të ndodhura

krahasuar me zërat e parashikuar. Përthithja më pak nga kontraktimi (vlera e parashikuar në kontratë) mbart në vetvete riskun e mos kryerjes së plotë të aktiviteteve sikundër parashikuar.

- Nga auditimi rezultoi se për dy projekte ka ndryshim të projekt menaxherit të Drejtorisë së menaxhimit të fondeve të BE, të cilat riskojnë realizimin e suksesshëm të projekteve dhe përdorimin e fondeve në mënyrë efektive, kjo pasi ndryshimi i shpeshtë mund të shkaktojë humbje të vazhdimësisë në menaxhimin e projekteve dhe në koordinimin ndërmjet palëve të përfshira; humbje të njohurive dhe eksperiencës të grumbulluar nga menaxherët e mëparshëm; dhe vonesa në ekzekutimin e aktiviteteve të projektit, për shkak të nevojës për kohë për t'u njohur me projektin dhe përshtatur procedurat dhe planifikimet e mëparshme.

-Nga krahasimi i vlerave të parashikuara nga CFCU mbi nivelin e pagesave në nivel projekti dhe përlogaritjeve të TVSH-ve respektive si dhe nivelin e realizimit të pagesave faktike për TVSH e çdo projekti, rezulton se planifikimi i kryer nga ana e CFCU është jo real, kjo për vetë faktin se, nga njëra anë mbështetet mbi totalin e vlerës (në parashikimin e këtyre vlerave nuk është marrë në konsideratë vlera e zbritshme e pagesës së parafinancimit) dhe nga ana tjetër operohet në fazë të hershme, mbi një formulë matematikore që rezulton në vlera të përafërta.

- Nga auditimi mbi dokumentacionin mbështetës të pagesave të kryera për efekt të projekteve AI/IPA2017/06 dhe AL/IPA2017/8 rezultoi se dokumentacioni justifikues i kryerjes së aktiviteteve është i pjesshëm si dhe në mospërputhje me deklaratat e paraqitura në “letrat e punës” të kryqëzuara mes eksperteve respektiv dhe grupit të punës.

-Nga grupi i auditimit konstatohet se janë ndërprerë dy kontrata të njëpasnjëshme pa realizuar detyrat e përcaktuara nga donatori për të marrë produktin përfundimtar nga përfituesi, i cili në këtë projekt është AMF, për të cilat është kryer likuidimi pas konfirmimit të marrjes së produktit të fazës së parë, sipas kushteve të kontratës për vlerën totale në shumat 10,051 \$ dhe 23,272 Euro.

-Nga grupi i auditimit konstatohet se në një prej kontratave të fondeve BB është parashikuar se klienti do t'i paguajë konsulentit për këtë shërbim shumën e cila nuk duhet të kalojë 72,030 \$, ku në këtë shumë do përfshihen të gjitha kostot dhe fitimet e konsulentit si dhe çdo detyrim tatimor që mund t'i lindi konsulentit. CFCU nuk ka bërë ndalesën e shumës së TVSH-së nga klienti, por e ka paguar jashtë vlerës së parashikuar në këtë kontratë, duke sjellë shpenzime pa efektivitet në shumën totale prej 14,436 \$.

## **II. HYRJA**

Mbështetur në Ligjin Nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit nr.1097/1, datë 16.09.2024, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH, në subjektin Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të tjerë për aktivitetin e kryer për periudhën nga 01.01.2021 deri më 30.06.2024 u krye auditimi “Auditim përputhshmërie” nga grupi i auditimit me përbërje:

1. R.Xh, Përgjegjës Grupi
2. A.B, auditues
3. Xh.N, audituese
4. A.K, audituese
5. A.M, audituese

## **OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA**

### **1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit.**

Në zbatim të programit të auditimit objektivi kryesor është dhënia e një opinionit mbi përputhshmërinë e aktivitetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të tjerë me Ligjin Nr.9840 datë 10.12.2007, ligjin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, ligjin e buxhetit të shtetit dhe akte të tjera ligjore e nënligjore në funksion të realizimit të misionit dhe objektivit të kësaj drejtorie, si dhe bazueshmërinë me kërkesat e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

**Objektivat e auditimit** lidhen me dhënien e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së institucionit, nëpërmjet një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen në të gjitha aspektet materiale, sasiore dhe cilësore, me kriteret e aplikuar si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohet veprimtaria etj.

**Qëllimi i auditimit** është raportimi mbi gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e auditimit dhe vlerësimi i pavarur i funksionimit të sistemeve të ngritura, procedurave të ndjekura nga Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë, gjatë procesit të realizimit të objektivave në përputhje me legjislacionin në fuqi, vlerësimi objektiv, profesional e i pavarur i përputhjes së veprimeve procedurale, administrative, ekonomike e financiare, me kriteret dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi. Vlerësimi dhe evidentimi i shkeljeve të parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar, shfrytëzimit me efikasitet, efektivitet dhe ekonomicitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike, si dhe dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes.

### **b. Identifikimi i çështjes**

Fushëveprimi i këtij auditimi është vlerësimi me siguri të arsyeshme i veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë për periudhën objekt auditimi nga 01.01.2021 deri më 30.06.2024, në përputhje me aktet ligjore të cilat rregullojnë veprimtarinë e këtij institucioni. Përputhshmëria dhe rregullshmëria në procedurat e ndjekura nga ana e CFCU gjatë kryerjes së planifikimit të prokurimit, zbatimi i procedurave të tenderimit, vlerësimi i ofertave si dhe kontraktimi final; monitorimi i zbatimit të kontratës, kryerja e pagesave dhe menaxhimi financiar të projekteve. Referuar analizës së riskut, në fazën e planifikimit dhe auditimit në terren, u identifikuan fushat me risk më të lartë. Gjithashtu, sigurojmë që vlerësimi fillestar i riskut në fazën e planifikimit si dhe ai i aplikuar gjatë fazës së auditimit në terren, vijon të mbetet i vlefshëm. Sa më sipër, fushat me risk më të lartë u përcaktuan si drejtimit e auditimit të miratuara me Programin e Auditimit dhe të trajtuara në këtë Raport Auditimi.

### **c. Përgjegjësitë e Strukturave Drejtuese**

Drejtimi i CFCU është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare, materiale dhe njerëzore në përputhje me politikat, ligjet, vendimet, udhëzimet dhe rregulloret e aplikuar (kriteret e vlerësimit). Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

#### **d. Përgjegjësia e audituesve të KLSH**

Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, ne kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese. Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë. Audituesit në të gjithë llojet e auditimit, kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 "Parimet themelore të auditimit të sektorit publik", paragrafi 44-51. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI. Këto standarde kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojë e kryejë auditimin me qëllim që të arrijë nivelin e sigurisë së kërkuar nëpërmjet auditimit të realizuar.

#### **e. Kriteret e vlerësimit**

Për kryerjen e këtij auditimi, në lidhje me dhënien e opinionit për përputhshmërinë e aktivitetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të tjerë, kriteret e vlerësimit janë si më poshtë:

- Ligji Nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji Nr.9936, datë 26.6.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”;
- Ligji Nr.9840, datë 10.12.2007 “Për ratifikimin e Marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe komisionit të Komuniteteve Europiane për rregullat e bashkëpunimit për asistencën për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të instrumentit të parazgjerimit (IPA)”;
- Ligji Nr.25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”;
- VKM Nr.299, datë 23.05.2018 për “Krijimin, organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Financimeve dhe kontraktimeve për fondet e BE-së, BB-së dhe donatorëve të tjerë”;
- VKM Nr.719 datë 18.6.2009 “Për përcaktimin e funksioneve të përgjegjësive dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve e strukturave të menaxhimit të decentralizuar të asistencës së bashkimit evropian në kuadër të instrumentit të parazgjerimit (IPA), komponenti I”;
- VKM Nr.23, datë 12.1.2011 Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësive dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve të strukturave të menaxhimit të decentralizuar të asistencës së Bashkimit Evropian, në kuadër të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA), komponenti I: asistencë e tranzicionit dhe forcimi institucional;

- VKM Nr.541, datë 18.6.2015 “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër nëpërmjet RSH të përfaqësuar nga qeveria e RSH dhe KE për rregullat e zbatimit të asistencës financiare të BE në Shqipëri në kuadër të zbatimit të IPA II”;
- VKM Nr.987, datë 09.12.2015 “Për miratimin në parim të marrëveshjes së financimit nëpërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Evropian për programin e Veprimit IPA, për vitin 2014 për Shqipërinë.”;
- Rregullore e Brendshme mbi Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 197, datë 12.10.2022;
- Rregullore e procedurave të auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit, miratuar me Vendimin nr.07, datë 17.01.2024 të Kryetarit të KLSH-së;
- Udhëzimi Nr.10 datë 9.3.2015 “Për përcaktimin e procedurave për menaxhimin nëpërmjet fondit kombëtar të bashkëfinancimit të buxhetit të shtetit për projektet IPA” i ndryshuar me Udhëzimin Nr.26 datë 29.12.2016;
- Udhëzimi Nr.14, datë 28/12/2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe njësitë e menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj”, i ndryshuar;
- Udhëzim Nr.8, datë 17.2.2003 Për evidencimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorët e huaj;
- Udhëzimi Nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; Rregullorja e Prokurimit të Bankës Botërore, e ndryshuar;
- Udhëzuesit e Bankës Botërore për prokurimin e mallrave, punëve dhe shërbimeve jo konsulence të financuara me kreditë dhe grantet e IBRD dhe IDA si dhe të udhëzimit për përzgjedhjen dhe punësimin e konsulentëve, të financuara me kreditë dhe grantet e IBRD dhe IDA.

#### **f. Standardet e auditimit**

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), përkatësisht në: Nivelin e parë “Parimet INTOSAI-t” ku përfshihet: ISSAI-P-1 “Deklarata e Limës”, ISSAI-P-10 “Deklarata e Meksikos”; Nivelin e dytë “Standardet e INTOSAI-t” ku përfshihen: ISSAI 100 - Parimet bazë në auditimin e sektorit publik, ISSAI 400-499 “Parimet bazë të auditimit të përputhshmërisë”, ISSAI 4000 "Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë"; ISSAI 4200; ISSAI-140 “Sigurimin e cilësisë”, ISSAI 130 “Kodin Etik”, ISSAI 2315 “Risku”, ISSAI 2320-2450 “Materialiteti” , ISSAI 2500 “Dokumentimi”; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC; Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t; INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë"; Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë" etj.

#### **g. Metodatat e auditimit**

Është përdorur metoda me auditim të njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.



*Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin* . Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

*Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:*

- *Kontrolli aritmetik*. Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)

- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese*. Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese*. Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

- *Kontrolli i vlerësimit*. Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

- *Konfirmim nga të tretët*. Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.

- *Kontrolli sipas një treguesi*. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.

- *Verifikimi i transaksioneve* është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.

- *Intervistimi* është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.

- *Raporte dhe informacione* janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.

- *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

## **h. Dokumentimi i auditimit**

Dokumentimi i auditimit është mbështetur në kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë dhe në Rregulloren e Procedurave të Auditimit në KLSH, me ndryshime. Gjithashtu, është mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “*Dokumentimi i Auditimit*”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e

zbatueshme ligjore dhe rregullatorë. Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionin dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren, Akteve të Konstatimeve të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit ky Raport i Auditimit.

### **III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**

#### **1. Informacion i përgjithshëm**

CFCU, është krijuar me VKM nr. 596, datë 05.09.2007 “Për Ngritjen e Strukturave dhe Përcaktimin e Autoriteteve e të Përgjegjësive për Zbatimin e Instrumentit të Parazgjerimit”, si strukturë brenda Ministrisë së Financave. Në vitin 2018, me VKM nr.299, datë 23.05.2018 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Financimeve dhe Kontratave për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorë të tjerë”, CFCU ndryshon nga Drejtori e Përgjithshme në Ministrinë e Financave në Drejtori e Përgjithshme në varësi të Ministrisë së Financave. Numri i punonjësve i përcaktuar në VKM do të ishte 34 veta.

Organizimi i brendshëm i saj është miratuar sipas Urdhrit nr.88, datë 13.06.2018 të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve dhe Fondet e BE- së, BB-së dhe Donatorëve të tjerë” për periudhën deri më 26.08.2022. Marrëdhëniet e punës së punonjësve rregullohen në bazë të dispozitave të legjislacionit për nëpunësin civil.

Në vitin 2020, me Urdhër të Kryeministrit nr. 21, datë 03.02.2020 CFCU ristrukturohet dhe totali i pozicioneve të punës shkon në 35 vende. Ky Urdhër pasohet me Urdhër nr.46 datë 05.03.2020 “Për një ndryshim në Urdhër nr.21 datë 03.02.2020” ku shkurtohet pozicioni “përgjegjës sektori” dhe shtohet një pozicion “specialist” por numri total i punonjësve nuk ndryshon.


Me Urdhër nr. 142, datë 26.08.2022 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve dhe Fondet e BE- së, BB-së dhe Donatorëve të tjerë” i ndryshuar me Urdhër nr.166 datë 04.10.2022 përcaktohen rolet dhe përgjegjësitë e sektorëve/drejtorive të ndryshme në Drejtorinë e Përgjithshme të Financimit dhe Kontraktimit të BE-së, BB dhe fonde të tjera të donatorëve, ristrukturohet CFCU dhe totali i pozicioneve të punës shkon në 36.

Për periudhën nga 04.10.2022 e në vijim struktura është rregulluar me Urdhër nr.59 datë 18.04.2024. Urdhër i cili ka ndryshuar numrin e punonjësve në 48 punonjës në total. Ky ndryshim ka ardhur si pasojë e kërkesës datë 30.01.2024 me shkresën nr.83 prot. ku CFCU i drejtohet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë duke inicuar një propozim dhe argumentim për disa ndryshime në strukturën organizative të institucionit. Sipas këtij propozimi, kërkohet që numri total i punonjësve për vitin 2024 të arrijë në 48 veta nga të cilët 38 të dedikuar për projektet e financuara nga IPA ndërkohë që numri i punonjësve për menaxhimin e projekteve të financuara nga BB dhe donatorë të tjerë të jetë 10.

Sipas strukturës organike aktuale CFCU është e përbërë nga katër Drejtori, respektivisht:

- I. Drejtoria për Kontraktimin dhe Monitorimin e Zbatimit të Programeve IPA.
- II. Drejtoria për Sigurimin e Cilësisë (IPA).
- III. Drejtoria për Menaxhimin Financiar IPA dhe Kontrollin e Nivelit të Parë për ETCP.
- IV. Drejtoria për Projektet e Bankës Botërore dhe Donatorëve të tjerë.

Tre (3) nga katër (4) drejtoritë e CFCU kryejnë aktivitete të lidhura me menaxhimin e IPA-s, duke mbuluar proceset e tenderimit, kontraktimit, sigurimit të cilësisë të procedurave të prokurimit dhe kontrollit të Njërive IPA pranë institucioneve përfituese, menaxhimit të kontratave dhe menaxhimit financiar të fondeve IPA.



Nga grafiku i mësipërm në lidhje me funksionet e menaxhimit të CFCU, një Drejtor i Përgjithshëm menaxhon Drejtorinë e Përgjithshme dhe një Drejtor menaxhon çdo drejtori. Gjithashtu, sektorët brenda drejtorive menaxhohen nga Përgjegjësit e Sektorëve, me përjashtim të Sektorit për Nivelin e Parë të Kontrollit të ETCP që është drejtpërdrejt nën përgjegjësinë e Drejtorit përkatës, (sektori për Nivelin e Parë të Kontrollit të ETCP-së nuk është pjesë e organizimit organizativ të CFCU-së relevante për menaxhimin e programeve vjetore/shumëvjeçare të IPA III).

Në mënyrë të detajuar:

Nr	Pozicioni	Numri sipas U.59/18.4.24	Numri faktik	Vakanca
1	<b>Drejtor i Përgjithshëm</b>	1	1	-
2	<b>Drejtorja për menaxhimin e kontratave IPA</b>	18	9	9
	Drejtor	1	1	-
2.1	<b>Sektor për për gatitjen e dokumenteve të prokurimit</b>	5	1	4
	P/Sektor	1	-	1
	Specialist	4	1	3
2.2	<b>Sektor për vlerësimin dhe kontraktimin IPA</b>	6	5	1
	P/Sektor	1	1	-

	Specialist	5	4	1
<b>2.3</b>	<b>Sektor për monitorimin e kontratave IPA</b>	<b>6</b>	<b>2</b>	<b>4</b>
	P/Sektori	1	1	-
	Specialist	5	1	4
<b>3</b>	<b>Drejtoria për Sigurimin e Cilësisë dhe kontrollin e brendshëm</b>	<b>9</b>	<b>6</b>	<b>3</b>
	Drejtor	1	1	-
<b>3.1</b>	<b>Sektor për kontrollin e brendshëm dhe çështjet ligjore</b>	<b>3</b>	<b>2</b>	<b>1</b>
	Specialist	3	2	1
<b>3.2</b>	<b>Sektor për kontrollin e cilësisë</b>	<b>5</b>	<b>3</b>	<b>2</b>
	P/Sektori	1	1	-
	Specialist	4	2	2
<b>4</b>	<b>Drejtoria për Menaxhimin Financiar IPA</b>	<b>11</b>	<b>8</b>	<b>3</b>
	Drejtor	1	1	-
<b>4.1</b>	<b>Sektori për menaxhimin financiar IPA dhe kontabilitetin</b>	<b>4</b>	<b>3</b>	<b>1</b>
	P/Sektori	1	1	-
	Specialist	3	2	1
<b>4.2</b>	<b>Sektori për kontrollin financiar</b>	<b>6</b>	<b>4</b>	<b>2</b>
	P/Sektori	1	1	-
	Specialist	5	3	-

Burimi i të dhënave: CFCU, përpunoi Grupi auditimit.

Misioni i kësaj Drejtorie është të sigurojë një menaxhim efektiv administrativ, financiar dhe teknik të projekteve të miratuara, në përputhje me Marrëveshjet Financiare me Komisionin Evropian e donatorë të tjerë. Funkcionet kryesore të saj janë:

1. Tenderimin e fondeve.
2. Ndjekjen e procedurave të Vlerësimit dhe Kontraktimit.
3. Monitorimin mbi zbatimin e kontratave.
4. Kryerjen e pagesave.
5. Siguron zbatimin korrekt të rregullave të menaxhimit financiar të kontratave.
6. Kryen Kontrollin e Nivelit të Parë të shpenzimeve të deklaruara nga projekt-partnerët shqiptarë përfitues të Programeve të Bashkëpunimit Rajonal.
7. Raportimin periodik të riskut dhe parregullsive në DFK dhe strukturat IPA në ministritë e linjës.
8. Siguron kontrollin e funksionimit e sistemit të menaxhimit dhe kontrollit në Drejtorinë e Financimeve dhe Kontraktiveve (DFK) dhe në strukturat IPA në ministritë e linjës.
9. Siguron cilësinë e dokumentacionit të procedurave të prokurimit, nëpërmjet zbatimit të parimit të “katër syve”.
10. Kryen funksionin e Zyrtarit Autorizues të Programit, nëpërmjet Drejtorit të saj.

## **2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.**

### **2.1 Vlerësim mbi përputhshmërinë e aktivitetit të Drejtorisë së Zbatimit të projekteve të BB dhe Donatorëve të tjerë.**

Drejtoria për Zbatimin e Projekteve të Bankës Botërore dhe të Donatorëve të tjerë ka si funksion planifikimin dhe ndjekjen e procedurave të prokurimit, koordinimin e procedurave për nënshkrimin e kontratave dhe monitorimin e zbatimit të tyre, menaxhimin financiar të projekteve si dhe përgatitjen e raportimeve periodike lidhur me ecurinë e zbatimit të projektit për Bankën Botërore dhe Donatorët e tjerë, funksione të cilat i kryen në përputhje me Udhëzuesit e Bankës Botërore: “Prokurimi i mallrave, punimeve dhe shërbimeve jo konsulente sipas huave nga IBRD dhe kredive dhe granteve nga IDA dhe nga Huamarrësit e Bankës Botërore” dhe “Përzgjedhja dhe

Punësimi i Konsulentëve nga Huamarrësit e Bankës Botërore”, dhe dispozitat e përcaktuara në marrëveshjet e grantit ndërmjet Qeverisë së Shqipërisë dhe Bankës Botërore. Kjo drejtori është e ndarë në dy sektor: Sektori i Menaxhimit të Prokurimeve, në përbërje të të cilit janë katër specialist dhe një përgjegjës sektori dhe Sektori i Menaxhimit Financiar dhe Kontabilitetin, në përbërje të të cilit janë dy specialist dhe një përgjegjës sektori nga ku rezulton se një vend specialisti është vakant. Mbajtja e pozicionit të përgjegjës të specialistit vakant nuk garanton ngarkesën e drejtë për secilin nëpunës, sigurimin e mbarëvajtjes së punës në këtë drejtori si dhe arritjen e objektivave të saj.

Çdo projekt rregullohet nga një Manual Operacionesh, i cili përfshin një përshkrim të detajuar të aktiviteteve të projektit dhe masave institucionale për projekt, procedurat administrative, kontabël, audituese, raportuese, financiare, prokurimin, disbursimin dhe treguesit e monitorimit të projektit. Manuali i projektit dhe çdo ndryshim i lidhur me të realizohet me miratimin e Bankës Botërore. Secili projekt realizohet në paketa prokurimi dhe Plani i Prokurimit të Projektit miratohet gjithashtu nga BB. Plani i Prokurimit përmban parashikime dhe çdo ndryshimi i tij është objekt i miratimit paraprak “No Objections” nga BB. Gjatë gjithë kohës së zbatimit të projektit krijohet dhe mbahet një Komitet Drejtues i Projektit (PSC), i cili përbëhet nga përfaqësues të MFE-së, CFCU-së dhe autoritet të tjera përkatëse, me mandate, terma reference dhe burime të pranueshme për BB, për të qenë përgjegjës për dhënien e udhëzimeve strategjike, për t’i dhënë prioritet aktiviteteve të projektit, duke përfshirë miratimin e planeve të punës dhe mbikëqyrjen e progresit të zbatimit të projektit. Gjithashtu gjatë kohës së zbatimit të projektit marrësi krijon dhe mban një Ekip për Zbatimin e Projektit (PIT), për të qenë përgjegjës për zbatimin e projektit në koordinim me CFCU-në dhe PSC-në.

Secili projekt i BB dhe donatorëve të tjerë ka një llogari speciale të hapur në Bankën e Shqipërisë nga momenti që marrëveshja kuadër bëhet efektive deri në mbylljen e projektit, si dhe një llogari tjetër në bankat e nivelit të dytë, e cila menaxhohet nga CFCU. Buxhetimi vjetor bazohet në planin e prokurimit dhe secili entitet përfitues është përgjegjës për këtë proces. Disbursimi i fondeve për projektet e Bankës Botërore dhe donatorëve të tjerë mund të bëhet në 3 mënyra, të cilat janë:

1. Parapagim
2. Rimbursim
3. Pagesë direkte

Parapagimi përdoret kryesisht vetëm një herë në fillim të projektit, në mënyrë që llogaria e sapo hapur e projektit në Bankën e Shqipërisë dhe më tej ajo e hapur në bankën e nivelit të dytë, të ketë likuiditet mjaftueshëm për të përballuar faturat fillestare të kontraktorëve. CFCU i dërgon BB formularin me kërkesën për parapagim për një shumë të caktuar, të bazuar në planin buxhetor. Më tej në vazhdimësi të projektit operohet nëpërmjet disbursimit me rimbursim, ku CFCU i dërgon BB aplikimin për disbursim me rimbursim për një vlerë që mbulon shpenzimet e një periudhe të caktuar, e cila shoqërohet me “Statement of Expenditure” për të gjitha shpenzimet e kësaj periudhe. Në këtë mënyrë llogaria e projektit ka likuiditet të vazhdueshëm dhe në përfundim të projektit për t’u mbyllur llogaria dërgohet edhe një formular i shoqëruar me dokumentacionin mbështetës me shpenzimet e fundit në vlerën e parapagimit fillestar. Në këtë mënyrë mbyllet e gjithë procedura në përfundim të projektit, balanca e llogarisë bëhet 0 dhe bëhet edhe mbyllja e llogarisë speciale të projektit. Nga shqyrtimi i urdhërpagesave të lëshuara nga CFCU për projektet e BB rezulton se Nëpunës Autorizues është Drejtori i Përgjithshëm, ndërsa Nëpunës Zbatues është Përgjegjës i Sektorit të Finances dhe Menaxhimit Financiar.

Gjatë periudhës planifikuar për auditim janë realizuar ose janë në proces realizimi 5 projekte të Bankës Botërore ose donatorëve të tjerë të cilat pasqyrohen si më poshtë:

Nr	Emri i Projektit	Donatori	Përfituesi	Grant/Kredi	Vlera e projektit	Data e fillimit	Data e mbarimit	Statusi
1	Zhvillimit të kontabilitetit në Sektorin Publik	I. (W. B) - Fonde të S.	MFE	Grant	1,450,000	5/17/2018	6/30/2020	Mbyllur
2	Fuqizimin e kapaciteteve mbikëqyrëse të AMF	W. B - Fonde të S.	AMF	Grant	990,000	5/15/2020	12/31/2022	Mbyllur
3	Lehtësimi i Tregtisë dhe transportit në Ballkanin Perëndimor	I.(W. B)	MEKI, DPD, MIE, MPB	Kredi	17,600,000	1/17/2020	12/15/2025	Në vazhdim
4	(Programi i Zhvillimit të Mjedisit)	(S)	MTM	Grant	20,300,000	7/8/2021	7/8/2024	Në vazhdim
5	Forcimit të Cilësisë së Auditimit dhe Raportimit	I.& I.(W. B) - Fonde të S.	KKK, BMP, BSH, AMF	Grant	1,428,571	4/29/2022	12/31/2025	Në vazhdim

Fondet e disbursuara për secilin projekt gjatë viteve 2021, 2022, 2023 dhe deri në qershor 2024 janë si në tabelën më poshtë:

Nr	Projekti	2021	2022	2023	6.2024	Total	Monedha
1	Zhvillimit të kontabilitetit në Sektorin Publik (Development of Public Sector Accounting Project)	164,326	355,895	426,576	0	946,797	USD
2	Fuqizimin e kapaciteteve mbikëqyrëse të AMF (Strengthening Supervisory Capacities Project)	200,000	419,132	247,551	0	866,683	USD
3	Lehtësimi i Tregtisë dhe transportit në Ballkanin Perëndimor (Western Balkans Trade and Transport Facilitation Project - ĒBTTF)	0	450,084	378,656	1,331,428	2,160,169	Euro
4	Environmental Support Program (Programi i Zhvillimit të Mjedisit)	3,000,000	0	0	0	3,000,000	SEK
5	Strengthening Quality of Auditing and Report Project (Forcimit të Cilësisë së Auditimit dhe Raportimit)	0	0	144,798	162,939	307,737	Euro

\*\*\* Marrëveshja është në monedhën SEK. Kërkesa për disbursim bëhet në SEK por fondet vijnë në BSH në EUR me kursin e datës së kalimit. Kontrata me kompaninë fituese është lidhur në monedhën EUR.

Ecuria e realizimit të projekteve deri në dhjetor 2024 është 567,811.75 EUR ose 40%, konkretisht paraqitur si më poshtë:

Nr	Projekti	Fillimi	Mbarimi	Statusi 06.2024	Vlera Totale	Realizimi Vlerë	Realizimi %
1	Zhvillimit të kontabilitetit në Sektorin Publik (Development of Public Sector Accounting Project)	17/05/2018	31/12/2022	I mbyllur	1,450,000	1,394,966	96%
2	Fuqizimin e kapaciteteve mbikëqyrese te AMF (Strengthening Supervisory Capacities Project)	15/05/2020	31/12/2022	I mbyllur	990,000	866,683	88%
3	Lehtesimi I Tregtise dhe transportit ne Ballkanin Perendimor (Western Balkans Trade and Transport Facilitation Project - WBTF)	17/01/2020	15/12/2025	Në vazhdim	17,600,000	3,204,169	18%
4	Environmental Support Program (Programi I Zhvillimit te Mjedisit)	08/07/2021	31/10/2027	Në vazhdim	20,300,000	3,000,000	15%
5	Strengthening Quality of Auditing and Report Project (Forcimit të Cilësisë së Auditimit dhe Raportimit)	13/05/2022	31/12/2025	Në vazhdim	1,428,571	307,737	22%

Nga grupi i auditimit është audituar projekti i “Fuqizimin e kapaciteteve mbikëqyrese të AMF”, i cili ka filluar procedurën e prokurimit në 15.05.2020 dhe ka përfunduar në dhjetor 2020. Për këtë projekt janë lidhur gjithsej 3 kontrata ku implementimi i tyre ka përfunduar brenda vitit 2022.

Përfituesi	Subjekti	Data e lidhjes së kontratës	Data e implementimit	Data e përfundimit	Vlera e kontratës	Statusi
C.F.L.	I. C.F. to provide training services on capital market regulations	17.11.2022	17.11.2022	31.12.2022	72,030	Mbyllur
E.Y.G.	Strengthening A. regulatory and supervisory function and Support in its Capital Market Development Efforts”	25.05.2021	16.07.2021	31.12.2022	558,243	Mbyllur
A.K.A.	Peripatetic advisor to provide on-job regulatory and supervisory support and guidance to A.	29.12.2021	12.01.2022	31.12.2022	256,400	Mbyllur
G.I.B.	Peripatetic advisor to provide on-job regulatory and supervisory support and guidance to A.	25.02.2021	25.02.2021	31.12.2022	207,126.00	Mbyllur

Nga auditimi mbi dokumentacionin referuar pagesave të kryera, rezulton se:

Për projektin:”Peripatetic advisor to provide on-job regulatory and supervisory support and guidance to A.”, kontrata është lidhur me konsulentin G.I.B, kontrata ka si objekt:

Deliverables of activities	Delivery date
<b>Inception report</b> Present an overall approach and detailed program work plan and completion schedule for the services. It should discuss the constraints and challenges identified by the Consultant and ways to address them in order to timely and effectively deliver the assignment.	2 weeks after the signing of the contract
<b>Quarterly progress reports</b> Describe the support provided in detail, including the materials or documents prepared.	Every quarter
<b>Task 1</b> - Assist A.... in quality assurance for deliverables and outputs procured under the project. Review the reports and other documents produced from consultants and provide advice for their possible improvement.	Ongoing
<b>Task 2</b> - Gap analysis from project deliverables and recommendation of best solutions or changes, as well as other professional assistance as per requirement.	Ongoing
<b>Task 3</b> - Provide strategic guidance to A.... to best cope with supervisory/regulatory trends and support market development. Assist management in their decisions towards market and supervisory development.	Ongoing

<b>Task 4</b> - Provide advice to A.... in strengthening their role in maintaining and strengthening the stability of the financial system.	Ongoing
<b>Task 5</b> - Carry any other advisory activities as requested by A.... management	Ongoing

Nga auditimit rezulton se me shkresën Nr.1707/2 Prot, datë 02.07.2021 autoriteti përfitues AMF i ka dërguar CFCU dokumentacionin financiar dhe konfirmimin e marrjes së produktit **“Inception report”** nga konsulenti G.I.B. për periudhën 25.02.2021-07.06.2021 sipas planit të punës së dakortësuar në kontratë për të cilën është paraqitur tabela përmbledhëse e shpenzimeve të rimbursueshme në vlerën 10,051 USD, ku nga CFCU është bërë ndalesa 15% ose 1,235 USD për pagesën e tatimit në burim të individit përfitues, pagesa është realizuar në datë 22.07.2021.

Pas marrjes në dorëzim të produktit të parë të përgatitur nga konsulenti, me anë të emalit ka njoftuar tërheqjen nga implementimi i kontratës në datën 28.06.2021. Në datën 30.06.2021 CFCU ka nxjerr shkresën për ndërprerjen e kontratës me konsulentin G.I.B. Në datën 1 korrik është rihapur procedura për vazhdimin e implementimit të kësaj kontrate me një konsulent tjetër. Për vazhdimin e projektit:”Peripatetic advisor to provide on-job regulatory and supervisory support and guidance to A.” është lidhur kontrata me konsulentin A.K.A. me objekt:

Deliverables of activities	Delivery date
<b>Quarterly progress reports</b> Describe the support provided in detail, including the materials or documents prepared.	Every quarter
<b>Task 1</b> - Assist A.... in quality assurance for deliverables and outputs procured under the project. Review the reports and other documents produced from consultants and provide advice for their possible improvement.	Ongoing
<b>Task 2</b> - Provide strategic guidance to A.... to best cope with supervisory/regulatory trends and support market development. Assist management in their decisions towards market and supervisory development.	Ongoing
<b>Task 3</b> - Provide advice to A.... in strengthening their role in maintaining and strengthening the stability of the financial system.	Ongoing
<b>Task 4</b> - Carry any other advisory activities as requested by A.... management	Ongoing

Nga lidhja e kontratës me konsulentin e dytë konstatohet se në objektivat e parashikuara është reduktuar objektivi **Inception report I** cili është i përfituar në kontratën e ndërprerë, gjithashtu është reduktuar edhe **Task 2 - Gap analysis from project deliverables and recommendation of best solutions or changes, as well as other professional assistance as per requirement**, detyrë kjo e cila është parashikuar në kontratën fillestare por që nuk është realizuar. **Ky veprim nuk është argumentuar nga përfituesi.**

Rezulton se me shkresën Nr.1823 Prot, datë 01.08.2022 autoriteti përfitues AMF i ka dërguar CFCU dokumentacionin financiar dhe konfirmimin e marrjes së produktit: **“Quarterly progress reports”** Describe the support provided in detail, including the materials or documents prepared, nga konsulenti A.K.A. për periudhën 12.01.2022-31.03.2022 sipas planit të punës së dakortësuar në kontratë për të cilën është paraqitur fatura me nr.1, datë 22.07.2022 në vlerën 23,272 euro, ku nga CFCU është bërë ndalesa 15% ose 3,490 euro për pagesën e tatimit në burim të individit përfitues, pagesa është realizuar në datë 04.08.2022. Me shkresën nr.799, datë 10.08.2022, CFCU i drejtohet konsulentit A.K.A. duke i komunikuar zgjidhjen e kontratës ku i referohet kërkesës së bërë nga konsulenti për ndërprerje kontrate. **Nga verifikimi i praktikës e cila gjendet në dosje konstatohet se nuk ka komunikim/kërkesë nga konsulenti për një veprim të tillë.**

Nga grupi i auditimit konstatohet se janë ndërprerë dy kontrata të njëpasnjëshme pa realizuar detyrat e përcaktuara nga donatori për të marr produktin përfundimtar nga përfituesi, i cili në këtë projekt është AMF, për të cilat është kryer likuidimi pas konfirmimit të marrjes së produktit të fazës së parë, sipas kushteve të kontratës për vlerën totale në shumat 10,051 dollar dhe 23,272 euro.



Duke u nisur nga vetë natyra e kontratës dhe shërbimit që do të përfitohet, të cilat n.q.s. nuk realizohet në tërësinë e saj, detyrat e përcaktuara konsiderohen të paimplementueshme duke çuar dështimin e përfitimit të produktit final. ***Nga sa më sipër grupi i audituesve del në konkluzionin se nga mosveprimi i CFCU, si institucion përgjegjës për monitorimin dhe realizimin e projektit, nuk ka parashikuar në kushtet e kontratës, seksionin e penaliteteve për mos realizimin e kontratës sipas të gjitha përcaktimeve të saj, dhe kjo ka sjellë shpenzime pa efektivitet në shumën totale prej 10,051 Dollar dhe 23,272 Euro.***

Gjithashtu grupi i auditimit konstaton se është vijuar me projektin “Internacional Consultancy Firm to provide training services on capital market regulations” dhe projektin “Strengthening A. regulatory and supervisory function and Support in its Capital Market Development Efforts” pa një relacion mbi ndikimin e mos realizimit të fazës së parë të detyrave paraprahe të cilat do të përfitohen dhe do të vazhdojnë të implementohen me zhvillimin e projektit final.

Për projektin: “I.C.F. to provide training services on capital market regulations” kontrata është lidhur me konsulentin C.F.L, konsulenti ka detyrimin të prodhojë materialet si më poshtë:

Nr	Deliverables of activities	Delivery date
1	Deliver workshops on the draft Regulations for market participants, other external stakeholders and A. staff	5-23 December 2022

Rezulton se me shkresën nr.2848/3 Prot, datë 09.12.2022 autoriteti përfitues AMF i ka dërguar CFCU dokumentacionin financiar dhe konfirmimin e marrjes së produktit “Inception Report” nga firma përfituese C.F.L. sipas planit të punës së dakortësuar në kontratë për shumën 10% të kontratës për të cilën është paraqitur fatura me nr.2542, datë 24.11.2022 në vlerën 7,203 USD, e cila është paguar më datë 15.12.2022. Rezulton se me shkresën nr.2848/6 Prot, datë 29.12.2022 autoriteti përfitues AMF i ka dërguar CFCU dokumentacionin financiar dhe konfirmimin e marrjes së produktit “Raporti Final” nga firma përfituese C.F.L. sipas planit të punës së dakordësuar në kontratë për shumën 64,827 USD ku është paraqitur fatura me nr.2545, datë 22.12.2022, e cila është paguar më datë 18.01.2023. Vlera totale e paguar për këtë kontratë rezulton në 72,030 USD + 14,436 USD TVSH-ja = 86,436 USD.

***Nga grupi i auditimit konstatohet se në nenin 3. Payment të kontratës është parashikuar se klienti do ti paguajë konsulentit për këtë shërbim shumën e cila nuk duhet të kalojë 72,030 USD, ku në këtë shumë do përfshihen të gjitha kostot dhe fitimet e konsulentit si dhe çdo detyrim tatimor që mund ti lindë konsulentit. Nga auditimi rezulton se CFCU nuk ka bërë ndalesën e shumës së TVSH-së nga klienti, por e ka paguar jashtë vlerës së parashikuar në këtë kontratë, duke sjellë shpenzime pa efektivitet në shumën totale prej 14,436 USD.***

Për projektin: “Strengthening A. regulatory and supervisory function and Support in its Capital Market Development Efforts” kontrata është lidhur me konsulentin E. and Y.G, konsulenti ka detyrimin të prodhojë materialet si më poshtë:

Nr	Deliverables of activities	Delivery date
1	The consultant will prepare an Initiation Report which includes the work Plan and agree it with A....	2 weeks from the signing of the contracts
2	The consultant will agree with A... on list of bylaws to be drafted. A... considers as priority the following areas that need to be covered by the bylaws, as described in the capital markets laë.	7 months from the signing of the contracts
3	Deliverables under Group task 2 of activities: Further strengthen A.... risk based supervision	9 months from the signing of the contracts
4	Deliverables under Group task 3 of activities: Development of A..... capacity to monitor and supervise securities markets and investment funds	3 months from the signing of the contracts

5	Deliverables under Group task 3 of activities: Support to A.... on Capital Market Development Efforts	3 months from the signing of the contracts
---	---	--

Rezulton se me shkresën nr.2650 prot, datë 01.11.2022 autoriteti përfitues AMF i ka dërguar CFCU dokumentacionin financiar dhe konfirmimin e marrjes së produktit nr.1 nga firma përfituese E. and Y. G. sipas planit të punës së dakordësuar në kontratë për shumën 167,472 USD për të cilën është paraqitur fatura me nr.1, datë 22.09.2022, e cila është paguar më datë 10.11.2022.

Rezulton se me shkresën nr.2848/2 prot, datë 24.11.2022 autoriteti përfitues AMF i ka dërguar CFCU dokumentacionin financiar dhe konfirmimin e marrjes së produktit nr.2 nga firma përfituese E. and Y. G. sipas planit të punës së dakordësuar në kontratë për shumën 167,472 USD për të cilën është paraqitur fatura me nr.2, datë 17.11.2022, e cila është paguar më datë 12.12.2022.

Rezulton se me shkresën nr.2848/4 prot, datë 27.12.2022 autoriteti përfitues AMF i ka dërguar CFCU dokumentacionin financiar dhe konfirmimin e marrjes së produktit nr.3 nga firma përfituese E. and Y. G. sipas planit të punës së dakordësuar në kontratë për shumën 111,648 USD për të cilën është paraqitur fatura me nr.4, datë 07.12.2022, e cila është paguar më datë 13.01.2023.

Rezulton se me shkresën nr.2848/5 prot, datë 29.12.2022 autoriteti përfitues AMF i ka dërguar CFCU dokumentacionin financiar dhe konfirmimin e marrjes së produktit nr.4 nga firma përfituese E. and Y. G. sipas planit të punës së dakordësuar në kontratë për shumën 111,648 USD për të cilën është paraqitur fatura me nr.5, datë 07.12.2022, e cila është paguar më datë 19.01.2023.

Vlera totale e paguar për këtë kontratë rezulton në 558,243 USD + 111,649 USD TVSH-ja = 669,892 USD. Në përfundim të projektit "Fuqizimin e kapaciteteve mbikëqyrëse të AMF" rezulton se për këtë projekt nga vlera totale e grandit prej 990,000 USD është konsumuar shuma 23,272 euro + 766,379 USD.

***Nga auditimi i zbatimit të detyrimeve të konsulentit, parashikuar në seksionin 4 (Reporting, Schedule of Deliverables and Timing) të kontratës e cila është firmosur në datën 24.05.2021 midis konsulentit dhe AMF rezulton se konsulenti nuk ka zbatuar detyrimet për raportim sipas afateve të parashikuara për detyrat dhe afatet si më poshtë:***

Nr	Detyra	Afati i parashikuar	Afati max për raportim
1	The consultant will prepare an Initiation Report which includes the work Plan and agree it with A....	2 weeks from the signing of the contracts	9-Jun-21
2.1	2.i Licensig requirements for the followong a) Investment Firms b)Market Operators	7 months from the signing of the contracts	25-Dec-21
3.1	Report analyzing the needsregrading prudential reporting	9 months from the signing of the contracts	22-Feb-22
3.2	Report analyzing the enterprise risk management at A....	9 months from the signing of the contracts	22-Feb-22
4.1	i) Report analyzing enforcement needs of A.... and proposing appropriate models compatible to the Albania Legislation	3 months from the signing of the contracts	25-Aug-21
4.1	ii)preparation of Enforcement manual	7 months from the signing of the contracts	25-Dec-21
5.2	Technical note on Fintech challenges to A.... Cover dissmenations custos ( presentation workshop and materials)	5 months from the signing of the contracts	25-Oct-21

***Nga grupi i auditimit konstatohet se materialet dhe detyrat të cilat konsulentët duhet të përgatisin dhe të implementojnë kërkohen të jenë vetëm në gjuhën angleze, Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me VKLA Nr.4, datë 19.6.2017 "Për miratimin e rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të RSH", neni 4, pika 9 ku citohet se "Në rastin e komunikimit me institucione apo individë të huaj, dokumentet mund të përpilohen edhe në gjuhë të huaj. Në këtë rast nuk është nënshkruar kopja e dokumentit edhe në shqip si variant origjinal, fraksion i së cilës protokollohet kopja në gjuhë të huaj. "***

Rezulton se janë hartuar pasqyrat financiare të çertifikuara nga audituesi i jashtëm nga shoqëria G.T. SHPK.

Nga grupi i auditimit është audituar projekti i “**Zhvillimit të Kontabilitetit në Sektorin Publik**” ku përfitues është Ministria e Financave dhe Ekonomisë, projekt i cili ka filluar procedurën e prokurimit në 17.05.2018, është parashikuar të përfundojë në 30.06.2020, por është shtyrë me amendamentin nr.615, datë 20.10.2021 dhe ka përfunduar në dhjetor 2022, për këtë projekt janë lidhur gjithsej 5 kontrata ku implementimi i tyre ka përfunduar brenda vitit 2022.

NR	Emri I Projektit	Donatori	Përfituesi	Grant / Kredi	Vlera e projektit	Data e Fillimit	Data e mbarimit	Statusi
1	Zhvillimit te kontabilitetit ne Sektorin Publik	I.(W. B.) - fonde të S.	MFE	Grant	1,450,000	5/17/2018	12/31/2022	Mbyllur

Nga auditimi mbi dokumentacionin referuar pagesave të kryera, rezulton se:

Për këtë projekt është lidhur kontrata me Nr.1221/1 Prot, datë 19.12.2018 me konsulentin O.H, kontrata ka si objekt: “Local Project Coordinator”, kjo kontratë është shtyrë deri në datën 31.12.2022 me addendum no.2.

Nga auditimi rezulton se me shkresën Nr.451 Prot, datë 12.01.2021 autoriteti përfitues Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit i ka dërguar CFCU dokumentacionin financiar dhe konfirmimin e marrjes së produktit nga konsulenti O.H. për periudhën tetor-dhjetor 2020 sipas planit të punës së dakordësuar në kontratë për të cilën është paraqitur tabela përmbledhëse e shpenzimeve të rimbursueshme në vlerën 5,950 Euro, ku nga CFCU është bërë ndalesa 15% ose 895 Euro për pagesën e tatimit në burim të individit përfitues, pagesa është realizuar në datë 20.01.2021.

Në vijim me shkresën Nr.6857 Prot, datë 15.04.2021 autoriteti përfitues i ka dërguar CFCU dokumentacionin financiar dhe konfirmimin e marrjes së produktit nga konsulenti O.H. për periudhën janar-mars 2021 sipas planit të punës së dakordësuar në kontratë për të cilën është paraqitur tabela përmbledhëse e shpenzimeve të rimbursueshme në vlerën 5,270 Euro, ku nga CFCU është bërë ndalesa 15% ose 790 Euro për pagesën e tatimit në burim të individit përfitues, pagesa është realizuar në datë 30.04.2021.

Me shkresën Nr.866 Prot, datë 15.07.2021 autoriteti përfitues i ka dërguar CFCU dokumentacionin financiar dhe konfirmimin e marrjes së produktit nga konsulenti O.H. për periudhën prill-qershor 2021 sipas planit të punës së dakordësuar në kontratë për të cilën është paraqitur tabela përmbledhëse e shpenzimeve të rimbursueshme në vlerën 5,270 Euro, ku nga CFCU është bërë ndalesa 15% ose 790 Euro për pagesën e tatimit në burim të individit përfitues, pagesa është realizuar në datë 28.07.2021.

Me shkresën Nr.318 Prot, datë 10.01.2022 autoriteti përfitues i ka dërguar CFCU dokumentacionin financiar dhe konfirmimin e marrjes së produktit nga konsulenti O.H. për periudhën Korrik-Dhjetor 2021 sipas planit të punës së dakordësuar në kontratë për të cilën është paraqitur tabela përmbledhëse e shpenzimeve të rimbursueshme në vlerën 3,060 Euro, ku nga CFCU është bërë ndalesa 15% ose 459 Euro për pagesën e tatimit në burim të individit përfitues, pagesa është realizuar në datë 20.01.2022.

Me shkresën Nr.8487 Prot, datë 11.05.2022 autoriteti përfitues i ka dërguar CFCU dokumentacionin financiar dhe konfirmimin e marrjes së produktit nga konsulenti O.H. për periudhën janar-prill 2022 sipas planit të punës së dakordësuar në kontratë për të cilën është paraqitur tabela përmbledhëse e shpenzimeve të rimbursueshme në vlerën 6,970 Euro, ku nga CFCU është bërë ndalesa 15% ose 1,045 Euro për pagesën e tatimit në burim të individit përfitues, pagesa është realizuar në datë 17.05.2022.

Me shkresën Nr.16309 Prot, datë 02.09.2022 autoriteti përfitues i ka dërguar CFCU dokumentacionin financiar dhe konfirmimin e marrjes së produktit nga konsulenti O.H. për periudhën maj-gusht 2022 sipas planit të punës së dakordësuar në kontratë për të cilën është paraqitur tabela përmbledhëse e shpenzimeve të rimbursueshme në vlerën 6,970 Euro, ku nga CFCU është bërë ndalesa 15% ose 1,045 Euro për pagesën e tatimit në burim të individit përfitues, pagesa është realizuar në datë 28.09.2022.

Me shkresën Nr.20970 Prot, datë 14.11.2022 autoriteti përfitues i ka dërguar CFCU dokumentacionin financiar dhe konfirmimin e marrjes së produktit nga konsulenti O.H. për periudhën shtator-dhjetor 2022 sipas planit të punës së dakordësuar në kontratë për të cilën është paraqitur tabela përmbledhëse e shpenzimeve të rimbursueshme në vlerën 3,910 Euro, ku nga CFCU është bërë ndalesa 15% ose 586 Euro për pagesën e tatimit në burim të individit përfitues, pagesa është realizuar në datë 21.11.2022.

Me shkresën Nr.23707 Prot, datë 27.12.2022 autoriteti përfitues i ka dërguar CFCU dokumentacionin financiar dhe konfirmimin e marrjes së produktit nga konsulenti O.H. për periudhën nëntor-dhjetor 2022 sipas planit të punës së dakordësuar në kontratë për të cilën është paraqitur tabela përmbledhëse e shpenzimeve të rimbursueshme në vlerën 4,250 Euro, ku nga CFCU është bërë ndalesa 15% ose 637 Euro për pagesën e tatimit në burim të individit përfitues, pagesa është realizuar në datë 30.12.2022.

Nga auditimi mbi dokumentacionin referuar pagesave të kryera, rezulton se:

Për këtë projekt është lidhur kontrata me Nr.2650/1 Prot, datë 17.12.2018 me konsulentin Th. Ch.I. of P.F. and A. (C.) in Joint Venture woth A.L, kontrata ka si objekt: "Development of Professional Accounting Skills and Sustainable Public Sector Accounting training mechanism", kjo kontratë është shtyrë deri në datën 31.12.2022 me addendum no.2.

Nga auditimi rezulton se me shkresën Nr.12308 Prot, datë 07.07.2021 autoriteti përfitues Ministria e Financave, nëpërmjet nënpunësit të autorizuar znj. A.Xh. i ka dërguar CFCU dokumentacionin financiar dhe konfirmimin e marrjes së produktit nga konsulenti Th.Ch.I. of P.F. and A. (C.) in Joint Venture woth A.L, sipas planit të punës së dakordësuar në kontratë për të cilën është paraqitur fatura nr.1 e shpenzimeve të rimbursueshme në vlerën 42,042 USD me TVSH, pagesa është realizuar në datë 28.07.2021.

Me shkresën Nr.7719 Prot, datë 27.04.2022 autoriteti përfitues Ministria e Financave, nëpërmjet nënpunësit të autorizuar znj. A.Xh. i ka dërguar CFCU dokumentacionin financiar dhe konfirmimin e marrjes së produktit nga konsulenti Th.Ch.I.of P.F. and A.(C.) in Joint Venture woth A.L, sipas planit të punës së dakordësuar në kontratë për të cilën është paraqitur fatura nr.3/2022 e shpenzimeve të rimbursueshme në vlerën 63,063 USD me TVSH, pagesa është realizuar në datë 21.06.2022.

***Nga grupi i auditimit konstatohet se për fazën e dytë të implementimit të projektit nuk është plotësuar kushti 2.3 i kontratës për detyrën: "Deliver the training on I... deep dive and training of trainers (120 hours for 25 person)". Në dosjes e paraqitur si dhe në materialet të cilat gjenden në CD nuk gjendet listëprezenca e pjesëmarrësve më nënshkrimin përkatës.***

Me shkresën Nr.18597/1 Prot, datë 13.10.2022 autoriteti përfitues Ministria e Financave, nëpërmjet nënpunësit të autorizuar znj. A.Xh. i ka dërguar CFCU dokumentacionin financiar dhe konfirmimin e marrjes së produktit nga konsulenti Th.Ch. I. of P.F. and A. (C.) in Joint Venture woth A.L, sipas planit të punës së dakordësuar në kontratë për të cilën është paraqitur fatura nr.4/2022 e shpenzimeve të rimbursueshme në vlerën 126,126 USD me TVSH, pagesa është realizuar në datë 21.11.2022.

***Nga grupi i auditimit konstatohet se për fazën e tretë të implementimit të projektit nuk është plotësuar kushti 3.3 i kontratës për detyrën: "Train 100 public accountants from central government (4 groups with 25 persons, 80 hours each group)". Në dosjen e paraqitur si dhe në materialet të cilat gjenden në CD nuk gjendet listëprezenca e pjesëmarrësve më nënshkrimin përkatës.***

Me shkresën Nr.23637 Prot, datë 27.12.2022 autoriteti përfitues Ministria e Financave, nëpërmjet nënpunësit të autorizuar znj. A.Xh. i ka dërguar CFCU dokumentacionin financiar dhe konfirmimin e marrjes së produktit nga konsulenti Th.Ch.I. of P.F. and A. (C.) in Joint Venture with A.L, sipas planit të punës së dakordësuar në kontratë për të cilën është paraqitur fatura nr.5/2022 e shpenzimeve të rimbursueshme në vlerën 310,072 USD me TVSH, pagesa është realizuar në datë 26.01.2023.

***Nga grupi i auditimit konstatohet se për fazën e pestë të implementimit të projektit nuk është plotësuar kushti 5.2 i kontratës për detyrën: "5 day training with focus in financial reporting and I. with a train of trainer approach for 10 persons " dhe kushti 5.3 i kontratës për detyrën "10 day training with focus in financial reporting and I. with a train of trainer approach for the assigned staff of Accounting Department in the UT and UBT". Në dosjen e paraqitur si dhe në materialet të cilat gjenden në CD nuk gjendet listëprezenca e pjesëmarrësve më nënshkrimin përkatës.***

Nga auditimi mbi dokumentacionin referuar pagesave të kryera, rezulton se:

Për këtë projekt është lidhur kontrata me Nr.2092/1 Prot, datë 20.07.2020 me konsulentin E. B., kontrata ka si objekt: "The Translation of the International Accounting Standarts for Public Sector". Nga auditimi rezulton se me shkresën Nr.120 Prot, datë 06.01.2021 autoriteti përfitues Ministria e Financave, nëpërmjet Koordinatorit të Kontratës znj. I.M. i ka dërguar CFCU dokumentacionin financiar dhe konfirmimin e marrjes së produktit nga konsulenti E.B. sipas planit të punës së dakordësuar në kontratë për të cilën është paraqitur fatura nr.1 e shpenzimeve të rimbursueshme në vlerën 607 Euro, pagesa është realizuar në datë 20.01.2021. Kjo kontratë me kërkesën e kontraktorit është ndërprerë në datën 26.01.2021. Vijimi i detyrës së përkthimit ka vijuar me lidhjen e kontratës me Nr.511/1 Prot, datë 18.05.2021 me konsulentin K. K, kontrata ka si objekt: "The Translation of the International Accounting Standarts for Public Sector".

Nga auditimi rezulton se me shkresën Nr.23169 Prot, datë 23.12.2021 autoriteti përfitues Ministria e Financave, nëpërmjet Koordinatorit të Kontratës znj. I. M. i ka dërguar CFCU dokumentacionin financiar dhe konfirmimin e marrjes së produktit nga konsulenti K.K. sipas planit të punës së dakordësuar në kontratë për të cilën është paraqitur fatura nr.1 e shpenzimeve të rimbursueshme në vlerën 2,087 Euro, pagesa është realizuar në datë 03.03.2022. ***Nga grupi i auditimit konstatohet se pagesa është realizuar jashtë afateve të përcaktuara në seksionin D të kontratës ku parashikohet se pagesa do të bëhet brenda 30 ditëve nga data e dorëzimit të materialit nga konsulenti.***

Me shkresën Nr.22473 Prot, datë 07.12.2022 autoriteti përfitues Ministria e Financave, nëpërmjet Koordinatorit të Kontratës znj. I.M. i ka dërguar CFCU dokumentacionin financiar dhe konfirmimin e marrjes së produktit nga konsulenti K.K. sipas planit të punës së dakordësuar në kontratë për të cilën është paraqitur fatura nr.2 e shpenzimeve të rimbursueshme në vlerën 8,351 Euro, pagesa është realizuar në datë 28.12.2022.

Nga auditimi mbi dokumentacionin referuar pagesave të kryera, rezulton se:

Për këtë projekt është lidhur kontrata me Nr.2093/1 Prot, datë 20.07.2020 me konsulentin A. Xh, kontrata ka si objekt: “The Review of the International Accounting Standarts for Public Sector (IPSAS)”.

Nga auditimi rezulton se me shkresën Nr.23168 Prot, datë 23.12.2021 autoriteti përfitues Ministria e Financave, nëpërmjet Koordinatorit të Kontratës znj. I.M. i ka dërguar CFCU dokumentacionin financiar dhe konfirmimin e marrjes së produktit nga konsulenti A.Xh. sipas planit të punës së dakordësuar në kontratë për të cilën është paraqitur fatura nr.1 e shpenzimeve të rimbursueshme në vlerën 1,147 USD, pagesa është realizuar në datë 26.01.2022.

Me shkresën Nr.23636 Prot, datë 23.12.2022 autoriteti përfitues Ministria e Financave, nëpërmjet Koordinatorit të Kontratës znj. I.M. i ka dërguar CFCU dokumentacionin financiar dhe konfirmimin e marrjes së produktit nga konsulenti A.Xh. sipas planit të punës së dakordësuar në kontratë për të cilën është paraqitur fatura nr.1 e shpenzimeve të rimbursueshme në vlerën 2,677 USD, pagesa është realizuar në datë 30.12.2022.

Nga auditimi mbi dokumentacionin referuar pagesave të kryera, rezulton se:

Për këtë projekt është lidhur kontrata me Nr.2830 Prot, datë 31.12.2020 me konsulentin P.C.C, kontrata ka si objekt: “Technical Assistance for IPSAS Implementation”, kjo kontratë është shtyrë deri në datën 31.12.2022 me addendum no.1.

Nga auditimi rezulton se me shkresën Nr.12308 Prot, datë 07.07.2021 autoriteti përfitues Ministria e Financave, nëpërmjet nënpunësit të autorizuar znj. A.Xh. i ka dërguar CFCU dokumentacionin financiar dhe konfirmimin e marrjes së produktit nga konsulenti P.C.C. sipas planit të punës së dakordësuar në kontratë për të cilën është paraqitur fatura nr.141/2021 e shpenzimeve të rimbursueshme në vlerën 91,631 USD me TVSH, pagesa është realizuar në datë 17.09.2021.

Me shkresën Nr.18485 Prot, datë 07.10.2022 autoriteti përfitues Ministria e Financave, nëpërmjet nënpunësit të autorizuar znj. A.Xh. i ka dërguar CFCU dokumentacionin financiar dhe konfirmimin e marrjes së produktit nga konsulenti P.C.C. sipas planit të punës së dakordësuar në kontratë për të cilën është paraqitur fatura nr.555/2022 e shpenzimeve të rimbursueshme në vlerën 114,539 USD me TVSH, pagesa është realizuar në datë 20.10.2022.

***Nga grupi i auditimit konstatohet se për fazën e dytë të implementimit të projektit nuk është plotësuar kushti 3.2.11 i kontratës për detyrën: "1 day workshop woth a selected group auditors 15-20 persons". Në dosjes e paraqitur si dhe në materialet të cilat gjenden në CD nuk gjendet listëprezenca e pjesëmarrësve më nënshkrimin përkatës.***

Me shkresën nr.23906 Prot, datë 30.12.2022 autoriteti përfitues Ministria e Financave, nëpërmjet nënpunësit të autorizuar znj. A.Xh. i ka dërguar CFCU dokumentacionin financiar dhe konfirmimin e marrjes së produktit nga konsulenti P.C.C. sipas planit të punës së dakordësuar në kontratë për të cilën është paraqitur fatura nr.913/2022 e shpenzimeve të rimbursueshme në vlerën 114,540 USD me TVSH dhe fatura nr.998/2022 e shpenzimeve të rimbursueshme në vlerën 137,448 USD me TVSH, pagesa është realizuar në datë 25.01.2023 për shumën 225,482USD.

Me shkresën nr.24181 Prot, datë 30.12.2022 autoriteti përfitues Ministria e Financave, nëpërmjet nënpunësit të autorizuar znj. A.Xh. i ka dërguar CFCU dokumentacionin financiar dhe konfirmimin e marrjes së produktit nga konsulenti P.C.C. sipas planit të punës së dakordësuar në kontratë për të cilën është paraqitur fatura nr.4/2023 e shpenzimeve të rimbursueshme në vlerën 50,000 USD me TVSH dhe fatura nr.5/2023 e shpenzimeve të rimbursueshme në vlerën 40,000 USD me TVSH, pagesa është realizuar në datë 25.01.2023 për shumën 116,505 USD.

Rezulton se janë hartuar pasqyrat financiare të çertifikuara nga audituesi i jashtëm nga shoqëria G.Th. SHPK.

**\*\*\* Si përfundim, pavarësisht se projekti i “Zhvillimit të Kontabilitetit në Sektorin Publik”, ku përfitues është Ministria e Financave dhe Ekonomisë, i cili ka filluar procedurën e prokurimit në 17.05.2018, është parashikuar të përfundojë në 30.06.2020, por është shtyrë me amendamentin nr.615, datë 20.10.2021 dhe ka përfunduar në dhjetor 2022, për të cilin janë lidhur gjithsej 5 kontrata ku implementimi i tyre ka përfunduar brenda vitit 2022, përgjatë fazës së auditimit në terren dhjetor 2024, rezulton se akoma nuk ka një produkt final për implementim dhe zbatimin në praktik të Standarteve të Kontabilitetit në Sektorin Publik.**

**Personat që mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre:**

Znj. V. K, në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm.

Znj. D. G, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit Financiar dhe Kontabilitetit.

Znj. A. D, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Prokurimeve.

Për sa është trajtuar në Projektraportin e auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me Nr.53/1 Prot dhe datë 06.01.2025, protokolluar në KLSH me Nr.1097/5 Prot., datë 10.02.2025, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:** I. Nisur nga gjetja e paraqitur në draft-raport është kryer verifikimi dhe analiza nga ana jonë, në përfundim të së cilën konkludojmë se:

1. “Task 2 - Gap analysis from project deliverables and recommendation of best solutions or changes, as well as other professional assistance as per requirement” nuk është përfshirë në kontratën me konsulentin A.K.A.

2. Në kushtet kur nuk kemi të dokumentuar ndonjë kërkesë nga përfituesi për ndryshim apo rishikim të objektivave të kontratës, mos përfshirja e “Task-2” rezulton të jetë një gabim njerëzor gjatë përgatitjes së kontratës.

3. Mungesa e “Task 2” nuk është materializuar në impakt financiar negativ pasi konsulentja është paguar vetëm për angazhimin e saj dhe produktet e konfirmuara nga AMF-ja, në cilësinë e Institucionit përfitues të kontratës.

4. Projekti për “Fuqizimin e kapaciteteve mbikëqyrëse të AMF”, në kuadër të së cilit është lidhur kjo kontratë, është mbyllur më 31.12.2022 dhe në qershor, 2023, Banka Botërore ka bërë publik raportin final të rezultateve të projektit “Implementation Completion and Results Report”. Në këto kushte, është e pamundur të bëhet rivlerësimi rektroaktiv i objektivave të pa përmbushura të kontratës fillestare apo integrimi në kontrata ekzistuese.

Në përmbushje të rekomandimit, për të shmangur gabime të tilla në të ardhmen, CFCU angazhohet të marrë masa për trajnimin e vazhdueshëm të stafit përgjegjës për përgatitjen e kontratave.

**II.** CFCU, në përputhje me Manualin Operacional të Projektit, në seksionin “I. Komunikimi dhe dokumentacioni zyrtar”, ku në paragrafin e parë përcaktohet se: “Email-i do të shërbejë si mjete kryesor i komunikimit zyrtar ndërmjet GDFC-së, përfituesve, BB-së dhe tenderuesve/kontraktorëve për zbatimin e procedurave të prokurimit, kontraktimit, menaxhimit financiar dhe monitorimit” ka pranuar njoftimin për ndërprerjen e kontratës me email-in e datës 3.8.2022 nga ana e konsulentit A.K.A. Ky komunikim është administruar nga Sektori i Prokurimit, përgjegjës për hartimin/ndryshimet e kontratave, dhe jo nga Sektori i Menaxhimit Financiar. Në përmbushje të rekomandimit dosja që administrohet nga Menaxhimi Financiar është plotësuar tashmë me komunikimin e lartpërmendur. Në vijimësi dokumentacioni justifikues për ndryshimet apo ndërprerjet e kontratave do të administrohet edhe në dosjet përkatëse të Sektorit të Menaxhimit

Financiar. Në përputhje me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”, CFCU do të vijojë procesin e nisur për inventarizimin e dosjeve të projekteve.

**III.** CFCU ka kompetenca të kufizuara për veprim gjatë fazës së zbatimit të kontratës, pasi ky është një proces që realizohet/monitorohet nga Përfituesi. CFCU në rastet e tejkalimit të afateve të parashikuara në kontratë për dorëzimin e produkteve, alerton dhe kërkon informacion nëpërmjet komunikimeve të vazhdueshme me email me koordinatorët e kontratave. Gjatë procesit të përgatitjes së kontratave, përdoren modele standarde për çdo tipologji kontrate, sipas përcaktimeve të standardizuara nga Banka Botërore (BB). CFCU në rolin e institucionit të besuar për ndjekjen e procedurave të prokurimit sipas rregullave të BB-së, të cilat janë qartësisht të përcaktuara në marrëveshjet financiare të nënshkruara midis Bankës Botërore dhe Republikës së Shqipërisë, nuk ka mundësi të modifikoj modelin standard të paracaktuar të kontratës. Për të ilustruar këtë, ju bashkëlidhim përgjigjen e dërguar nga BB në rastin kur, gjatë procesit të negociatave për një kontratë, konsulentët/kontraktorët kërkojnë të modifikojnë nenet e kontratës. Sipas këtij komunikimi, theksohet se: *“Kërkesa e konsulentit për të modifikuar nenet e kontratave standarde të përdorura për veprimtari të financuara nga Banka nuk mund të pranohen. Dispozitat standarde të kontratës janë miratuar nga departamenti ligjor i Bankës dhe agjencitë zbatuese lejohen vetëm të modifikojnë ato nene që i referohen objektit të projektit/kontratës. Detyrimet në lidhje me përfundimin, auditimin, përgjegjësitë etj. janë të zbatueshme në mënyrë uniforme për këtë formë të kontratës e cila është nën 300,000 USD.”* Për sa më sipër CFCU angazhohet të sigurojë ndjekjen rigorozë të afateve të përcaktuara në kontratë për raportimin e detyrave nga konsulente dhe të bashkëveprojë për përfituesit për çdo vonesë të identifikohet menjëherë në mënyrë që të merren masa të përshtatshme, por nuk mundet të angazhohet për të parashikuar penalitete financiare në kontratat e ardhshme.

**IV.** CFCU, për të gjitha komunikimet shkresore me institucionet e huaja dhe konsulentët/kontraktorët, përgatit gjithashtu një kopje në gjuhën shqipe, e cila administrohet nga zyra e protokollit. Përkthimi i kontratave kërkon specialist të autorizuar në fushën përkatëse për të kryer këtë proces. Gjithashtu, ky proces do të sillte një kosto shtesë, për të cilën nuk ka një buxhet të dedikuar nga fondet e projekteve ose nga buxheti i Institucionit. Në vijimësi, CFCU, në dakordësi me institucionet përfituese, do të sigurohet që për kontratat e reja të parashikohet që, në momentin e hartimit të termave të referencës, të përfshihet detyrimi për konsulentët/kontraktorët për të dorëzuar raportet dhe produktet në gjuhën shqipe dhe në anglisht.

**V.** CFCU ka detyrim verifikimit dhe sigurimit e përmbushjes të gjitha kushteve për pagesë, para se të kryejë ekzekutimin e pagesës. Në seksioni D të kontratës në gjetje (me konsulentin K. K.) përcaktohet se *“Pagesa do të bëhet në EURO jo më vonë se 30 ditë pas dorëzimit të faturave në dy kopje te Koordinatori i caktuar në paragrafin 4.”* Në rastin e trajtuar ka patur pasaktësi të faturës së dorëzuar nga konsulenti. Pas dorëzimit së faturës të saktë dhe aprovimit më datë 01.03.2022 nga ana e Koordinatorit të kontratës, është kryer pagesa më datë 03.03.2022. CFCU angazhohet që në vijim, për të siguruar gjurmë auditimi të qartë për projektet e reja do të shtohet një parashikim në Manualin Operacional përkatëse për pezullimin e afatit kohor për ekzekutimin e pagesave deri në momentin e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm (faturë, produkte/materiale etj). Gjithashtu, CFCU do të ketë vëmendje të shtuar në respektimin e afateve kohore në kryerjen e pagesave duke mbajtur komunikime të vazhdueshme me koordinatorët e kontratave dhe/ose me konsulentët/kontraktorët në rastet kur praktikata e dorëzuara për pagesë kanë mangësi.

**VI.** Sa rekomandohet e tejkalon tagrin e CFCU-së. Në Manualin Operacional të projektit - Seksioni II. *“Organizimi i Projektit”*, Pika 1. *“Strukturat e Qeverisë dhe përgjegjësitë e tyre”*, përcaktohet në mënyrë të qartë se *‘Përgjegjësia për zbatimin e projektit do të jetë e Ministrisë së Financave*



*dhe Ekonomisë.*, ndërkohë që për CFCU-në parashikohet se: 'Aspektet fiduciary që përfshijnë prokurimin dhe menaxhimin financiar, do të trajtohen nga Njësia Qendrore e Financave dhe Kontraktimit (CFCU) në MFE.' CFCU bazuar në rolin e përcaktuar në marrëveshje dhe në Manualin Operacional të Projektit sigurohet nga strukturat përgjegjëse për zbatimin e Projektit që kushtet janë plotësuar sipas parashikimeve të kontratave. Në rastin konkret, duke qenë se në detyrimet e parashikuara në kontratë për kontraktorin nuk ka qenë e specifikuar dorëzimi i listë pjesëmarrësve me nënshkrimet përkatëse, CFCU ka pasur mjaftueshëm elementë në dispozicion për kryerjen e aktivitetit (certifikata pjesëmarrje, foto, listat e pjesëmarrësve, konfirmimi dhe miratimi i Përfituesit), ndaj bazuar në dokumentacionin e paraqitur, ka vijuar me pagesat sipas kushteve të kontratës. Gjithsesi në vijim, në rastet e kontratave të ngjashme që parashikojnë realizimin e trajnimeve, duke marrë për referencë këtë raport, CFCU do të marrë masa për të njoftuar përfituesit dhe koordinatorët e kontratave për përfshirjen e listave të pjesëmarrësve dhe nënshkrimet përkatëse si pjesë e dokumentave provuese. Projekti për “Zhvillimit të kontabilitetit në Sektorin Publik” është mbyllur më 31.12.2022 dhe në Gusht, 2023, Banka Botërore ka bërë publik raportin final të rezultateve të projektit “Implementation Completion and Results Report” për këtë arsye, është e pamundur të realizohen sërish aktivitetet dhe të plotësohet dokumentacioni me listat e pjesëmarrësve. Për sa i përket përmbushjes së objektivave të kontratave, ky proces bazohet në konfirmimin dhe aprovimin e Institucionit Përfitues.

**VII.** Në gërmën a), të pikës 2.05 “*Monitorimi i Projektit, raportimi dhe vlerësimi*”, të Nenit 2 “*Zbatimi i Projektit*”, të VKM nr. 251, datë 9.5.2018, “*Për miratimin e letër marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Botërore për Rindërtimin dhe Zhvillim, që vepron si administratore e fondeve grant të siguruara nga Sekretariati Shtetit për Çështjet Ekonomike (SECO) të qeverisë Zviceriane, nën fondin e besimit me shumë donatorë, për fuqizimin e kontabilitetit dhe të mjedisit të mirëbesimit në Evropën Jugore dhe Azinë Qendrore, për Projektin e Zhvillimit të Kontabilitetit në Sektorin Publik*”, parashikohet se a) Marrësi, nëpërmjet PIT-it, do të monitorojë dhe vlerësojë progresin e Projektit dhe do të përgatisë raportet e Projektit në përputhje me dispozitat e seksionit 2.06 të kushteve standarde dhe mbi bazën e treguesve të pranueshëm për Bankën Botërore. CFCU nuk ka kompetenca dhe instrumentat për të identifikuar nëse nuk ka një produkt final për implementim dhe zbatimin në praktik të Standarteve të Kontabilitetit në Sektorin Publik, pasi kjo vlerësohet nga Përfituesi dhe Banka Botërore / Donatori. Në vijim, CFCU mund vetëm të përcjellë në formë shkresore pranë Ministrisë së Financave gjetjen dhe rekomandimin për vlerësimin nga ana e tyre të masave të mëtejshme sipas rastit.

**VIII.** Bazuar në marrëveshjen financiare midis Bankës Botërore dhe Republikës së Shqipërisë, AMF është institucioni përgjegjës për realizimin e projektit. CFCU gjatë procesit të përgatitjes së kontratave përdor modele standarde për çdo tipologji kontrate, sipas përcaktimeve të standardizuara nga Banka Botërore (BB). CFCU-së në rolin institucionit të besuar për ndjekjen e procedurave të prokurimit sipas rregullave të BB-së, qartësisht të përcaktuar në marrëveshjet financiare nuk i lejohej të kryej modifikim të modelit standard të paracaktuar të kontratës. Për të mbështetur këtë, bashkëlidhur gjeni përgjigjen e dërguar nga BB në rastin kur, gjatë procesit të negociatave për kontratat, konsulentët/kontraktorët kërkojnë të modifikojnë nenet e kontratës. Sipas këtij komunikimi, theksohet se: “*Kërkesa e konsulentit për të modifikuar nenet e kontratave standarde të përdorura për veprimtari të financuara nga Banka nuk mund të pranohen. Dispozitat standarde të kontratës janë miratuar nga departamenti ligjor i Bankës dhe agjencitë zbatuese lejohen vetëm të modifikojnë ato nene që i referohen objektit të projektit/kontratës. Detyrimet në lidhje me përfundimin, auditimin, përgjegjësitë etj. janë të zbatueshme në mënyrë uniforme për këtë formë të kontratës e cila është nën 300,000 USD.*” Projekti për “Fuqizimin e kapaciteteve

mbikëqyrëse të AMF”, në kuadër të së cilit janë lidhur këto kontrata, është mbyllur më 31.12.2022 dhe në Qershor, 2023, Banka Botërore ka bërë publik raportin final të rezultateve të projektit “Implementation Completion and Results Report”. Në këto kushte, është e pamundur të bëhet rivlerësimi rektroaktiv i objektivave të pa përmbushura të kontratës fillestare apo integrimi në kontrata ekzistuese.

**IX.** Projekti për “Fuqizimin e kapaciteteve mbikëqyrëse të AMF”, në kuadër të së cilit janë lidhur këto kontrata, është mbyllur më 31.12.2022 dhe në Qershor, 2023, Banka Botërore ka bërë publik raportin final të rezultateve të projektit “Implementation Completion and Results Report”. Në këto kushte, është e pamundur të bëhet rivlerësimi rektroaktiv i objektivave të pa përmbushura të kontratës fillestare apo integrimi në kontrata ekzistuese. Bazuar në faktin që kontraktorët janë paguar për kohën e angazhimit të tyre dhe për produktet e realizuara e të pranuar nga Klienti (AMF si institucion përfitues) gjithashtu edhe në dokumentin kontraktual që rregullon marrëdhënien midis palëve, nuk ka hapësira ligjore për rikuperuar shumat e lart përmendura.

**X.** CFCU i ka paguar C.F.L. vetëm vlerën e dakordësuar midis palëve gjatë procesit të negociimit të kontratës. Gjatë këtij procesi është pranuar oferta finale e C.F.L. në shumën prej 72,030 USD pa taksa. Vlera e TVSH-së në shumën 14,406 USD e llogaritur mbi vlerën e tatueshme prej 72,030 është transferuar nëpërmjet mekanizmit të reverse-charge (në këtë rast, për shkak të afatit të shkurtër në dispozicion të zbatimit të kontratës 17.11.2022–31.12.2022, si zgjidhje ad hoc shuma e TVSH-së i paguhet autoritetit tatimor përgjegjës nga CFCU duke aplikuar procedurën e reverse-charge) nga llogaria e projektit në llogarinë e buxhetit të shtetit të dedikuar për mbledhjen e tatimeve dhe taksave. Vlera e TVSH-së në favor të buxhetit shtetit është paguar nga fondet e pa përdorura të Projektit. Këto fonde në të kundërt do ti ktheheshin Bankës Botërore dhe nuk do të mund të përdreshin për aktivitete të tjera për shkak të mbylljes së Projektit. Paqartësia e nenit 3 është rezultat i një gabimi njerëzor gjatë përpilimit të kontratës. Në vijim CFCU do të marrë masa për trajnimin e stafit dhe vëmendje të shtuar gjatë procesit të përgatitjes së kontratave.

**XI.** CFCU nuk mund të vijojë me praktika ligjore për të rikuperuar nga kontraktori shumën e TVSH-së prej 14,406 \$ pasi kjo shumë është paguar në favor të organeve tatimore të Republikës së Shqipërisë dhe jo kontraktorit. Kontrata dhe Projekti në tërësi konsiderohet i mbyllur me raportin final të hartuar nga Banka Botërore ndaj nuk mund të ndërmerren masa me retroaktivitet.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** *Nga shqyrtimi i observacioneve të fazës së projektraportit të auditimit, sqarojmë se nuk paraqesin kundërshtim të argumentuar me arsyetim dhe bazë ligjore ose të mbështetur me dokumentacion të ri justifikues ndryshe nga ajo që është paraqitur në fazën e auditimit në teren, në lidhje me problematikat e konstatuara dhe gjetjet e grupit të auditimit, por kërkojnë modifikimin e rekomandimeve. Sa më sipër, vijohet të mbahet i njëjti qëndrim, observacioni nuk merret në konsideratë.*

## **2.2 Vlerësim mbi përputhshmërinë e aktivitetit të Drejtorisë së Menaxhimit të Prokurimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së.**

Drejtorja e Menaxhimit të Prokurimeve dhe Kontraktimeve për fondet e BE-së është pjesë e Drejtorisë së Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve (CFCU). Kjo Drejtori ka si mision garantimin e menaxhimit efektiv dhe eficient të procedurave të tenderimit, kontraktimit dhe zbatimit të kontratave të financuara nga fondet e Instrumentit për Ndihmën e Para-Aderimit (IPA). Në kuadër të këtij misioni, sigurimit të një sistemi efektiv të kontrollit të brendshëm si dhe një ndarje të qartë funksionesh, procesesh e përgjegjësish, krijimi i kësaj Drejtorie është shoqëruar me hartimin e bazës ligjore si dhe me ngritjen e strukturave përkatëse në Institucionet Përfituese të fondeve IPA.

Nga auditimi i strukturës organizative të CFCU për drejtoritë e lidhura me menaxhimin e IPA-s, rezultojnë me mungesë si vijojnë:

- Sektori për Përgatitjen e Dokumenteve të Prokurimit për fondet e BE-së - Pozicioni i *Përgjegjësit të Sektorit dhe 4 Specialistë* (është vakant prej miratimit të strukturës së re, pra më tepër se 6 muaj).
- Sektorin për Vlerësimin dhe Kontraktimin e IPA -1 *Specialist*
- Sektorin për Monitorimin e Kontratave: 4 *Specialistë*  
*Drejtoria për Sigurimin e Cilësisë dhe Kontrollin e Brendshëm:*
- *Sektori për Kontrollin e Brendshëm dhe çështjet ligjore: 1 Specialist*
- *Sektori për Kontrollin e Cilësisë: 2 Specialistë*  
Drejtoria për Menaxhimin Financiar IPA
- Sektori për Menaxhimin Financiar IPA dhe Kontabilitetin: 1 *Specialist*

Referuar strukturës organizative të CFCU për drejtoritë e lidhura me menaxhimin e IPA-s, nga auditimi rezulton se Sektori “*Për monitorimin e kontratave*” përbëhet nga Përgjegjësi i Sektorit dhe 1 specialist, 4 vende të tjera janë vakante, gjithashtu në Sektorin për Përgatitjen e Dokumentave të Prokurimit për fondet e BE-së mungon Përgjegjësi i Sektorit, që prej miratimit të strukturës së re pra për një periudhë kohore më të gjatë se 6 muaj dhe 4 specialistë. Vakanca të tjera ka në Sektorin për Vlerësimin dhe Kontraktimin e IPA ku mungon 1 specialist. Në Drejtorinë për Sigurimin e Cilësisë dhe Kontrollin e Brendshme mungon 1 specialist, në Sektorin për Kontrollin e Brendshëm dhe çështjet ligjore dhe 2 specialistë në Sektorin për Kontrollin e Cilësisë. Gjithashtu në Drejtorinë për Menaxhimin Financiar IPA mungon 1 specialist. Rrjedhimisht për vitin 2024 rezulton se, Drejtoria e Menaxhimit të Prokurimeve dhe Kontraktimeve për fondet e BE-së operon me 14 punonjës më pak. *Mbajtja e një numri relativisht të lartë vakancash (konkretisht 30% e stafit total) çënon ngarkesën e drejtë për secilin nëpunës, sigurimin e mbarëvajtjes së punës në këtë drejtori si dhe arritjen e objektivave të saj. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Urdhër nr. 59, datë 18.04.2024 ku përcaktohet se numri total i punonjësve të CFCU do të ishte 48 veta.*

Nga auditimi rezulton se, përgjegjësitë e punës së Burimeve Njerëzore i mbulon një specialiste pranë Drejtorisë për Sigurimin e Cilësisë dhe Kontrollin e Brendshëm në Sektorin për Kontrollin e Brendshëm dhe Çështjet Ligjore, detyrim i cili buron nga përshkrimet e punës, konkretisht formulari i përshkrimit të punës, Sektori për Kontrollin e Brendshëm dhe Çështjet Ligjore pika V, c.7, c.8, c.9, d, d.1. Përgjegjësitë e pozicionit të Punonjësit të Protokollit në këtë drejtori mbulohet nga një punonjës me kontratë pune, sipas VKM-së nr. 39, datë 24.01.2024 “*Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2024, në njësitë e qeverisjes qendrore*”. Sipas kësaj VKM, për CFCU janë parashikuar 3 specialistë me kohë mesatare/ditore 6 orë në ditë.

Në Urdhrin nr. 213, datë 30.07.2018 të Ministrit të Financave “Për funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, Drejtorisë së përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorë të tjerë si dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të taksës së Pasurisë”, thuhet se “*Të gjithë shërbimet mbështetëse dhe transaksionet financiare të tyre do të mbulohen nga aparati i MFE, deri në krijimin e njësisë së shërbimeve mbështetëse në strukturat organike të këtyre drejtorive*”. Deri në përfundim të periudhës së auditimit, 6 vite pas urdhrin të sipërcituar, nuk rezulton të jetë krijuar kjo strukturë pranë CFCU. Shërbimet mbështetëse dhe transaksionet financiare kryhen ende nga MFE. Kjo bie në kundërshtim me VKM nr. 893 datë 17.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse,*

të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm” e ndryshuar me VKM 520 datë 07.09.2023 “Për disa ndryshime në Vendimin nr.893 datë 17.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullave të Organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm” pika 27. Konkretisht: *Në çdo institucion i cili ka të paktën 15 pozicione pune duhet të ketë të paktën një pozicion të dedikuar për funksionet e lidhura me financat e institucionit.*

Rregullorja për funksionimin e Drejtorisë është miratuar me Urdhër nr.146 datë 11.06.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve për fondet e BE, BB dhe donatorëve të tjerë”. Nga auditimi rezulton se ndryshimet e sipërcituara nuk janë reflektuar në Rregulloren e Brendshme të Institucioni. Gjithashtu përshkrimet e punës janë sipas rregullores së mëparshme dhe nuk gjejnë reflektim pozicionet e reja të krijuara sipas strukturës së re. *Këto veprime bien në kundërshtim me Ligjin nr.10296 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 9 pika 4 a dhe f.*

### **Menaxhimi i projekteve të financuara me fonde IPA**

#### ***- Mbi përputhshmërinë lidhur me planifikimin e prokurimit deri në kontraktimin final***

Shqipëria përfiton prej Instrumentit të Asistencës për Anëtarësim (IPA) të Bashkimit Evropian që prej vitit 2007, respektivisht IPA I (periudha 2007 - 2013), IPA II (periudha 2014 - 2020) dhe së fundmi IPA III (periudha 2021 - 2027), për të cilin janë nënshkruar tashmë marrëveshjet financiare. CFCU është e përfshirë në rolin e autoritetit kontraktues nën menaxhimin indirekt të IPA (IMBC).

**Drejtoria e Menaxhimit të Projekteve IPA** ka pasur në objekt të punës për vitet 2021 - 6 mujor 2024 projektet dhe nënprojektet e miratuar për financim nga Marrëveshjet Financiare të 5 programeve kombëtare si më poshtë:

Marrëveshja	Vlera e Buxhetuar Në mijë Euro	Vlera e kontraktuar në mijë Euro	Përthithje nga kontraktimi i në mijë Euro	Vlera e paguar në mijë Euro	Përthithje nga pagesat në mijë Euro <sup>2</sup>	Afati i kontraktimit	Afati përfundimtar i implementimit
1. Marrëveshja Financiare per IPA 2014	16,300,000	14,688,607.1	90%	12,488,975.4	85%	11.12.2018	11.12.2022
2. Marrëveshja Financiare per IPA 2015	14,200,000	9,813,877.84	69%	9,209,657.15	94%	29.09.2021	29.09.2022
3. Marrëveshja Financiare per IPA 2017	1,850,000	1,829,262.39	99%	1,698,613.74	93%	30.03.2021	30.03.2024
4. Marrëveshja Financiare per IPA 2019	2,000,000	2,000,000	100%	1,472,324.43	74%	17.12.2023	17.12.2026
5. Marrëveshja Financiare per IPA 2020	2,450,000	2,447,703.3	99%	1,061,487.38	43%	11.04.2024	11.04.2027
<b>Total IPA II</b>	<b>36,800,000</b>	<b>30,779,450.63</b>	<b>84%</b>	<b>25,931,058.10</b>	<b>84%</b>		

Për periudhën objekt auditimi nga ana e CFCU janë kontraktuar 37 kontrata ku pjesë e tyre kanë qenë edhe programet IPA 2014 dhe IPA 2015, të cilat janë iniciuar gjatë viteve 2018 - 2020 por

<sup>2</sup> Përthithje nga pagesat i referohet projekteve të finalizuar dhe paguar

Nen programin IPA 2014 është ende nën implementim një kontrate, CENSUS, e cila mbyllet në muajin Dhjetor 2024. Ndaj 85% përthithje nuk është përfundimtare pasi programi ende nuk është mbyllur dhe ka në pritje dhe 2 pagesa të tjera.

- Nen programin IPA 2019 është ende nën implementim kontrata me perfitues OSFA, e cila mbyllet në muajin Dhjetor 2025. Ndaj 74% përthithje nuk është përfundimtare pasi programi ende nuk është mbyllur dhe ka në pritje 2 pagesa të tjera për këto kontrate

- Nen programin IPA 2020 janë mbyllur 3 kontrata në pagese dy kontrata në proces kontrolli financiar dhe një kontrate nën implementim. Ndaj 43% përthithje nuk është përfundimtare pasi programi ende nuk është mbyllur.

fazat e vijueshmërisë së tyre (lidhja e kontratës, implementimi apo pagesa) kanë patur shtrirje edhe në vitit 2021-2024.

Ecuria e kontratave të lidhura nën Programet IPA 2017, 2019 dhe 2020, që në fillim të implementimit të tyre deri në fund të 6-mujorit të parë të vitit 2024 duke paraqitur 6,277,667.53 (Euro) financim IPA, kundrejt 6,276,965.69 Euro të kontraktuara (99%), duke reflektuar një nivel të lartë të disbursimeve dhe të përthithjes së fondeve të përfituara nën këto projekte.

Sa i takon pagesave paraqitet e ndarë në dy momente, së pari projektet nën IPA 2017 të cilat të gjitha mbajnë statusin përfunduar dhe për to mund të shprehemi mbi vlerat totale, si dhe projektet nën IPA 2019 dhe IPA 2020 pjesë e të cilëve janë projekte me statusin në proces, duke pamundësuar shprehjen mbi totalin të vlerave të përthithura.

Respektivisht:

Në lidhje me **IPA 2017** janë planifikuar sipas marrëveshjes 1,850 mijë euro për kryerjen e prokurimeve, nga të cilat janë kontraktuar të plota 1,830 mijë euro (pra kontraktimi është realizuar në masën 98.88% kundrejt atij të planifikuar, ose 20,737.61 Euro më pak) dhe janë kryer pagesa në vlerën 1,698 mijë Euro, duke reflektuar një nivel të realizimit të pagesave në masën 93%.

Në lidhje me **IPA 2019** janë planifikuar sipas marrëveshjes 2,000 mijë Euro për kryerjen e prokurimeve, nga të cilat janë kontraktuar 2,000 mijë euro (pra kontraktimi është realizuar në masën 100 % sa planifikimi) dhe deri në fund të 6-mujorit të parë të vitit 2024, janë kryer pagesa në vlerën 1,472 mijë Euro, duke reflektuar një nivel të realizimit të pagesave në masën 74%. *Nën programin IPA 2019 është ende nën implementim kontrata me përfitues O., e cila mbyllet në muajin dhjetor 2025. Ndaj 74% përthithje nuk është përfundimtare pasi programi ende nuk është mbyllur dhe ka në pritje 2 pagesa të tjera për këtë kontratë.*

Në lidhje me **IPA 2020** janë planifikuar sipas marrëveshjes 2,450 mijë euro për kryerjen e prokurimeve, nga të cilat janë kontraktuar 2,447 mijë euro (pra kontraktimi është realizuar në masën 99%, ose 2,296.70 euro më pak se planifikimi) dhe deri në fund të 6-mujorit të parë të vitit 2024, janë kryer pagesa në vlerën 1,061 mijë Euro, duke reflektuar një nivel të realizimit të pagesave në masën 43%. *Nën programin IPA 2020 përfshihen: tre kontrata të mbyllura në pagesë, dy kontrata në proces kontrolli financiar dhe një kontratë nën implementim. Ndaj 43% përthithje nuk është përfundimtare pasi programi ende nuk është mbyllur.*

Nga auditimi është konstatuar se ecuria e kontratave të lidhura nën Programet IPA 2017, 2019 dhe 2020, që në fillim të implementimit të tyre deri në fund të 6-mujorit të parë të vitit 2024 paraqitet në total 6,300,000 (Euro) financim IPA, kundrejt 6,276,965.69 Euro të kontraktuara (99%) duke reflektuar një nivel të lartë të përthithjes së fondeve të përfituara nën këto projekte. Ndarë sipas llojeve të kontratave (kontrata shërbimi, binjakëzimi, grante etj.), vlera e kontraktuar fillestare dhe aktuale paraqiten në tabelë.

**Tabela:** Kontratat ndarë sipas llojit për periudhën 01.01.2021 – 30.06.2024

Në Euro

Lloji i kontratës	Shuma totale fillestare	Shuma totale aktuale	Në përqindje
Grant direkt	4,800,000.00	4,800,000.00	100.00%
Kontratë granti	3,877,414.68	3,877,319.69	100.00%
Shërbim	6,637,700.00	6,625,585.00	99.82%
STP-SER-2019-01 GLOBAL Price	4,725.00	4,725.00	100.00%
Binjakëzim	2,246,976.63	2,246,974.79	100.00%
Binjakëzim "light"	748,625.21	748,625.21	100.00%
<b>Totali</b>	<b>18,315,441.52</b>	<b>18,303,229.69</b>	<b>99.93%</b>

Burimi: Të dhënat nga CFCU. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Evidentuar nga ndarja e llojeve të kontratave si më sipër, rreth 8.6 milionë Euro janë kontraktuar në formë grantesh dhe rreth 6.6 milionë Euro janë kontraktuar për kontrata shërbimi, pasuar nga kontratat e binjakëzimit. Sa i takon outputit përfundimtar të kontratave, rezulton se nga përshkrimi i tyre në databazë, por edhe nga kontratat e përzgjedhura për auditim, mbizotërojnë produkte të llojit “shërbim” dhe jo “mallra”, duke e vështirësuar matjen e produktivitetit të kontratave dhe duke e kufizuar atë në përmbushjen e objektivave në kuadër të ofrimit të shërbimit dhe jo të një outputi final të trupëzuar.

Për programin IPA 2015, duke analizuar projektet dhe kontratat përbërëse të këtij programi, rezulton se nuk janë kontraktuar fondet për 6 kontrata, për të cilat kontrolli ka qenë përgjithësisht i formës ex-ante, si në vijim:

- Kontrata “Ngritja e kapaciteteve për nëpunësit civilë të aftë dhe shumë të motivuar për të forcuar aftësitë dhe kapacitetin e tyre për të menaxhuar procesin e integritit në BE dhe negociatave”, në vlerë 1,000,000 Euro.
- Kontrata “Asistencë Teknike për të mbështetur Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Financat Qendrore dhe Njësinë Kontraktuese për të mbështetur në mënyrë efektive programimin dhe zbatimin e instrumentit të EUIF – kontratat e granteve të OShC-ve” në vlerë 300,000 Euro.
- Kontrata “Mbështetja e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e kodit të ri evropian të komunikimeve elektronike dhe rregullores për aksesin e hapur në internet” (ex-post) në vlerë 300,000 Euro.
- Kontrata “Krijimi i rrjetit celular të radios dhe të dhënave dhe blerja e pajisjeve të përdoruesit fundor për rrethet kryesore MC LTE” në vlerë 3,200,000 Euro.
- Kontrata “Asistencë Teknike për të koordinuar dhe zbatuar reformën kombëtare në fushën e punësimit dhe aftësive (NESS)” (ex-post) është mbyllur nga AK më datë 06.02.2019.
- Fondet për kontratën “Asistencë Teknike për Zhvillimin e Programeve Sektoriale Kombëtare dhe Programimin IPA” në vlerë 257,500 Euro nuk janë rialokuar.

Referuar analizës së të dhënave të vëna në dispozicion nga Plani i Prokurimit kryqëzuar me databazën e kontratave, rezulton se për programet IPA 2014 dhe 2015 asnjë kontratë nuk është nënshkruar përgjatë periudhës objekt auditimi, por procesi i tenderimit dhe nënshkrimit të kontratës i takon periudhës përpara vitit 2021 (pavarësisht se mund të ketë kontrata që kanë si datë përfundimi periudhën objekt auditimi).

Për programin IPA 2017, për periudhën objekt auditimi janë kontraktuar 9 kontrata granti në vlerë totale të buxhetuar 700,000 Euro, kontratat e të cilave janë nënshkruar më datë 29.03.2021, por procedura e tenderimit të tyre është realizuar përpara periudhës objekt auditimi.

Për programin IPA 2019, është kontraktuar vlera 2,000,000 Euro për kontratën e grantit brenda periudhës objekt auditimi, e cila është ende nën implementim, me datë përfundimi 11.12.2024.

Për programin IPA 2020, janë kontraktuar 6 kontrata brenda periudhës objekt auditimi me vlerë të buxhetuar 2,450,000 Euro.

Në portofolin e saj, CFCU referuar periudhës objekt auditimi ka 16 kontrata të financuara në kuadër të programeve vjetore IPA II (IPA 2017, IPA 2019 dhe IPA 2020) me një vlerë totale prej 5,130 milionë euro, ku disa prej tyre tashmë janë përfunduar dhe disa janë ende në zbatim.

Portofoli i projekteve, projektet e zbatuara dhe ato në proces që CFCU duhet të zbatojë në kuadër të programeve IPA II janë paraqitur në vijim:

- 3 kontrata si pjesë e programit kombëtar **IPA 2014** me përfitues si më poshtë:

Përfituesi	Projekti	Vlera e kontratës	Statusi
PAI, B.I.I.C, B.A.E, F.E.N.d'A.(E.) F. I. shpk.A.	Implementation of civil service reform across the public administration	2,836,500	Mbyllur
I.	"Suport për implementimin e regjistrimit të popullsisë dhe banesave 2020 (census)"	4,800,000	Nën Implementim
E.E.& E.C.S.A (G.)	"Support in the Energy Efficiency Sector and the Renewable Energy (RES) Development "	249,650	Mbyllur

- 15 kontrata si pjesë e programit kombëtar **IPA 2015** me përfitues si më poshtë:

Përfituesi	Titulli	Vlera e kontratës	Statusi
R.L.	Experts "assessors" to assist in the evaluation of grant applications received for civil society call for proposals under IPA 2017 NP (indirect management) – Lot 2	2,325	Mbyllur
L.Gj.	"Experts "assessors" to assist in the evaluation of grant applications received for civil society call for proposals under IPA 2017 NP (indirect management) – Lot 2	2,400	Mbyllur
B.S. in E.S.A	"Building capabilities of the Albanian public administration on free movement and fight against illicit trafficking of cultural goods"	249,000	Mbyllur
G.I.S. (DIN) – in consortium with S.A.S. (UNE)	"Support to the General Directorate of Standardization in aligning legislation and work procedures with the Union acquis and C.&C. criteria, aiming to prepare DPS to become full member of C.&C.	299,475	Mbyllur
BDI in consortium with D. B.	"Enhancing Bank of Albania's alignment with EU Acquis"	799,948	Mbyllur
I. for P. and L.	"youThink-Enabling the proactive participation of Youth in policy and legislative development of Albania and its implication in the process of European Integration"	64,000	Mbyllur
T. for I.	Europe respects Human Rights	62,432.40	Mbyllur
A. of E.I. and N.	A. of E.I. and N.	68,300	Mbyllur
P. P. of N.E. A	"Paving the way towards a sustainable Natura 2000 network in Albania: the case of Nartë-Pishe-Poro complex site"	37,329.95	Mbyllur
I.	"Increasing civic awareness on standard energy efficiency measures in Albania"	39,099.19	Mbyllur
C.for L.R.	"Enhanced social dialogue and improved employment policies in Albania in the view of the EU Integration process"	36,826.85	Mbyllur
E.d.	Albanian Youth for EU Integration	61,621.41	Mbyllur
Qendra"l dhe Zh. D."/D.I. and D.C.	"Enhance the capacities of Local CSOs to contribute in negotiation process"	69,710.05	Mbyllur
C.S. R. C. C.	Europe for Albanian Youth (EU4A)	55,986.15	Hapur
W. G.	Technical Assistance to support the reform on Employment Policies and Vocational Education and Training	2,291,660	Mbyllur

- 12 kontrata nën programin kombëtar IPA 2017 nga të cilat 3 kontrata përpara periudhës objekt auditimi:

Përfituesi	Titulli	Vlera e kontratës	Statusi
Member State I.-A.	Institution building for alignment with the Union acquis on the protection of personal data	399,971.15	Mbyllur
Member State G.-I.	Strengthening the Protection and the Enforcement of Intellectual Property Rights	347,057.48	Mbyllur
Member State A.	Support to the Albanian Customs Administration in relation to the implementation of the EU Customs Code and increase of operational capacities in the area of counterfeit goods	400.000	Mbyllur

Për periudhën objekt auditimi 2021 – 2024 (gjashtë mujor i parë) janë zhvilluar 3 (tre) programe IPA 2017, IPA 2019 dhe IPA 2020, si pjesë e të cilëve janë kontraktuar gjithsej 16 kontrata/projekte. Këta 3 (tre) programe paraqiten me një total prej 16 projekte, kështu IPA 2017 me 9 (nëntë) projekte, IPA 2019 me 1 (një) projekt dhe IPA 2020 me 6 (gjashtë) projekte. Në mënyrë të detajuar paraqiten si vijon:

- 9 (nga 12) kontrata nën programin kombëtar IPA 2017 me përfitues:

Përfituesi	Titulli	Data e lidhjes së kontratës	Data e implementimit	Data e përfundimit	Vlera e kontratës	Statusi
SDC	PRO-Consumers, A step Further Towrds EU Requirements	29/03/21	30/03/21	29/01/23	58,924.82	Mbyllur
Sh.Q.S.	Civil participation tackles the problems related to wwste management, advocating for the acquis transposition into local policies	29/03/21	30/03/21	29/09/22	56,022.58	Mbyllur
ICHLA	CSOs as advocators for implementation of horizontal environmental legislation at the local level - Vlora Region	29/03/21	30/03/21	29/03/23	76,076.00	Mbyllur
I. R.R.- I.	Promoting the usage of European standards on environmental protection for a better livelihood	29/03/21	30/03/21	29/09/22	79,930.63	Mbyllur
COSPE	ECO Friends - Environment and Climate Operative Friends	29/03/21	30/03/21	29/09/22	85,464.02	Mbyllur
E.C.	Empowering civil society activism and concrete contributions into the EU accession negotiation process in Albania	29/03/21	30/03/21	29/11/22	85,211.13	Mbyllur
EMA	Strengthening organizations in Albania on consumer protection	29/03/21	30/03/21	29/03/23	86,806.13	Mbyllur
Q.“K.Sh.”	Improving capacities of CSOs and the system of consumer protection in Albania to reach European standards – PROTECT ME	29/03/21	30/03/21	29/09/22	81,647.13	Mbyllur
IZHIQ	Towrwd EU: Strengthening CSOs and local government for better consumer protection	29/03/21	30/03/21	29/01/23	72,151.32	Mbyllur

Marrëveshja Financiare IPA 2017 është nënshkruar me datë 30 Mars 2018 dhe ka patur afat final kontraktimi datën 30 Mars 2021.

Brenda afatit kontraktual 30 Mars 2021 janë nënshkruar 12 kontrata ku 9 prej tyre cikli i plotë (lidhje deri në pagesë) i përket periudhës objekt auditimi. Nga vlera totale 1,850,000 Euro e alokuar për Programin Kombëtar IPA 2017, janë kontraktuar 1,829,262 Euro (99%) dhe disbursuar deri më 01 gusht 2024 vlera prej 1,687,868 Euro (93%). Implementimi i 12 kontratave të lidhura nën këtë program ka mbaruar në muajin Mars të vitit 2024.

Mbyllja e programit kombëtar vjetor IPA 2017 parashikohet të kryhet në vitin 2025.

- 1 kontratë nën programin kombëtar **IPA 2019** me përfitues:

Përfituesi	Subjekti	Data e lidhjes së kontratës	Data e implementimit	Data e përfundimit	Vlera e kontratës	Statusi
O. S. F. A. and T. U. A. S. L. F.	"EU support to Inclusive Education in Albania"	11/02/22	12/02/22	11/12/24	2,000,000	Nën Implementim

Marrëveshja Financiare IPA 2019 është nënshkruar me datë 17 Dhjetor 2020 dhe ka pasur afat final kontraktimi datën 17 Dhjetor 2023.

Kontraktimi është përmbyllur më 11 Shkurt 2022, 10 muaj para afatit final të kontraktimit. Vlera e kontraktuar është 2,352,941.19 Euro, nga të cilat 85% (2,000,000 Euro) e kostos totale të kontratës financohet nga kontributi i BE-së dhe 15% (352,941.19 EUR) është kontribut i përfituesit të grantit. Kontrata është aktualisht nën implementim (deri në dhjetor 2024).

Vlera totale e disbursuar deri më 01 gusht 2024 është EUR 1,472,324.43 (74%).

Implementimi i kontratave nën IPA 2019 parashikohet të vijojë deri në fund të vitit 2026.

Mbyllja e programit kombëtar vjetor IPA 2019 duhet të kryhet në vitin 2027.



- 6 kontrata nën programin kombëtar IPA 2020 me përfitues:

Përfituesi	Subjekti	Data e lidhjes së kontratës	Data e implementimit	Data e përfundimit	Vlera e kontratës	Statusi
I. N. I. H.	"Support to enhance the organisation and governance of the Institute, strengthen its capacity for data collection, epidemiological analysis and monitoring, and improve its emergency response for communicable diseases and cross-national threats"	12/Apr/22	27/Apr/22	26/Dec/22	250,000	Mbyllur
A. O.B.	"Support to the Office of the People's Advocate and promotion of human rights in Albania"	17/06/22	20/06/22	19/06/23	300,000	Mbyllur
E. N.A (ENA)	"Capacity Building for Civil Servants of the Public Administration, Including Trainings/ Internships in EU Members State Administrations and Traineeship Scheme ("Young Cells")"	16/02/23	17/02/23	16/07/24	699,779.93	Nën kontrolllet finale
J. R (FËF) A. (EAA)	"Strengthening the Science and Research ecosystem in Albania"	04/05/23	10/07/23	09/05/24	248,625.21	Nën kontrolllet finale
G.S.E. SpA CSI P. E. S –I.	"Strengthening the overall capacity and effectiveness of the Agency for Energy Efficiency"	18/07/23	24/07/23	23/03/24	250,000	Nën kontrolllet finale
AAM D.M.I (F)-Member A. C. (A).	NEAR/TIA/2022/EA-RP/0067 Support to the State Advocate to bring judicial practices in line with best EU practices and human rights standards, (including peer-to-peer exchange, trainings and justified study visits as appropriate)	02/04/24	15/04/24	14/10/25	700,000	Nën Implementim

Marrëveshja Financiare për programin IPA 2020 është nënshkruar më datë 12 Prill 2021 me afat final kontraktimi datën 12 Prill 2024.

Nën këtë program janë planifikuar të zbatohen 6 (gjashtë) procedura me një vlerë totale prej 2,450,000 Euro.

Nga vlera totale 2,450,000 Euro e alokuar për Programin Kombëtar IPA 2020, janë kontraktuar 2,447,703 Euro (99.91%) dhe disbursuar deri më 01 gusht 2024 vlera prej 1,028,472.26 Euro (59%).

Statusi aktual i 10 kontratave të parashikuara nën këtë program është si vijon:

- 4 (katër) kontrata nën implementim
- 6 (gjashtë) kontrata të mbyllura

Implementimi i kontratave nën IPA 2020 parashikohet të përfundojë brenda vitit 2025.

Mbyllja e programit kombëtar vjetor IPA 2020 duhet të kryhet në vitin 2028.

Ndërkohë, nga kontrolli i dosjeve të përzgjedhura, rezulton se:

Sipas Manualit të Binjakëzimit nga Komisioni Europian, aneksi C1, është e rekomanduar që fisha e binjakëzimit mos të ketë më shumë se 10 faqe (pa përfshirë anekset), ndërkohë që në gati të gjitha fishat e binjakëzimit ky rekomandim nuk zbatohet.

Në datën 26.10.2021 fisha e binjakëzimit për projektin “Mbështetje për Institucionin e Avokatit të Popullit dhe promovimi i të drejtave të njeriut në Shqipëri” u publikua në Europe Aid website dhe në 28.10.2021 CFCU dërgon e-mailin për qarkullimin e fishës, ku afati përfundimtar i dërgimit të propozimeve është 7 Janar 2022. Ky veprim bie në kundërshtim me pikën 2.2 të Manualit të Binjakëzimit ku thuhet se: *Në princip, shtetet anëtare kanë 8 javë kohë për të përgatitur*

propozimet e tyre me një deadline konkret të specifikuar në momentin e qarkullimit të fishës. Autoriteti Kontraktor mund të konsiderojë vendosjen e një deadline më të gjatë në raste të justifikuara. Ndërkohë që në rastin konkret, afati është 10 javë dhe nuk është i justifikuar. E njëjta situatë, me një diferencë kohore rreth 9 javë për qarkullimin e fishës, në mungesë të argumenteve të justifikuara, konstatohet edhe në rastin e fishës së binjakëzimit “Mbështetje për Administratën Doganore Shqiptare në lidhje me zbatimin e kodeve doganore europiane dhe rritjen e kapaciteteve operacionale në fushën e mallrave të falsifikuara”, nga dërgimi i fishës përmes e-mail (datë 29.05.2020) deri në afatin e dorëzimit të propozimeve (datë 29.07.2020).

Mbledhja e Komisionit të Përzgjedhjes për projektin “Mbështetje për Institucionin e Avokatit të Popullit dhe promovimi i të drejtave të njeriut në Shqipëri” është realizuar në datat 2 dhe 3 Shkurt 2022, gati 4 javë pas afatit të fundit për propozimet (që ishte në 7 Janar 2022). Kjo bie në kundërshtim me Manualin e Binjakëzimit, pika 2.4.2.2 ku: *Mbledhja e komitetit të përzgjedhjes lejon përfituesin të vlerësojë plotësisht cilësinë e propozime të ofruara në mënyrë që të mund të zgjedhë partnerin më të përshtatshëm. Duke ndjekur ftesat formale të Autoritetit Kontraktor, mbledhja drejtohet nga këta të fundit. Nuk duhet të zërë vend më vonë se 2 javë pas afatit të fundit për propozimet.*

Më 17.02.2022 me shkresën nr.193 prot., CFCU kërkon aprovimin ex-ante për procedurën e përzgjedhjes nga ana e Delegacionit të BE në Shqipëri për projektin “Mbështetje për Institucionin e Avokatit të Popullit dhe promovimi i të drejtave të njeriut në Shqipëri”. Në këtë shkresë përmendet se Autoriteti Kontraktor duhet të lajmërojë rezultatet e procedurës shteteve anëtare që morën pjesë në garë brenda datës 03.03.2022. Lajmërimi është kryer 5 ditë pas afatit, me shkresën e datës 08.03.2022 nr.265 prot., është njoftuar shteti anëtar Greqi se nuk është përzgjedhur si fitues i procedurës. Megjithatë, njoftimi i rezultateve të procedurës është bërë brenda 4 javëve, sipas manualit të binjakëzimit.

Evidentohen mungesa në dosjet e procedurave të dokumentacioneve të stafit të përzgjedhur si pjesëmarrës, qoftë në grupet për përgatitjen e dokumentacionit, ashtu si dhe në Komisionin Përzgjedhës sa i takon jetëshkrimeve (CV) që duhet të dorëzohen.

**- Mbi monitorimin e kontratës, administrimi, pagesat e kryera dhe kontabilizimi i tyre.**  
Nga auditimi me përzgjedhje i projekteve rezultoi:

Mbi parashikimet e Fondeve IPA për vitet 2021, 2022 dhe 2023

### VITI 2021

Programi Kombëtar IPA 2017

IPA	Planifikimi janar (€)	Planifikimi Prill/ Qershor (€)	Realizimi 2021 (€)	Kundrejt planifikimit fillestar (€)	Kundrejt planifikimit të rishikuar (€)
Kontratat Grant nën IPA 2017					
EMA (AL/IPA2017/10)	560,000.00€	68,503.23€	68,503.23€		0
ICLA (AL/IPA2017/6)		60,860.80€	60,860.80€		0
IZHIQ (AL/IPA2017/12)		54,955.05€	54,955.05€		0
AL 17 IPA FI 02 20	87,356.71€	87,356.71€			
AL/IPA2017/8	700,000.00€	17,092.80€	68,371.22€		
<b>TOTAL</b>		<b>288,768.59 €</b>	<b>252,690.30 €</b>	<b>n/a</b>	

Programi Kombëtar IPA 2019

IPA	Planifikimi janar (€)	Planifikimi Qershor (€)	Realizimi 2021 (€)	Kundrejt planifikimit fillestar (€)	Kundrejt planifikimit të rishikuar (€)
Kontrata per IPA 2019					
S.	1,600,000.00€	600,000.00€	-	n/a	n/a
<b>TOTAL</b>	<b>1,600,000.00€</b>	<b>600,000.00€</b>			

Për Programin Kombëtar IPA 2020 nuk ka patur parashikime sepse ky program ndodhej në faza të hershme të kontraktimit.

**VITI 2022**

Programi Kombëtar IPA 2017

IPA	Planifikimi janar €	Planifikimi Qershor €	Realizimi 2022 €	Kundrejt planifikimit fillestar €	Kundrejt planifikimit të rishikuar €
IPA 2017					
EMA (AL/IPA2017/10)	-	-	-		
ICLA (AL/IPA2017/6)	-	-	-		
IZHIQ (AL/IPA2017/12)	-	-	-		
AL 17 IPA FI 02 20	87,356.71	-	57,699.57		
AL/IPA2017/8	17,092.80	17,092.80	-		
<b>TOTAL</b>	<b>104,449.51</b>	<b>17,092.80</b>	<b>57,699.57</b>		

Programi Kombëtar IPA 2019

IPA	Planifikimi janar €	Planifikimi Qershor €	Realizimi 2022 €	Kundrejt planifikimit fillestar €	Kundrejt planifikimit të rishikuar €
Kontrata per IPA 2019					
S.	900,000.00€	-	748,926.23€	151,073.77€	-
<b>TOTAL</b>	<b>900,000.00€</b>	<b>-</b>	<b>748,926.23€</b>	<b>151,073.77€</b>	<b>-</b>

Programi Kombëtar IPA 2020

IPA	Planifikimi janar €	Planifikimi Qershor €	Realizimi 2022 €	Kundrejt planifikimit fillestar €	Kundrejt planifikimit të rishikuar €
Kontratat e perzgjedhura nen IPA 2020					
AOB AL 20 IPA JH 01 21	240,000.00 €	234,468.61 €	234,468.61 €	5,531.39 €	-
- ISSH	200,000.00 €		195,742.14 €		
AL 20 IPA HE 01 21	50,000.00 €	54,257.86 €		4,257.86 €	-
AEE AL 20 IPA EY 01 22	200,000.00 €	200,000.00 €	-	200,000.00 €	200,000.00 €
<b>TOTAL</b>	<b>690,000.00 €</b>	<b>488,726.47</b>	<b>430,210.75 €</b>	<b>209,789.25</b>	<b>200,000.00€</b>

**VITI 2023**

National Programme IPA 2017

IPA	Planifikimi janar€	Planifikimi Qershor€	Realizimi 2023€	Kundrejt planifikimit fillestar €	Kundrejt planifikimit të rishikuar €
IPA 2017					
EMA (AL/IPA2017/10)	18,302.90	18,302.90	14,572.06	3,730.84	3,730.84
ICLA (AL/IPA2017/6)	15,215.20	15,215.20	10,745.38	4,469.82	4,469.82
IZHIQ (AL/IPA2017/12)	17,196.27€	17,196.27€	10,942.96€	6,253.31€	6,253.31€

AL 17 IPA FI 02 20	-	-	-		
AL/IPA2017/8	17,092.80 €	17,092.80 €	9,360.12	7,732.68 €	
<b>TOTAL</b>	<b>67,807.17€</b>	<b>67,807.17€</b>	<b>45,620.52€</b>	<b>22,186.65€</b>	<b>14,453.97 €</b>

### Programi Kombëtar IPA 2019

IPA	Planifikimi janar €	Planifikimi Qershor €	Realizimi 2023 €	Kundrejt planifikimit fillestar €	Kundrejt planifikimit të rishikuar €
Kontrata per IPA 2019					
S.	700,000€	579,209.58€	723,398.20€	- 23,398.20€	N/A
<b>TOTAL</b>	<b>700,000€</b>	<b>579,209.58€</b>	<b>723,398.20€</b>	<b>- 23,398.20€</b>	

### Programi Kombëtar IPA 2020

IPA	Planifikimi janar €	Planifikimi Qershor €	Realizimi 2023 €	Kundrejt planifikimit fillestar €	Kundrejt planifikimit të rishikuar €
<b>IPA 2020</b>					
AOB AL 20 IPA JH 01 21	65,529.55€	65,529.55€	33,015.12€	32,514.43€	32,514.43€
- ISSH AL 20 IPA HE 01 21	54,257.86€	54,257.86€	47,816.18€	6,441.68€	6,441.68€
AEE AL 20 IPA EY 01 22	200,000.00€	200,000.00€	198,188.62€	n/a	
<b>TOTAL</b>	<b>319,787.41€</b>	<b>319,787.41€</b>	<b>279,019.92</b>	<b>38,956.11€</b>	<b>38,956.11€</b>

### **Viti 2024 (deri ne 30.06.2024)**

#### Programi Kombëtar IPA 2019

IPA	Planifikimi janar €	Planifikimi Qershor	Realizimi 2024 (deri ne 30.06.2024) €	Kundrejt planifikimit fillestar €	Kundrejt planifikimit të rishikuar €
Kontrata per IPA 2019					
S.	327,675.57€	327,675.57€	-		
<b>TOTAL</b>	<b>327,675.57€</b>	<b>327,675.57€</b>			

#### National Programme IPA 2020

IPA	Planifikimi Janar €	Planifikimi Qershor €	Realizimi 2024 (deri ne 30.06.2024) €	Kundrejt planifikimit fillestar €	Kundrejt planifikimit të rishikuar €
<b>IPA 2020</b>					
AOB AL 20 IPA JH 01 21	-	-	-	-	-
- ISSH AL 20 IPA HE 01 21	-	-	-	-	-
AEE AL 20 IPA EY 01 22	51,811.38€	51,811.38€			
<b>TOTAL</b>	<b>51,811.38€</b>	<b>51,811.38€</b>	<b>0</b>		

Në lidhje me nivelin parashikim realizim të fondeve IPA në nivel programi për çdo vit rezulton:

*Për vitin 2021*

- IPA 2017, planifikimi fillestar (Janar 2021) rezultonte në 560,000 Euro (Kjo shume është shume e parafinancimit 80% te vlerës totale 700,000.00 Euro, ne përputhje me Nenin 15.1, opsioni 1 i Kushteve të Përgjithshme të Kontratës) ndërkohë, në planifikimin e rishikuar (Prill dhe Qershor 2021) rezultonte në vlerën 288,768.59 Euro. Sa i takon planit të rishikuar, rezulton se planifikimi i kontratave (9 në total) realisht është bërë në Prill 2021 pas finalizimit të fazës së kontraktimit të kontratave, kur për çdo kontratë është parashikuar para-financimi bazuar në shumatat totale të secilës kontratë. Në muajin Qershor pagesa e parafinancimit për të tre kontratat e përzgjedhura ishte paguar me vlerë 184,319.08 Euro. Ndërkohë, për një kontratë binjakëzimi, të lidhur në e cila është parashikuar që në Qershor 2020, në vlerën 400,000 Euro (sa kontrata fillestare) dhe realizimi për vitin 2020 paraqitet në vlerën 312,643.29 Euro (parafinancim).

- IPA 2019 për vitin 2021, planifikimi fillestar (Janar 2021) rezultonte në 1,600,000 Euro (Kjo shumë është shumë e parafinancimit 80% të vlerës totale 2,000,000.00 €, në përputhje me Nenin 15.1 të Kushteve të Përgjithshme. Në janar të vitit 2021 për këtë kontratë si e dhënë rezultonte fondi i alokuar. Ndërkohë, në planifikimin e rishikuar (Prill dhe Qershor 2021) rezultonte në vlerën 600,000 Euro. Sa i takon planit të rishikuar, rezulton se planifikimi i kontratës është 1,000,000 Euro më pak.

*Për vitin 2022*

- IPA 2017, planifikimi në muajin Janar paraqitet në vlerën 104,449.51 Euro për dy kontrata (binjakëzim dhe grant) të evidentuara në tabelat e mësipërme. Planifikimi i rishikuar në muajin Qershor paraqitet në 17,092.80 Euro dhe realizimi për vitin 2022 në vlerë totale 57,699.57 Euro. Referuar kontratave të tjera këto mbylleshin dhe kishin si afat dorëzimi të raportimeve datat 29 dhjetor 2022.

- Për IPA 2019, planifikimi fillestar (Janar 2020) rezultonte në vlerën 900,000 Euro, dhe ky parashikim përfaqësonte vlerën e parafinancimit sipas formulës mbi vlerën totale 2,000,000.00 € të kontratës, dhe duke marrë në konsideratë informacionin për kohëzgjatjen e pritshme të kontratës interimet ishin ndarë në dy vite. Planifikim të ndryshuar nuk ka, ndërkohë referuar realizimit ai përfaqëson vlerën e parafinancimit në vlerë 748,926.23 Euro, konkretisht 151,073.77 Euro më pak se planifikimi.

- Për IPA 2020, planifikimi fillestar (Janar 2020) rezultonte në vlerën 690,000 Euro, dhe ky parashikim përfaqësonte vlerën e parafinancimit (sipas shumave të planifikuara në Planin e Prokurimit, në përputhje me Nenin 15.1, opsioni 1 i Kushteve të Përgjithshme të kontratës).

Planifikimi fillestar (Janar 2020) për 4 kontratat e përzgjedhura përfaqëson:

- a. për AOB / AL 20 IPA JH 01 21 vlerën e parafinancimit në nivelin 80% i 300,000.00€ sipas shumës së planifikuar në Planin e Prokurimit, në përputhje me Nenin 15.1, opsionin 1 të Kushteve të Përgjithshme të kontratës;
- b. për ISSH Parashikimi është mbështetur në të dhënat totale të Planit të Prokurimit për këtë kontratë e cila ka patur vlerën totale 250,000.00 € . Parashikimet jane 80 % dhe 20 % të shumës totale 250,000.00 € sipas Planit te Prokurimit për vitin 2022 dhe janë ndarë përkatësisht në 6 mujorin e parë të 2022 parafinacimi (200,000.00 €) dhe pagesa finale në shumën 50,000.00 € në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2022 (dhjetor 2022);
- c. për AL 20 IPA HE 01 21 kontraktimi është kryer në dt 12.04.2022 vlera fillestare parashikuar është më e ulët se parashikimi i riparë (qershor 2022) ky i fundit 4,257.86 Euro më shumë. Sa i takon realizimit, kjo vlerë paraqet parafinancimin dhe rezulton në

195,742.14€, pagesë e cila është ekzekutuar gjatë gjashtëmujorit të parë. Balanca e mbetur e financimit në vlerën 54,257.86 € parashikuar në përputhje me nenin 4 të Kushtet të veçanta të kontratës;

d. për AL 20 IPA EY 01 22 vlera e parashikuar dhe e paguar rezultojnë të njëjta.

#### *Për vitin 2023*

- IPA 2017, vlera e parashikuar në planifikimin fillestar (Janar 2023) dhe ajo në planifikimin e rishikuar (Qershor 2023) rezultojnë dhe e paguar rezultojnë të njëjta, ndërkohë realizimi rezulton më i vogël krahasuar planit, konkretisht 22,186.65 Euro më pak se planifikimi fillestar.

- IPA 2019, vlera e parashikuar në planifikimin fillestar (Janar 2023) përfshinë vetëm një kontratë dhe ajo në planifikimin e rishikuar (Qershor 2023) rezulton më e vogël krahasuar planit fillestar prej 120,790.42 Euro. (Kjo procedurë rezulton e kryer me financim të ndërmjetëm – bridge financing nga Buxheti i Shtetit). Realizimi përfshinë pagesën e mëtejshme të parafinancimit, ekzekutuar në dt 05.10.2023, realizuar nëpërmjet procedurës “bridge financing”. Përfundimisht, vlera e realizuar rezulton me 23,398.20 Euro më shumë krahasuar planifikimit fillestar.

- IPA 2020 vlera e parashikuar në planifikimin fillestar (Janar 2023) rezulton e njëjtë me vlerën e planifikimit të rishikuar, prej 319,787.41 Euro. Realizimi rezulton më i vogël se plani, konkretisht me 38,956.11 Euro më pak.

#### *Për periudhën e 6-mujorit të parë 2024*

- IPA 2019, vlera e parashikuar në planifikimin fillestar (Janar 2023) përfshinë vetëm një kontratë dhe ajo në planifikimin e rishikuar (Qershor 2023) rezulton e njëjtë krahasuar me planin fillestar prej 327,675.25 Euro. (Kjo procedurë rezulton e kryer me financim të ndërmjetëm – bridge financing nga Buxheti i Shtetit)

- IPA 2020 vlera e parashikuar në planifikimin fillestar (Janar 2023) përfshinë vetëm një kontratë dhe ajo në planifikimin e rishikuar (Qershor 2023) rezulton e njëjtë krahasuar me planin fillestar prej 51,811.38 Euro. Pagesë finale nuk ka për arsye se, se kjo kontratë ka dalë me pagesa nga kontraktori përmes procedurës “recovery”.

**Konstatim: Nga auditimi u konstatuan problematika në planifikimin e fondeve të nevojshme për tu buxhetuar, konkretisht nga krahasimi i vlerave të planifikuara në fillim të vitit apo edhe atyre të rishikuara në muajin qershor/korrik, rezulton se ekzistojnë diferenca të konsiderueshme në realizimin e pagesave krahasuar me planin përkatës për periudhën objekt auditimi.**

***Sa i takon shqyrtimit të dosjeve të përzgjedhura dhe procedurave të ndjekura, rezultojnë parregullsi apo problematika të sqaruara në vijim, duke evidentuar edhe rastet përkatëse ku janë konstatuar këto mangësi:***

Nga auditimi i dosjeve fizike të projekteve të përzgjedhura nën programet IPA për t’u audituar u konstatua se në tërësi këto dosje mbartnin parregullsi në mënyrën e mbajtjes së tyre, mungonte fleta e inventarit për çdo dosje respektive, e për pasojë nuk është bërë numërimi i fletëve dhe inventarizimi/numërimi total i tyre sipas ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” neni 30, “Inventari i brendshëm i dosjes” që për shkak të sensitivitetit të informacionit, gjykohet si risk i shtuar dhe duhet vlerësuar nga CFCU.

**Evidentohen ndryshime të shpeshta të stafit të cilat reflektohen në realizimin e kontratës dhe për të cilat nga ana e CFCU nuk ka pasur kërkesë për llogaridhënie. Në Kontratën e Binjakëzimit me përfitues Avokatin e Popullit, vihen re ndryshimet si më poshtë:**

-në javën para nisjes së projektit final, RTAC (K.R.) dha dorëheqjen nga Avokati i Popullit dhe u zëvendësua me B. K;

-në fund të muajit korrik, Përgjegjësi për Komponentin 1 la vendin e punës në Avokatin e Popullit dhe u zëvendësua nga ish RTAC (K. R.) e cila u rikthye në punë;

-në dhjetor 2022 RTAA (D. Sh.) dha dorëheqjen e cila niste nga shkurti i 2023;

-më mars, MS Kryetarja e Komponentit 1 zëvendësohet me Përgjegjësin për Komponentin 2.

Në Kontratën e Binjakëzimit me AEE vihen re 6 side letters mes MS dhe BC duke njoftuar Autoritetin Kontraktor mbi ndryshime të ekspertëve. Arsyeja pas këtyre side letters ishte zgjerimi i ekspertëve të mobilizuar gjatë implementimit të projektit.

Në kundërshtim me Manualin e Binjakëzimit, seksioni 2.4.3 ku thuhet se “...*Nisja e implementimit nuk duhet të jetë më vonë se 3 muaj pas njoftimit të përzgjedhjes...*”, konstatohet se në projektin “Suport për zhvillimin e organizimit dhe qeverisjes së Institutit, forcimit të kapaciteteve për mbledhjen e të dhënave, analizave epidemiologjike dhe monitorimi dhe përmirësim i përgjigjeve ndaj emergjencës për sëmundjet e transmetueshme dhe kërcënimeve ndërkombëtare” implementimi ka nisur më 27.04.2022, 5 muaj pas njoftimit të rezultatit të procedurës së përzgjedhjes dhe 2 muaj pas datës indikative për nisjen e tij (e cila ishte 10 Shkurt 2022). Procesi i përpilimit dhe nënshkrimit të kontratës ka zgjatur deri më 19.04.2022.

**Konstatim: Konstatohet se nuk ka dokumentacion justifikues për realizimin e aktiviteteve në pjesën më të madhe të projekteve të audituara. Këto mungesa janë në formën e formateve të vlerësimit të nënshkruara dhe të plotësuara nga pjesëmarrësit, foto nga aktiviteti, foto nga mbledhjet në Zoom, formularët e vlerësimit të aktiviteteve etj.**

Në kontratën e tipit grant “**Fuqizimi i organizatave të mbrojtjes së konsumatorit në Shqipëri**” vihen re mungesa të theksuara të cilat janë dhe në formën e përfshirjeve të shkresave që vërtetojnë kryerjen e aktiviteteve të cilat nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me projektin si psh: Course II “Potential and challenge of integration in a troubled Europe”: Eu enlargement and regional cooperation in Western Balkan.

Course III “Albania and the trends of European Integration”: Covid 19-s impact on the Welfare state and EU enlargement and regional cooperation in WB.

Në vetëm 1 (një) nga 10 (dhjetë) projektet e përzgjedhura për tu audituar, konkretisht në kontratën e binjakëzimit “Mbështetje për Institucionin e Avokatit të Popullit dhe promovimi i të drejtave të njeriut në Shqipëri” rezultoi se, në raportin narrativ final komponenti “numri i nëpunësit civil të trajnuar si trajnerë” nuk është realizuar. Ky mosrealizim objektivi, nuk është shoqëruar me zbritjen e ditëve të punës respektive të dedikuara për të dhe rrjedhimisht nuk është pasqyruar në raport.

Lidhur me kontratën e binjakëzimit “Mbështetje për Administratën Doganore Shqiptare në lidhje me zbatimin e kodeve doganore europiane dhe rritjen e kapaciteteve operationale në fushën e mallrave të falsifikuara”, nga ana e EUD me shkresën Ref. Ares(2020)6802306 më datë 16.11.2020, janë kthyer komentet lidhur me kontrollin ex-ante të procedurës së prokurimit ku përcaktohet se përgjithësisht procedura ka shkuar mirë, por nevojiten reflektimet e komenteve përkatëse përgjatë kontratës. Rekomandohet që kostoja vjetore e auditimit/kontrollit të rishikohet pasi duket e lartë (5,975 EUR). Megjithatë, pavarësisht komenteve të EUD, rezulton se kjo kosto nuk është rishikuar dhe në kontratë është reflektuar e njëjta vlerë. Referuar qëndrimit të CFCU, kjo e fundit përcakton se ka marrë masa për ndryshimin potencial të

kontratës pas nënshkimit të saj në rast të ofertave më të ulëta, duke qenë se kontrata ishte nënshkruar në momentin e marrjes së komentit nga EUD.

Në shumicën e kontratave të audituara, me anë të side letters vihen re ndryshime të shpeshta të ekspertëve kryesorë të kontratës për arritjen e objektivave të projektit. Këto problematika janë të pa adresuara nga ana e CFCU tek kontraktori dhe nuk reflektohen as në raportin narrativ final ose në kontrollet on the spot.

Lidhur me kontratën e binjakëzimit “Mbështetje për Administratën Doganore Shqiptare në lidhje me zbatimin e kodeve doganore europiane dhe rritjen e kapaciteteve operationale në fushën e mallrave të falsifikuara” konstatohet se duke krahasuar kontratën me raportet e ndërmjetme dhe raportet finale, ndërthurur me Planet Roll Up 1 dhe 2, janë evidentuar aktivitete të cilat nuk janë të paraqitura në raportin final apo të mbuluara me ditë ekspert. Gjithashtu, nga krahasimi i ditë ekspert sipas kontratës dhe ditë ekspert sipas raporteve, vihet re angazhim me më shumë ditë për aktivitete të caktuara dhe angazhim më i ulët në të tjera, sipas parashikimit në kontratë, referuar edhe Planeve Roll Up 1 dhe 2. Për më tepër, konstatohet se angazhimi i ndryshëm nga kushtet e kontratës nuk është përkthyer në ndryshim të objektivave apo komponentëve të aktiviteteve, pavarësisht se ka aktivitete që nuk janë mbuluar me ditë angazhimi sipas progres raporteve, përpos 6 Side Letters përmes së cilave është rialokuar buxhetin ndërmjet zërave, si aktiviteti 1.1.1 dhe aktiviteti 2.4. Për këtë kontratë ka patur 6 side letters për rialokime buxhetore brenda zërave të buxhetit në vlerë totale 33,599.33 EUR ose 8.93% të vlerës totale të kontratës. Këto ndryshime nuk janë evidentuar nga CFCU përgjatë monitorimit të implementimit të kontratës së binjakëzimit, apo nga monitorimi i pagesave financiare.

**Sa i takon dhe pagesave të kryera për projektet e përzgjedhura janë evidentuar si në vijim:**

*Ndërprerje / pezullim i vijueshmërisë:*

Në 7 nga 8 projektet e përzgjedhura për tu audituar (konkretisht vetëm ato që janë përfunduar, pasi 2 vijojnë të jenë në proces), rezultoi se nga ana e CFCU është kryer ndërprerje e vijueshmërisë si nga ana e financës ashtu edhe nga implementimi për shkak të nevojës së plotësisht të dokumentacionit justifikues. Në mënyrë të detajuar:

- Për kontratat twinning ose twinning light nga ana e CFCU në mbështetje të nenit 5.3 aneks a7 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës, është përcaktuar pezullim i vijueshmërisë për shkak të mosplotësisht të dokumentacionit justifikues financiar dhe mos reflektimit të plotë të komenteve në raportin narrativ.

a.1. kontrata me institucion përfitues “Avokati Popullit” 15 ditë ndërpreje, me shkresën nr.861 prot., datë 29.08.2023 nga ana e CFCU është pezulluar pagesa finale për TC për shkak të mosdorëzimit të dokumenteve të duhura mbështetëse dhe dhënies së argumenteve / sqarimeve shtesë të pjesës narrative të Raportit, sikundër parashikohet në Article 5.3 të Annex a7 të Twinning Manual.

Për këtë është vendosur afati i pezullimit (15 ditë) prej datës 29.08.2023 deri në rifillim kur të dorëzohet dokumentacioni.

a.2. kontrata me institucion përfitues “Instituti i Shëndetit Publik” 15 ditë ndërpreje, me shkresën nr.547 prot., datë 25.5.2023 nga ana e CFCU, është kërkuar pezullim i pagesave për Shtetin Anëtar për mosplotësim të dokumentacionit suportues

- Për kontratat Grant nga ana e CFCU në mbështetje të nenit 15.5 aneks a7 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës, është përcaktuar pezullim i vijueshmërisë së pagesave për shkak të



mosplotësimin të dokumentacionit justifikues financiar dhe mos reflektimit të plotë të komenteve në raportin narrativ.

a. 1. për kontratën EMA me shkresën nr.656/1 prot., datë 14.07.2023 pezulluar pagesa finale për TC për shkak të mosdorëzimit të dokumenteve të duhura mbështetëse dhe dhënies së argumenteve/sqarimeve shtesë të pjesës narrative të Raportit;

a.1/1. me shkresën nr.795 prot., datë 03.08.2023 pezulluar pagesa finale për TC për të njëjtin motivacion;

b. për kontratën S. rezultojnë 5 pezullime, sa më sipër me afat total 60 ditë;

c. për kontratën IZHIQ rezulton 1 pezullim, me afat 21 ditë kalendarike;

d. për kontratën ICLA rezultojnë 3 pezullime, me afat 10-14 ditë kalendarike;

e. për kontratën COSPE rezultojnë 2 pezullime, duke nisur me afat 15 ditë kalendarike, por që ka përfunduar në 29 ditë kalendarike pas kërkesës nga përfituesi, si dhe duke shtuar edhe një pezullim të dytë me 10 ditë kalendarike, për shkak të përdorimit të gjuhës italiane në materialet e dorëzuara.

Emertimi i kontrates	Kontraktori	Ndërpreje kërkuar nga AK ( shkresë/email)	Kthim përgjigje nga Kontraktori/ përfituesit e kontratave	Suspension kërkuar nga AK ( shkresë/email)	Kthim përgjigje nga Kontraktori/ përfituesit e kontratave
AL 20 IPA JH 01 21	A. O.B	29.08.2023 / 15.09.2023	31.10.2023	nr.861 prot., datë 29.08.2023	
AL 20 IPA HE 01 21	I. N. I. H.	11.05.2023 / 25.05.2023	22.06.2023		
Al/ IPA 2017/10	EMA	14.07.2023 nr prot 656/1	28.07.2024	nr 795 prot 03.08.2023	27.8.2023
AL 20 IPA EY 01 22	AEE	05.07.2024	12.07.2024		
CSOs as advocators for implementation of horizontal environmental legislation at the local level - Vlora Region	I.CH.L.A	14.07.2023/01.08.2023 21.09.239(via email)	04.10.23		
Towrd EU: Strengthening CSOs and local government for better consumer protection	IZHIQ	07.07.23	27.07.23		
Near/ TIA/2023/006 7	AAM	Për këtë kontratë nuk ka patur pezullim, pasi është paguar deri në fund të periudhës objekt auditimi vetëm parafinancimi			
AL/IPA2019/1	O.S.F.A				
AL 17 IPA FI 02 20	AEI				
AL/IPA2017/8	COSPE <sup>3</sup>	21.06.2023	19.07.2023	26.07.2023	03.08.2023

**Konstatim:** Nga auditimi rezulton se, nga ana e CFCU me qëllim plotësim të dokumentacionit justifikues për njohje dhe validim të shpenzimeve janë vendosur për 7 (shtatë) nga 8 (tetë) kontratat (cikli i pagesës së të cilave ka përfunduar) ka patur pezullime/ndërprerje të vijueshmërisë së pagesave deri në plotësim të dokumentacionit të kërkuar.

Intervali i ndërprerjeve ka vijuar nga 10 ditë në 29 ditë, ku për vetëm 1 (një) kontratë rezultoi ndërpreje e vazhduar prej 6 rastesh.

<sup>3</sup> Në vijimësi të korrespondencave janë evidentuar kërkesa për shtyrje nga përfituesi për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar nga CFCU, duke sjellë shtyrje të të gjithë procesit vijues

Nga auditimi rezulton se, këto ndërpreje kanë sjellë si rrjedhim ndryshim të afateve të pagesave (për shkak të ndryshimit në kohën e miratimit të raporteve narrative) krahasuar me kushtet/afatet kohore të paracaktuara në kontratë.

- Mbi miratimin e raporteve narrative

Afatet e miratimit

Referuar Manualit Twinning, Neni 5.5.3 “Raporti Final” parashikohen afatet e kohëzgjatjes, konkretisht perifrastuar... jo më vonë se tre muaj pas datës së përfundimit të periudhës së zbatimit siç përcaktohet në nenin 2.2 të kushteve të veçanta të Kontratës së Binjakëzimit, pra brenda periudhës së ekzekutimit të kontratës...

Në mënyrë të detajuar sa i takon respektimit të afateve të miratimit të progres raporteve (raporti narrativ final) dhe ndikimi mbi pagesat finale, si më poshtë vijojnë:

Kontrata	Përfituesi	Data e nënshkrimit të kontratës	Buxheti	Para financim		Pagesa Finale			Paguar (pagesa finale)	Ndërprerje			
				Data e kërkesës së transfertës	Shuma e kërkuar/ Parafinancim i mëtejshëm (further pre-financing)	Afati dorëzimit (referuar Special Condition të kontratës)	Data e dorëzimit të Raportit Final Annex V (kërkesa për pagesë)	Afati final për pagesë (Referuar pagesës)		Datë ndërprerje	Kthim pergjigje nga Kontraktori / përfituesit e kontratave	Datë ndërprerje	Kthim pergjigje nga Kontraktori / përfituesit e kontratave
Strengthening organizations in Albania on consumer protection	EMA	29.03.21	86,806.13	28.04.21	68,503.23	29.06.23	28.06.23	28.09.23	17.10.23	14.07.23 nr port 656/1	28.07.23	03.08.23 nr prot 795	27.08.23
CSOs as advocates for implementation of horizontal environmental legislation at the local level - Vlora Region	I.CH.L.A	29.03.2021	76,076.00	28.04.21	60,860.80	29.06.23	29.06.23	29.09.23	15.11.23	21.09.23	04.10.23	655/1 dt 14.7.23 / 655/3 dt 1.8.23	-
Toward EU: Strengthening CSOs and local government for better consumer protection	IZHIQ	29.03.2021	72,151.32	28.04.21	54,955.05	29.04.23	28.04.23	28.07.23	15.08.23	07.07.23	27.07.23	-	-
AL 20 IPA HE 01 21	ISHP	12.04.2022	250,000.00	10.05.2022	195,742.14	12.03.23	26.03.23	26.06.23	13.07.23 (ne perputhje me suspension eshte shtyre afati)	11.05.2023	22.06.23	-	-
AL 20 IPA JH 01 21	AP	17.06.2022	299,998.16	04.07.2022	234,468.61	17.09.23	08.08.23	08.11.23	14.12.23 (duke marre ne konsiderate percjelljen e dok mbeshtetes ne dhjetor 2023)	15.09.2023	01.12.23 (via email)	-	-

AL 20 IPA EY 01 22	AEE	18.07.20 23	250.000. 00	28.07. 2023 (email)	198,188.6 2 eur	18.06.24	Nuk ka pagese finale sepse ka recovery te pre-financing			05.07.20 24 (email nga financa per percjellje dokumen tacioni)	12.07.2 024	16.07.24	22.07.24
AL 17 IPA FI 02 20	AEI	24.11.20 20	400,000. 00	15.12. 2020	312,643.2 9	24.12.22	24.01.22	24.01.22	27.05.22	-	-	-	-
IPA 2017/AL/8	COSPE	29.03.20 21	85,464.0 2	20.04. 2021	68,371.22	29.09.22	27.03.23	20.10.23	19.10.23 (ka amendim kontrate)	21.06.23	19.07.2 3	26.07.23	03.08.23
Near/ TIA/2023/00 67	AAM	02.04.20 24	699,300. 00			Konkretisht kjo kontrate eshte nen zbatim							
AL/IPA2019/ 1	O.S.F.A	22.02.22	2,000,00 0.00	28.02. 22	(748,926.2 3 +723,398. 20)= 1,472,324. 43 eur	Konkretisht kjo kontrate eshte nen zbatim							

**Avokati i Popullit:** Me shkresën nr.812/2 Prot., datë 21.12.2023 është kryer Aprovimi i Raportit Final Narrativ dhe Financiar për Kontratën e Binjakëzimit nr. AL20IPAJH0121, nga data 08.08.2023 që ishte parashikuar për tu kryer.

Referuar kontratës implementimi nis 20.06.2022 dhe përfundon 19.06.2023, pagesa duhet kryer jo më vonë se 3 muaji nga përfundimi i implementimit. Referuar dokumentacionit, pagesa finale është kryer më 14.12.2023.

**AEI:** Me shkresën nr. 567 prot., datë 07.06.2022 është njoftuar miratimi i raportit final narrative dhe financiar për kontratën e binjakëzimit AL 17 IPA FI 02 20, nga data 24.12.2022 që ishte parashikuar për t'u kryer. Referuar kontratës implementimi nis 24.11.2020 dhe përfundon 24.11.2021, pagesa duhet kryer jo më vonë se 3 muaji nga përfundimi i implementimit. Referuar dokumentacionit, pagesa finale është kryer më 27.05.2022, pra rreth 4 muaj më vonë se përfundimi apo përcaktimi në Manual dhe kontratë.

**ISHP:** Me shkresën nr.630 Prot., datë 21.06.2023 është kryer Aprovimi i Raportit Final Narrativ dhe Financiar për Kontratën e Binjakëzimit nr.AL 20 IPA HE 01 21 TWL, nga data 26.03.2023 që ishte parashikuar për tu kryer.

Referuar kontratës implementimi nis 20.04.2022 dhe përfundon 19.06.2023, Referuar dokumentacionit, pagesa finale është kryer më 13.07.2023.

**EMA:** Përpara miratimit të pagesës finale nga ana e CFCU-së, me shkresën nr.13967 Prot., datë 14.09.2023 nga MEPJ, konkretisht nga drejtori i njësisë IPA është dërguar miratimi i përmbajtjes së raportit final të dërguar nga CFCU. Miratuar nga CFCU me shkresën nr.920 prot., datë 18.09.2023, nga data 28.06.2023 që ishte parashikuar për tu kryer.

Nga auditimi rezultoi se, bashkangjitur kësaj praktike mungon dokumenti narrativ (raporti narrativ) i dërguar apo komente të cilat mund të jenë kryer mbi të.

Referuar kontratës implementimi nis 30.03.21 dhe përfundon më 29.03.23. Referuar dokumentacionit, pagesa finale është kryer më 17.10.2023.

**AEE:** Me shkresën nr.4650 Prot., datë 27.05.2024 nga MIE (Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë) është dërguar raporti final i kontratës.

Nga ana e CFCU - Drejtorisë së Menaxhimit të kontratave IPA, në shkresën nr.695 prot., datë 09.08.2024 specifikohet se, *Raporti Final nuk shoqërohet me kërkesë për pagesë, kjo për arsye se shuma e shpenzuar gjatë implementimit të projektit është më e vogël se pagesa e parafinancimit.*

Me shkresën nr.549/3 prot., datë 23.09.2024 është aprovuar raporti final narrative.

Bashkangjitur praktikës Aneksi F3 Checklist for the Narrative Section of Reports dhe kopje e projektit. Mungon raporti final në kuadrin e një dokumenti zyrtar.

Me e-mail të datës 13.05.2024 nga CFCU është përcjellë kopje e raportit final, jo zyrtar. (Praktika dokumentare mungon). Pagesa finale e përfshirë në vlerën e parafinancimit (për shkak se e mbulonte plotësisht).

**OSFA/S:** Me shkresën nr.836/1 prot., datë 16.10.2023 është aprovuar Interim i parë i Raportit Financiar të grantit.

Referuar kontaktës implementimi nis 24.07.2023 dhe përfundon më 23.03.24. Referuar dokumentacionit, pagesa finale është kryer më 07.08.2023 (mbuluar nga parafinancimi). Kjo kontratë është nën implementim.

**IZHIQ:** Me shkresën nr.796/1 Prot., datë 18.08.2023 është kryer Aprovimi i Raportit Final Narrativ dhe Financiar për Kontratën e Binjakëzimit nr. IPA2017/AL/12, nga data 28.07.2023 që ishte parashikuar për tu kryer.

Referuar kontaktës implementimi nis 29.03.2021 dhe përfundon 28.04.2023, pagesa duhet kryer jo më vonë se 3 muaji nga përfundimi i implementimit, pagesa finale duhej kryer më 28.07.2023.

Referuar dokumentacionit, pagesa finale është kryer më 15.08.2023

**COSPE:** Përpara miratimit të pagesës finale, me shkresën nr. 335 prot., datë 27.03.2023, COSPE ka dërguar drejt CFCU raportin narrativ final. Miratuar nga CFCU me shkresën nr. 1082 prot., datë 01.11.2023, ku përmes së cilës është njoftuar përfituesi për miratimin e raportit final, pagesën finale si dhe pagesën e TVSH.

Referuar kontratës implementimi nis 29.03.2021 dhe përfundon pas 18 muajsh, pra më 29.09.2022.

Referuar dokumentacionit, pagesa finale është kryer më 19.10.2023, pas dy pezullimeve të njëpasnjëshme (29 ditë kalendarike dhe 10 ditë kalendarike).

**ICLA:** Me shkresën nr.921/1 prot., datë 17.11.2023 është kryer Aprovimi i Raportit Final Narrativ dhe Financiar për Kontratën e Binjakëzimit nr. IPA2017/AL/6, nga data 29.09.2023 që ishte parashikuar për tu kryer.

Referuar kontaktës implementimi nis 29.03.2021 dhe përfundon 29.06.2023, pagesa duhet kryer jo më vonë se 3 muaji nga përfundimi i implementimit, pagesa finale duhej kryer më 29.09.2023.

Referuar dokumentacionit, pagesa finale është kryer më 15.11.2023

**Nga ana tjetër, për shkak të vonesave në procedurat e aprovimit të raporteve finale narrative (për shkak të ndërprerjeve/pezullimeve nga ana e CFCU përpara miratimit të vlerave financiare të njohura) periudha për të cilën ishte planifikuar kjo pagesë shtyhet për vitin e ardhshëm, duke sjellë si pasojë:**

*- thyerje e afateve të pagesave kontraktuale (për shkak të ndryshimit në kohën e miratimit të raporteve narrative) krahasuar me kushtet/afatet kohore të paracaktuara në kontratë;*

*- djegie të fondet të TVSh-së për vitin sipas së cilit janë buxhetuar, kjo pasi, në rastet kur këto pagesa nuk realizohen sipas planifikimit të duhur, digjen fondet (të planifikuara në nivele më të larta krahasuar me faktin), duke krijuar kështu bllokimin e fondeve të cilat mund të ishin përdorur për pagesa apo investime të tjera.*

Nga auditimi u konstatua se, sa i takon miratimit të raporteve narrative, në rastet e granteve të përzgjedhura për tu audituar, miratimi nga njësia IPA (MEPJ) i raportit përfundimtar narrative, nuk shoqërohet bashkëngjitur shkresës përcjellëse, operuar kështu jo në përputhje me nenin 7, pika d të Marrëveshjes Operacionale IPA II midis NIPAC, Njesisë IPA dhe CFCU e cila përcakton se “IPA Unit in Line Ministries/Beneficiary Institutions will have the responsibility for the following tasks: ... approval of the reports of contractors/grant beneficiaries (“read and approved”) and the countersignature of the timesheets submitted by the contractors’ experts within th deadlines set down by the cfcu. ... approving and countersigning of the provisional and final acceptances. ...”

**Nga auditimi rezultoi se për shkak të vonesave në procedurat e aprovimit të raporteve finale narrative (për shkak të ndërprerjeve/pezullimeve nga ana e CFCU përpara miratimit të vlerave financiare të njohura) periudha për të cilën ishte planifikuar pagesa shtyhet për vitin e ardhshëm, duke sjellë si pasojë:**

- thyerje e afateve të pagesave kontraktuale (për shkak të ndryshimit në kohën e miratimit të raporteve narrative) krahasuar me kushtet/afatet kohore të paracaktuara në kontratë;
- djegie të fondet të TVSh-së për vitin sipas së cilit janë buxhetuar, kjo pasi, në rastet kur këto pagesa nuk realizohen sipas planifikimit të duhur, digjen fondet (të planifikuara në nivele më të larta krahasuar me faktin), duke krijuar kështu bllokimin e fondeve të cilat mund të ishin përdorur për pagesa apo investime të tjera.

*Mbi pagesat e projekteve në dy faza parafinancim dhe financim final:*

*Në Euro*

	Kontraktori	Shuma e kontratës	Shuma e kontratës (vetëm fondet IPA)	Parafinancimi	Pagesa finale (balance final payment) sipas kontrates	Kerkuar	Diferenca	Validuar	Recovery amount	Further pre-financing
AL 20 IPA JH 01 21	A.O.B	299,998.16		234,468.61	65,529.55	33,867.56	31,661.99	33,015.12		
AL 20 IPA HE 01 21	I.N.I.H	250,000.00		195,742.14	54,257.86	47,816.18	6,441.68	47,816.18		
AI/ IPA 2017/10	EMA	95,109.16	86,806.13	68,503.23	18,302.90	16,882.77	1,420.13	14,572.06		
AL 20 IPA EY 01 22	A.E.E	250,000.00		198,188.62	51,811.38	-	51,811.38	196,966.30	1,222.32	
Near/ TIA/2023/0067	AAM	699,300.00		139,860.00	nen zbatim					
AL/IPA2019/1	O.S.F.A	2,000,000.00		1,472,324.43	nen zbatim	1,009,605.33		723,398.20		723,398.20
AL/IPA 2017/12	IZHIQ	76,756.72	72,151.32	54,955.05	17,196.27	13,449.44	3,746.83	10,942.96		
AL/IPA 2017/6	ICLA	80,080.00	76,076.00	60,860.80	15,215.20	15,215.20	-	10,745.38		
AL 17 IPA FI 02 20	AEI	400,000.00		312,643.29	87,356.71	57,753.33 <sup>4</sup>	177.47	56,852.54		
IPA 2017/AL/8	COSPE	92,946.12	85,464.02	68,371.22	17,092.80	17,092.80	-	5,411.27		

Burimi: Të dhënat nga CFCU, përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

<sup>4</sup> Ka një credit note për gabim në koston e tremujorit të parë në vlerën 57,709.02 eur, pra në koston totale duhet të reflektohet 56,852.54 eur. Referuar faturës nr. 94/2021 për flesh tirana, AEI ka rënë dakord që shuma prej 53.76 eur të zbritet nga kërkesa fillestare e vlerës 57,699.75 eur.

Nga auditimi rezulton se, në pesë nga dhjetë rastet e përzgjedhura të cilat kishin përfunduar pagesat, vlera e kërkuar për pagesë finale nga ana e përfituesit ishte më e vogël se sa ajo e parashikuar në kontratë.

Kjo vlerë i referohet kërkesave të kontraktorëve dhe në çdo rast rezulton më e ulët nga sa ishte parashikuar për tu kërkuar, referuar raporteve financiar si dhe dokumentacionit justifikues vendosur në dispozicion u konstatua prania e rialokimeve të herë pas hershme brenda për brenda zërave duke mos identifikuar në asnjë rast shkakun e kërimit të këtyre vlerave më të ulta.

Nga ana e sektorit për monitorimin e kontratave, që ka për detyrë monitorimin e zbatimit të kontratave dhe ndjekjen rregullisht të zbatimit të tyre, nuk rezulton të jetë kryer një analizë / apo vlerësim mbi impaktin në outputin final, se si është arritur ai (nëse është cënuar apo jo) në zbatim dhe reflektim të ndryshimeve të ndodhura krahasuar me zërat e parashikuar. Përthithja më pak nga kontraktimi (vlera e parashikuar në kontratë) mbart në vetvete riskun e mos kryerjes së plotë të aktiviteteve sikundër parashikuar.

Nga auditimi mbi pagesat e kryera (parafinancim dhe financim final) rezulton se, në pesë nga dhjetë rastet e përzgjedhura (të cilat kishin përfunduar pagesat në të dy fazat), vlera e kërkuar për pagesë finale nga ana e përfituesit ishte më e vogël se sa ajo e parashikuar në kontratë. Në asnjë rast nuk rezultonte prania e një analize apo argumentimi të identifikimit të shkaqeve të kërimit të këtyre vlerave më të ulta.

- Nga ana e sektorit për monitorimin e kontratave, që ka për detyrë monitorimin e zbatimit të kontratave dhe ndjekjen rregullisht të zbatimit të tyre, nuk rezulton të jetë kryer një analizë / apo vlerësim mbi impaktin në outputin final, se si është arritur ai (nëse është cënuar apo jo) në zbatim dhe reflektim të ndryshimeve të ndodhura krahasuar me zërat e parashikuar. Përthithja më pak nga kontraktimi (vlera e parashikuar në kontratë) mbart në vetvete riskun e mos kryerjes së plotë të aktiviteteve sikundër parashikuar.

#### *Referuar raporteve financiare:*

Nga auditimi rezultoi se, vlerat e validuara për 7 (shtatë) nga 8 (tetë) projektet, pagesat e të cilëve ishin kryer, (në 5 raste të dy fazat dhe 3 raste vetëm faza e para financimit) ishin më të vogla se vlerat e kërkuara. Referuar raporteve financiare dhe dokumentacionit mbështetës justifikues, problematikat më të shpeshta të hasura rezultuan:

- Për kontratat TWinning:

a) Prani pjesore e dokumentacionit mbështetës. (Kontrata me Nr AL 20 IPA HE 01 21 dhe Kontrata Nr AL IPA 20 EY 01 22)

b) Raportimi financiar ka patur të përfshirë si kosto të lejuar në disa raste TVSH-në e faturave të lëshuara nga operatorë shqiptar, duke bërë që gjatë kontrollit financiar këtyre faturave tu zbritte vlera e TVSH-së dhe sjellë ndryshime ne koston finale të validuar nga AK. (Kontrata me Nr AL IPA JH 01 21)

c) Zbritjet për shkak të ndryshimeve të kursit të këmbimit të ndryshëm nga ai që duhet të përdoret sipas Kushteve të Përgjithshme të Kontratës. (Kontratat me NR përkatësisht AL 20 IPA JH 01 21, AL 20 IPA HE 01 21 dhe AL 20IPA EY 01 22)

- Për kontratat Grant:

a) Prani pjesore e dokumentacionit mbështetës, e cila ka bërë të ketë ndërprerje të përkohshme të pagesës finale (për kontrata sipas sqarimit më sipër referuar edhe tabelës përkatëse).

b) Afatet e ndërprerjeve (suspension) nuk janë respektuar në të gjithë rastet nga përfituesit e granteve rrjedhimisht kjo është reflektuar në shtyrjen e afatit të pagesës duke mos zbatuar Kushtet e Përgjithshme të Kontrates. (AL /IPA 2017 / 10 me përfitues EMA si dhe për kontratën AL/IPA

2016/ 6 ICLA kontratë e cila ka impaktin më të madh në thyerje të afateve pasi ka përcjellë dokumentacionin shtesë pas afatit të vendosur nga AK duke shkelur afatet, si dhe kontrata AL/IPA2017/8 me përfitues COSPE e cila është pezulluar deri në 29 ditë sipas kërkesës nga përfituesi)

c) Dokumentacioni mbështetës i veprimeve financiare nuk ka qenë i plotë për të justifikuar shpenzimet e kryera. (AL /IPA 2017 / 10 me përfitues EMA, AL/IPA2017/8 me përfitues COSPE)

d) Mosnjohje e plotë e procedurave të prokurimit në përputhje me procedurat e PRAG. (AL /IPA 2019 /1, AL/IPA2017/8 me përfitues COSPE)

e) Zbritjet për shkak të ndryshimeve të kursit të këmbimit të ndryshëm nga ai që duhet të përdoret sipas Kushteve të Përgjithshme të Kontratës (ALL) . (AL IPA 2017/10 dhe AL IPA 2019/1).

Referuar dokumentacionit justifikues vendosur në dispozicion, rezultoi problematik (në 1 (një) rast nga 10 (dhjetë) të përzgjedhur) në miratimin e përdorimit të fondit të kontigjencës, konkretisht për projektin AL 20 IPA JH 01 21.

Me Memo nr.916 prot., datë 15.09.2023 përgatitur nga Drejtoria për Kontraktimin dhe Monitorimin e zbatimit të Kontratës, është cituar përdorimi i fondit rezervë të kontigjencës. Përdorimi i tij është mbështetur në nenin 14.7 “Contingency reserve” të kushteve të përgjithshme të kontratës dhe paragrafit 6.1.2 “Structure of budget” të Twinning Manual.

Ky fond është përdorur për të mbuluar kostot shtesë të fluturimit, pas 2 (dy) kërkesave të dërguara via email me datë 17.06.2022 (mungon në dosje) dhe 23.02.2023.

Kërkesat e mësipërme janë miratuar nga CFCU me shkresat nr.615/1 prot., datë 17.06.2022 dhe 223 prot., datë 28.02.2023

Në 1 (një) rast nga 10 (dhjetë) projektet e përzgjedhura për tu audituar, rezultoi se CFCU ka miratuar përdorimin e fondit të kontigjencës, konkretisht për projektin AL 20 IPA JH 01 21.

Ky fond është përdorur për të mbuluar kostot shtesë të fluturimit, pas 2 (dy) kërkesave të dërguara via email me datë 17.06.2022 (mungon në dosje) dhe 23.02.2023.

Sa i takon përdorimit të Fondit të Kontigjencës referuar Twinning Manual:

- paragrafi 6.1.2 citohet ...*The allocation for the budget contingency reserve is fixed as 2.5% of the direct costs at the time of the contracting. Should the contingency reserve be used for the implementation of the project, the funds used are re-allocated to the relevant budget heading.*

- paragrafi 6.2.11 Contingency reserve citohet se... *Unforeseen needs corresponding to maximum 2.5% of the direct eligible costs can be foreseen. Although many eligible costs of a Twinning project are budgeted as unit costs and flat rates, costs reimbursed on the basis of documentary evidence (invoices) may increase unexpectedly and require extra resources. The contingency reserve can be used to finance the execution of additional or extended activities provided these are justified for achieving and/or sustaining the results.*

Nga auditimi rezultoi se, kërkesa është bërë përgjatë periudhës së kryerjes së misionit. Nuk jemi në kushtet e aktiviteteve shtesë apo të zgjatura, si dhe mungon argumentimi/justifikimi për këto pagesa në moszbatim të TM paragrafi 6.2.10 dhe 6.1.2

Nga auditimi i një prej dy kërkesave (e vetmja prezente në dosje) rezultoi se, kjo pagesë kërkohej për të mbuluar fluturimin e RTA drejt vendit përfitues (Shqipëri). Kjo praktikë referuar TM, Artikujt 2.4 “Travel allowances for RTA” 2.5 “Travel allowance for short term experts” rregullohet si vijon... *Each time an official or assimilated agent is dispatched to the Beneficiary country to act as a short-term expert, travel costs should be compensated on the basis of a travel allowance established based on the economically most favourable quote among those provided by three travel*

*agencies or on the quote provided by the entity of the MS administration selected by competitive procedure in charge of travel arrangements before the signature of the Twinning contract. The quotes shall be endorsed in advance by the authority signing the Twinning contract.*

Nga auditimi rezulton se, nga ana e CFCU është aprovuar përdorimi i fondit të kontigjencës, i cili është një rezervë financiare që përdoret për të përballuar ngjarje të papritura, shpenzime të paplanifikuara, ose situata emergjente që kërkojnë financim të menjëhershëm, pra fonde të destinuar për t'u përdorur në rrethana specifike dhe emergjente, dhe nuk janë të përshtatshme për financimin e shpenzimeve të zakonshme ose operacioneve rutinë që nuk lidhen me situata kritike. Në rastin konkret nuk ndodhemi në asnjë prej kushteve të sipër përmendura, por jemi në kushtet e ndryshimit të çmimit të biletave të fluturimit përgjatë kryerjes së misionit.

Në 1 (një) rast nga 10 (dhjetë) rastet e përzgjedhura për tu audituar rezultoi se, nga ana e CFCU-së është miratuar përdorimi i fondit të kontigjencës, fond i cili është përdorur për të mbuluar kostot shtesë të fluturimit të RTA drejt vendit përfitues për shkak të ndryshimit të çmimit të biletave, konkretisht për projektin AL 20 IPA JH 01 21. Fondi i kontigjencës është një rezervë financiare që përdoret për të përballuar ngjarje të papritura, shpenzime të paplanifikuara, ose situata emergjente që kërkojnë financim të menjëhershëm, pra fonde të destinuar për t'u përdorur në rrethana specifike dhe emergjente, dhe nuk janë të përshtatshme për financimin e shpenzimeve të zakonshme ose operacioneve rutinë që nuk lidhen me situata kritike.

Veprimet e mësipërme në kundërshtim me twinning Manual, paragrafi 6.2.10 dhe 6.1.2 dhe 2.4.

*Në kontratat grante të përzgjedhura dhe përfunduara u konstatuan fenomenet si më poshtë vijon:*

- Sa i takon shpërndarjeve të kryera brenda për brenda zërave të buxhetit nga ana e përfituesit nuk ka një informacion detajues se në cilat linja buxhetore është marrë fondi dhe destinacionin se ku është përdorur ai<sup>5</sup>.

- Dokumentacion pjesor mbështetës lidhur përmbushjen e aktiviteteve përkatëse;

- Ndryshim i shpeshtë i menaxherit të projektit nga ana e CFCU me të paktën 2 herë brenda periudhës së implementimit, duke ndikuar potencialisht në vazhdimësinë e projektit si rrjedhojë e rrezikut nga vonesat e shkaktuara, kompetencës profesionale të personit zëvendësues dhe mos operimit në mbështetje të plotë me Manualin PRAG.

*Në të paktën rastet e mëposhtme, sqarojmë:*

1.1. Nga auditimi mbi dokumentacionin justifikues financiar për këtë projekt, rezultoi se për projektin ICLA, në zëra përbërës të buxhetit u konstatua në 9 (nëntë) raste tejkalim i vlerës krahasuar buxhetit fillestar, në total vlera e validuar është më e vogël se vlera e parashikuar në buxhet. Në vijim të konstatimit, nga ana e përfituesit nuk rezulton të jetë argumentuar nevoja për rialokim në moszbatim me pikën 2.1.5 të Manualit PRAG e cila trajton “Eligibility of costs”... *Nqs nevojiten rialokime të tjera, dhe ato arrijnë më pak se 25% të çdo kreu buxhetor, ato mund të kryhen përmes njoftimeve...*

1.2. Nga auditimi i dokumentacionit justifikues vendosur në dispozicion rezultoi se, në buxhet ishte kryer parashikim në dy linja buxhetore kontraktimi i ekspertëve për 2 (dy) aktivitete të ndryshme, konkretisht:

- 5.7.5.1.4 Ekspert i jashtëm për seminarin e avokimit mbi raportet e vogla për LG dhe palët e interesuara (1 ditë përgatitore + 5 ditë për seminare në çdo bashki) lidhur me aktivitetin 3.2.1 për 6 ditë pune me vlerë 1,200 Euro.

---

<sup>5</sup> Fenomen i konstatuar në kontratat grant të audituara përveç një rasti.



- 5.7.5.2 Ekspert i jashtëm për punëtoritë e avokimit mbi minoreportet për mbledhjet e këshillit bashkiak - raundi 2 (1 ditë paraprake + 5 ditë për seminare në secilën komunë) lidhur me aktivitetin 3.2.2 për 6 ditë pune me vlerë 1,200 Euro.

Referuar raportit financiar, rezulton se linja buxhetore 5.7.5.2 e cila lidhej me aktivitetin 3.2.2 ka rezultuar me kursim në nivelin 83.3% apo në terma absolute 1,000 Euro. Sipas shpjegimit të dhënë nga përfituesi ...*Për shkak të një situatë të paparashikuar eksperti E.H nuk merrte dot pjesë dhe ky proces është mbyllur nga ekipi.*

Sa i takon dokumentacionit mbështetës të kryerjes së aktiviteteve rezultoi se, ato janë pjesore ku:

- mungojnë listëprezenca për të verifikuar anëtarët prezentë në takimet me këshillat bashkiak lidhur me aktivitetin 3.2.2;
- pagesa nga ana e financës është kryer bazuar mbi kërkesën e paraqitur nga eksperti dhe një timesheet bashkangjitur i cili nuk rakordon me të dhënat e pasqyruara në dokumentacionin justifikues të aktiviteteve. Kështu:
  - a) në timesheet citohet kontributi i ekspertit për aktivitetin 2.3 ndërkohë në buxhet dhe në dokumentacion mbështetës është cituar aktiviteti 3.2;
  - b) referohen pune për muajt mars 22, maj 22 dhe qershor 22 dhe ndërprerje e punës së tij në qershor 22, ndërkohë që në dokumentacionin mbështetës aktivitetet justifikuese korrespondojnë me muajt tetor dhe nëntor (aktivitetet 3.2 round 1 10.1.22, 11.10.22m 25.11.22, 15.11.22 dhe 24.11.22; aktivitetet 3.3 6.4.22, 22.05.22, 07.04.22, 24.06.22 dhe 27.05.22);
  - c) sipas letrave të punës së ekspertit aktiviteti në Selenicë është kryer më 25.05.22 dhe në Vlorë në 27.05.22 sipas dokumentacionit mbështetës së aktiviteteve në Selenicë është kryer më 27.05.22 dhe Vlorë 22.05.22).
- Në asnjë nga fotografitë dokumentuese nuk evidentohet kontributi i dhënë nga eksperti.
- Referuar pagesës për ekspert (eksperti E.H. i cili ka patur një kontratë të lidhur për ofrimin e 12 seancave (12 ditë pune) me vlerë totale 2,400 Euro), rezulton të jetë kërkuar prej tij pagesa për 7 ditë pune me vlerë totale 1,200 Euro dhe aq është paguar por, sa më sipër trajtuar rezulton se, puna është kryer nga grupi ndërkohë është kryer kontraktimi i ekspertëve për të kryer këtë proces. Problematika e evidentuar rezulton në çështjen se, a ka grupi ekspertizën e duhur për të kryer këtë proces dhe arritjen e objektivave final pa cënuar cilësinë e tyre, pasi kjo gjë bie ndesh me procedurën e prokurimit dhe kërkesën për ekspert.
- Nga ana e CFCU është paguar për 7 ditë pune megjithëse largimi i tij ka thyer kontratën e lidhur mes palëve. Neni 6 i kontratës parashikon... *Pagesa do të kryhet bazuar në kërkesën për pagesë nga eksperti (kërkesa datë 22.06.2022) pasi të jetë ofruar shërbimi kontraktuar, proces i cili nuk ka ndodhur e nga ana e CFCU në kushtet që nuk është parashikuar qartazi në kontratë rasti i prishjes së njëanshme, nuk është mbajtur penaltet.*

***Në kontratat grante të përzgjedhura dhe përfunduara u konstatuan fenomenet si më poshtë vijon:***

- Sa i takon shpërndarjeve të kryera brenda për brenda zërave të buxhetit nga ana e përfituesit nuk ka një informacion detajues se në cilat linja buxhetore është marrë fondi dhe destinacionin se ku është përdorur ai (fenomen i përhapur i konstatuar në të gjithë grantet me përjashtim të 1 (një) rasti).

- Dokumentacion justifikues lidhur përmbushjen e aktiviteteve përkatëse ishte pjesor.

- Ndryshim i shpeshtë i menaxherit të projektit nga ana e CFCU me të paktën 2 herë brenda periudhës së implementimit, duke ndikuar potencialisht në vazhdimësinë e projektit si rrjedhojë e rrezikut nga vonesat e shkaktuara, kompetencës profesionale të personit zëvendësues dhe mos operimit në mbështetje të plotë me Manualin PRAG.

**Nga auditimi mbi pagesën e kryer për efekt të projektit AI/IPA2017/06 rezultoi se:**

- Në 9 (nëntë) raste në zëra përbërës të buxhetit u konstatua tejkalim i vlerës krahasuar buxhetit fillestar, në total vlera e validuar është më e vogël se vlera e parashikuar në buxhet. Në vijim të konstatimit, nga ana e përfituesit nuk rezultoi të jetë argumentuar nevoja për rialokim në moszbatim me pikën 2.1.5 të Manualit PRAG.

- Referuar raportit financiar, rezultoi se linja buxhetore 5.7.5.2 e cila lidhej me aktivitetin 3.2.2 ka rezultuar me kursim në nivelin 83.3% apo në terma absolute 1,000 Euro kjo për shkak se aktiviteti nuk është kryer nga personi i kontraktuar por grupi punës.

- Dokumentacioni justifikues i kryerjes së aktiviteteve është i pjesshëm si dhe në mospërputhje me deklaratat e paraqitura në “letrat e punës” të kryqëzuara mes ekspertit dhe grupit të punës.

- Nga ana e CFCU është kryer pagesa e ekspertit për 7 ditë pune megjithëse largimi i tij ka thyer kontratën e lidhur mes palëve. Neni 6 i kontratës parashikon... *Pagesa do të kryhet bazuar në kërkesën për pagesë nga eksperti (kërkesa datë 22.06.2022) pasi të jetë ofruar shërbimi kontraktuar*, proces i cili nuk ka ndodhur e nga ana e CFCU.

**Implementimi:**

Përpara miratimit të pagesës finale nga ana e CFCU-së, me shkresën nr.13964 prot., datë 14.09.2023 nga MEPJ, konkretisht nga drejtori i njësisë IPA është dërguar miratimi i përbajtjes së raportit final të dërguar nga CFCU. Nga auditimi rezultoi se bashkangjitur kësaj praktike mungon dokumenti narrativ (raporti narrativ) i dërguar apo komente të cilat mund të jenë kryer mbi të.

**Ndryshimi i shpeshtë i menaxherit të projektit është kryer përmes urdhrave të brendshëm:**

- nr.8 datë 31.03.2021 protokolluar me nr.341 prot., është caktuar Projekt Menaxher i programit për Grant EuropeAid/168719/ID/ACT/AL për sigurimin dhe zbatimin e kontratës nr. IPA 2017/AL/6 “CSOs as advocates for implementation of horizontal environmental legislation at the local level vlora region” D. M.;

- nr.23 datë 25.06.2021 protokolluar me nr.341 prot., është caktuar Projekt Menaxher i programit për sigurimin dhe zbatimin e kontratës nr. IPA 2017/AL/6 “CSOs as advocates for implementation of horizontal environmental legislation at the local level vlora region” I. P.;

- nr.8 datë 11.4.2022 protokolluar me nr.372 prot., ndryshon U.B nr 23 datë 25.06.2021, nr.24 datë 25.06.2021 dhe nr.27 datë 25.06.2021 është caktuar Projekt Menaxher programi për sigurimin dhe zbatimin e kontratës nr. IPA 2017/AL/6 “CSOs as advocates for implementation of horizontal environmental legislation at the local level Vlore region” me motiv largim me leje lindje të PM të mëparshëm M. I.

Sa më sipër, rezultoi se Projekt Menaxheri i kontratës u ndryshua 3 (tre) herë, 31.03.2021 deri më 11.04.2022.

**Nga auditimi rezultoi se, projekt menaxheri i Drejtorisë së Menaxhimit të Fondeve të BE për kontratën IPA 2017/AL/6 u ndryshua 3 (tre) herë, për intervalin kohor 31.03.2021 deri më 11.04.2022 duke riskuar kështu realizimin e suksesshëm të projekteve dhe përdorimin e fondeve në mënyrë efektive, kjo pasi ndryshimi i shpeshtë mund të shkaktojë:**

- Humbje të vazhdimësisë në menaxhimin e projekteve dhe në koordinimin ndërmjet palëve të përfshira.
- Humbje të njohurive dhe eksperiencës të grumbulluar nga menaxherët e mëparshëm.
- Vonesa në ekzekutimin e aktiviteteve të projektit, për shkak të nevojës për kohë për t'u njohur me projektin dhe përshtatur procedurat dhe planifikimet e mëparshme.

**1.3 Lidhur me auditimin e dokumentacionit financiar mbi kontratën e grantit “ECO Friends”**, për projektin e COSPE, rezultoi se nga buxheti fillestar, është kryer një amendim i cili ka konsistuar në ndryshimin e kalendarit dhe të buxhetit duke rialokuar më shumë se 25% të vlerës së tij brenda zërave, pra duke mos patur ndryshime në vlerë totale në buxhet, por vetëm rialokime mes zërave. Ky amendim nuk është argumentuar qartësisht për arsyet e ndodhjes së tij apo mënyrës së ndryshimit të brendshëm të zërave. Amendimi i nënshkruar në Tetor 2021 nga AK dhe në Shkurt 2022 nga EUD, ka kryer ndryshime në Aneksin 1 “Përshkrimi i veprimit” dhe Aneksin 3 “Buxheti i veprimit”, ndërsa termat e tjerë kanë mbetur të pandryshuar. Me amendimin e kontratës, buxheti ka mbetur sërish në vlerën totale 92,946.19 Euro, ku përqindja e kontributit të EU/EDF shprehur në raport me kostot totale të pranuar paraqitet 91.95% (raport i pandryshuar nga kontrata fillestare).

Në buxhetin fillestar ishte kryer parashikim në dy linja buxhetore kontraktimi i ekspertëve lokalë për 2 (dy) aktivitete të ndryshme, konkretisht:

- 6.1. Ekspert lokal për mbështetjen e institucioneve publike për aktivitetet A.2.1, A.2.2. dhe A.2.3, përkatësisht 20 ditë, 20 ditë, 10 ditë: 50 ditë me tarifë 150 Euro, në total me vlerë 7,500 Euro.
- 6.9 Ekspert lokal për ndryshimet klimatike, për aktivitetet A.1.1.1, A.1.2, A.1.5, A.2.1, A.2.2 dhe A.2.3, përkatësisht 15 ditë, 20 ditë, 20 ditë, 15 ditë, 15 ditë, 20 ditë: 105 ditë me tarifë 80 Euro, në total me vlerë 8,400 Euro.

Ndërsa, në buxhetin e amenduar, linja 6.1 për aktivitetet A.2.1, A.2.2. dhe A.2.3, është rialokuar nën linjat buxhetore 1.1.1.2 dhe 1.1.1.4, ndërsa linja 6.9 është rialokuar nën linjat buxhetore 1.1.1.2 dhe 2.2.1, duke buxhetuar dy nënlinja të njëjta (1.1.1.2) për aktivitete të ndryshme. Për më tepër, dokumentacioni lidhur me vërtetimin e këtyre aktiviteteve në dosjen financiare është pjesor dhe jo i plotë, ku përkatësisht për linjat/aktivitetet e ndryshuara nuk evidentohet dokumentacion mbështetës. Në komentet e dhëna nga CFCU lidhur me Raportin Narrativ dhe Raportin Financiar, evidentohet se janë kërkuar sqarime dhe dokumentacione shtesë lidhur me përmbushjen e aktiviteteve për linjat 1.1.1.4 dhe 2.2.1, por nuk ka gjurmë në komente që të jenë kërkuar dokumentacione shtesë për linjën 1.1.1.2 duke mos garantuar plotësinë e kontrollit të kryer.

Referuar analizës financiare të vënë në dispozicion nga CFCU, lidhur me këto tri linja, rezulton se:

- Për linjën 1.1.1.2, në buxhetin e amenduar është parashikuar vlera 3,000 Euro, janë kërkuar 2,947 Euro dhe janë validuar 1,810.26 Euro shpenzime.
- Për linjën 1.1.1.4, në buxhetin e amenduar është parashikuar vlera 4,500 Euro, janë kërkuar 4,074 Euro dhe janë validuar 2,331.90 Euro shpenzime.
- Për linjën 2.2.1, në buxhetin e amenduar është parashikuar vlera 5,443.60 Euro, janë kërkuar 4,483.06 Euro dhe janë validuar 100%, pra shpenzime në vlerën 4,483.06 Euro.

Për më tepër, përgjatë implementimit, konstatohet se Menaxheri i Projektit është ndryshuar të paktën 2 herë brenda 3 muajve, përkatësisht:

- Me Urdhrin e Brendshëm nr. 10, datë 31.03.2021 është caktuar znj. D. M.
- Me Urdhrin e Brendshëm nr. 24, datë 25.06.2021 është caktuar znj. I. P.

**Mbi raportimin pranë FK për kërkesë për fonde, planifikimi i fluksit të parasë dhe menaxhimi i llogarive bankare.**

*Planifikimi i TVSH-së*

Referuar udhëzimit nr. 10, datë 09.03.2015, përcaktohet roli i CFCU si *strukturë përgjegjëse për kontraktimin dhe tenderimin për përgatitjen dhe dorëzimin pranë Fondit Kombëtar të një parashikimi/plani të koordinuar të fondeve të BE-së (IPA), bazuar në llogaritjet e tyre dhe në fazën e gjendjes së implementimit të programit/projektit sipas planit përkatës të prokurimit, statusin e zbatimit të programit, si dhe detyrimet e pagesave që rrjedhin nga kontratat e nënshkruara me kontraktorët/ përfituesit, duke respektuar rregullat PRAG të BE-së, sipas afateve të dorëzimit të kërkesave buxhetore afatmesme, sipas së cilit Drejtoria e Fondit Kombëtar kryen edhe parashikimin e fondeve të TVSH të pagueshme nga Buxheti i Shtetit sipas institucioneve përfituese. Kjo realizohet nëpërmjet dorëzimit të parashikimit të fluksit të parasë nga CFCU në fillim të vitit, si dhe ndryshimet përkatëse përgjatë periudhës së zbatimit të kontratës. Më hollësisht planifikimi dhe realizimi i pagesave të TVSH-së rezulton (në Euro):*

IPA	TVSH Janar	TVSH qershor	TVSH Realizim	Kundrejt planifikimit fillestar	Kundrejt planifikimit të rishikuar
<b>Viti 2021</b>					
IPA 2017	-	0	Për programin IPA 2017 për vitin 2021 parashikimi ka qenë zero sepse kontratat kanë patur si afat kontraktual periudhën Mars 2021 dhe deri në fund të vitit maksimalisht janë parashikuar për tu paguar parafinancimet (nuk ka parashikime për TVSH për vitin 2021). Ndërkohë për programet IPA 2019 dhe IPA 2020 parashikimi për vitin 2021 nuk ka patur për arsye se te dyja programet kanë qenë në fazë prokurimi dhe nuk ka patur kontrata të lidhura.		
IPA 2019	-	0			
IPA 2020	-	0			
<b>TOTAL</b>					
<b>Viti 2022</b>					
IPA 2017	55,833.40€ <sup>6</sup> (ndaj totalit 96,140.5€)	96,140.05 €	Gjatë vitit 2022 nuk është paguar asnjë vlerë TVSH (afati përfundimtar i zbatimit të kontratave ishte dt 29.12.2022 ose në fillim të vitit 2023)		
IPA 2019	101,174.06€ <sup>7</sup>	101,174.06€			
IPA 2020	190,000.00€ <sup>8</sup>	190,000.00€	Janë parashikime sepse kontratat kanë qenë në fazën fillesatare të fillimit të zbatimit dhe janë ekzekutuar vetëm pagesat e parafinancimit.		
<b>TOTAL</b>	<b>347,007.46€</b>	<b>387,314.11€</b>			
<b>Viti 2023</b>					
IPA 2017	96,140.05€	52,781.98€	15,015.01€ <sup>9</sup>	15.62%	28.45%
IPA 2019	101,174.06€	32,200.00€	15,954.76 Euro (pas finalizimit të kontollit financiar për periudhën e parë është arritur në këtë vlerë) por kjo shumë nuk është ekzekutuar gjatë viti 2023 dhe është mbartur në vitin 2024		
IPA 2020	53,796.18€	53,796.18€	-		
<b>TOTAL</b>	<b>251,110.29€</b>	<b>138,778.16€</b>			
<b>Viti 2024</b>					

<sup>6</sup> Për IPA 2017 parashikimi i TVSH-së është dërguar në Tetor 2021 në total në shumën 96,140.05 Euro. Kjo shumë e ndarë respektivisht për vitin 2022 në vlerën 55,833.40 Euro dhe për vitin 2023 në shumën 40,306.65 Euro

<sup>7</sup> Shume e TVSH është parashikuar për vitin 2023, ndërsa për vitin 2022 nuk ka parashikim për TVSH.

<sup>8</sup> Parashikimi i TVSH për vitet 2024 dhe 2025 për të gjitha kontratat që parashikoheshin për kontraktim deri në fund të vitit 2022.

<sup>9</sup> Kjo vlerë është paguar për të 9 (nëntë) kontratat Grant pas kontrolleve financiare respektive.

IPA 2017	Per kete program te gjitha pagesat duke perfshire edhe TVSH jane ekzekutuar gjate vitit 2023			
IPA 2019	200,000 <sup>10</sup> €	=15,954.76+120,000=135,954.76 <sup>11</sup> €	15,954.76€	Gjate vitit 2024 është paguar 100% pagesa e mbartur nga viti 2023 por është ende në kontroll financiar (deri në dt 12.11.2024), rrjedhimisht ende nuk ka pagesë të TVSH për 2024.
IPA 2020	40,000€	12,000 <sup>12</sup> €		
<b>TOTAL</b>	240,000€	147,954.76€		

Nga krahasimi i vlerave të parashikuara nga CFCU mbi nivelin e pagesave në nivel projekti dhe përlogaritjeve të TVSH-ve respektive si dhe nivelin e realizimit të pagesave faktike për TVSH e çdo projekti, rezulton se:

- Planifikimi i kryer nga ana e CFCU është jo realist, kjo për vet faktin se, nga njëra anë mbështetet mbi totalin e vlerës (në parashikimin e këtyre vlerave nuk është marrë në konsideratë vlera e zbritshme e pagesës së parafinancimit) dhe nga ana tjetër operohet në fazë të hershme, mbi një formulë matematikore që të nxjerr në vlera të përafërta. Në kushtet kur, ky parashikim do të shërbejë si informacion kryesor për Drejtorinë e Fondit Kombëtar për të përcaktuar vlerat e fondeve të TVSH-së për fondet IPA, të cilat duhet të përfshihen në buxhetet përkatëse të institucioneve përfituese të projekteve, planifikimi jo realist në nivele disa herë më të larta se realizimi faktik, ndikon në dëgjie të fondeve të dedikuara për TVSH-në në buxhetet përkatëse; (AL 20 IPA JH 01 21 parashikim në kundravajtje ligjore ku vlera e kërkuar është afërsisht 8% e asaj të parashikuar dhe No. AL/IPA2019/1 ku vlera e kërkuar dhe paguar është afërsisht 15% e vlerës së parashikuar).

Nga auditimi i dokumentacionit mbi korrespondencën zyrtare mes CFCU dhe Fondit Kombëtar vendosur në dispozicion rezultoi se nga CFCU nuk dërgohej zyrtarisht parashikimi për vlerat e TVSH.

- Për vitin 2022, nga ana e CFCU nuk është dërguar zyrtarisht (rezulton prania e një dokumenti word i cili pretendohet të jetë dërguar via email, por nuk përmbush ekstremitetet) vlerat e parashikuara për efekt TVSH-jë për fondet IPA. *Email datë 27.04.2022 për parashikimet e TVSH-së për programet IPA 2017 dhe 2019.*

- Për vitin 2023, nga ana e CFCU nuk është dërguar zyrtarisht (rezulton prania e një dokumenti word i cili pretendohet të jetë dërguar via email, por nuk përmbush ekstremitetet) vlerat e parashikuara për efekt TVSH-jë për fondet IPA. E mail datë 14.06.2023 për parashikimet e TVSH-së për programet IPA 2017, IPA 2019 dhe IPA 2020.

- Për vitin 2024, nga ana e CFCU nuk është dërguar zyrtarisht (rezulton prania e një dokumenti word i cili pretendohet të jetë dërguar via email, por nuk përmbush ekstremitetet) vlerat e parashikuara për efekt TVSH-jë për fondet IPA. E mail datë 10.06.2024 për parashikimet e TVSH-së për programet IPA 2019 dhe IPA 2020.

*Sa më sipër në kundërshtim me udhëzimin nr. 10, datë 09.03.2015, pika II.3*

*Referuar vlerave faktike të TVSH së paguar në nivel projekti:*

Projekti/kontrata		Vlera e parashikuar	Vlera e kërkuar	Vlera e paguar	Diferenca
Avokati i Popullit AL 20 IPA JH 01 21 A.O.B	Support to the Office of the People's Advocate and promotion of human rights in Albania	10.000 Euro (2022 nga shume totale 190.000 eur)	804.19 Euro	-	

<sup>10</sup> Ky parashikim mbështetet në faktin që gjatë vitit 2024 pritet të validohet pjesa e mbetur e shpenzimeve

<sup>11</sup> TVSH në shumën 15,954.76 është TVSH e mbartur nga viti 2023 dhe është ekzekutuar gjatë vitit 2024.

<sup>12</sup> TVSH mbështetur në përlogaritjet e buxhetit për kontratën Grant

ISHP AL 20 IPA HE 01 21 I.N.I.H	"Support to enhance the organisation and governance of the Institute, strengthen its capacity for data collection, epidemiological analysis....	30.000 Euro	0	0	
EMA No. IPA2017/AL/10	Strengthening organizations in Albania on consumer protection	€ 12,486.23 nga shume totale (96,140.05 Euro)	Aneksi V i referohet vetem shume EU fund. TVSH eshte subjekt pas finalizimit te kontrollit financiar	267,216.56 ALL (2204.21 Euro) bazuar ne kursin e kembimit te parafiancimit	10,282.01 Euro
AEE AL 20 IPA EY 01 22	Strengthening the overall capacity and effectiveness of the Agency for Energy Efficiency	10,000 Euro	0	0	
NEAR/TIA/2023/EA-RP/0067	Support the State Advocate to bring judicial practices and human rights standards (including peer-to-peer exchange, trainings and justified study visits)	30.000 Euro	Kontrate nen zbatim deri tani eshte paguar vetem parafiancimi		
S. <sup>13</sup> O.S.F.A No. AL/IPA2019/1	EU support to Inclusive Education in Albania	101.174.00 Euro	15,954.76 Euro	15,954.76 Euro	85,219.24 Euro
"ICLA" IPA2017/AL/6	CSOs as advocates for implementation of horizontal environmental legislation at the local level	9,885.20 Euro nga shume totale ( 96,140.05 Euro)	Aneksi V i referohet vetem shume EU fund. TVSH eshte subjekt pas finalizimit te kontrollit financiar	203,048.69 ALL (1646.65 Euro)	8,238.55 Euro
"IZHIQ" IPA2017/AL/12	Towwrd EU: Strengthening CSOs and local government for better consumer protection	10,334.26 nga shume totale ( 96,140.05 Euro)	Aneksi V i referohet vetem shume EU fund. TVSH eshte subjekt pas finalizimit te kontrollit financiar	117,370.38 ALL (951.83 Euro) bazuar ne kursin e kembimit te parafiancimit	9,382.43 Euro
AL 17 IPA FI 02 20 A.E.I	Mbështetje për Administratën Doganore Shqiptare në lidhje me zbatimin e kodeve doganore europiane dhe rritjen e kapaciteteve operacionale në fushën e mallrave të falsifikuara	0	0	0	0
AL/IPA2017/8 COSPE	ECO Friends – Miqtë Operativë të Mjedisit dhe Klimës	12,802.00 Euro nga totali 96140.05 Euro	227,597.22 ALL (1845.93 Euro sipas kursit te kembimit te parafiancimit, i cili ka qene me i larte se kursi ne fund te kontrates)		

<sup>13</sup> Kjo kontrate eshte ende nen zbatim

Fondet IPA qëndrojnë në llogarinë e Bankës së Shqipërisë të aksesueshme nga Fondi Kombëtar, për tu përdorur për kryerjen e pagesave nga CFCU në llogaritë e kontraktorëve, pavarësisht periudhës në të cilën kryhen pagesat, pasi ky fond nuk planifikohet në nivel vjetor. Ndërkohë që fondet për TVSH-në e pagueshme nga Buxheti i Shtetit, qëndrojnë në llogaritë respektive pranë bankave të nivelit të dytë, ku çdo institucion sipas planifikimit të kryer nga CFCU për pagesat e pritshme në bazë të kontratave IPA, duhet të buxhetojë vlerat e TVSH-së që do të paguhen gjatë vitit.

### **Mbi planifikimin e TVSH-së**

Nga krahasimi i vlerave të parashikuara nga CFCU mbi nivelin e pagesave në nivel projekti dhe përlllogaritjeve të TVSH-ve respektive si dhe nivelin e realizimit të pagesave faktike për TVSH e çdo projekti, rezulton se:

- Planifikimi i kryer nga ana e CFCU është jo realist, kjo për vet faktin se, nga njëra anë mbështetet mbi totalin e vlerës (në parashikimin e këtyre vlerave nuk është marrë në konsideratë vlera e zbritshme e pagesës së parafinancimit) dhe nga ana tjetër operohet në fazë të hershme, mbi një formulë matematikore që të nxjerr në vlera të përafërta.

Në kushtet kur, ky parashikim do të shërbejë si informacion kryesor për Drejtorinë e Fondit Kombëtar për të përcaktuar vlerat e fondeve të TVSH-së për fondet IPA, të cilat duhet të përfshihen në buxhetet përkatëse të institucioneve përfituese të projekteve, planifikimi jo realist në nivele disa herë më të larta se realizimi faktik, ndikon në djegie të fondeve të dedikuara për TVSH-në në buxhetet përkatëse; (AL 20 IPA JH 01 21 parashikim në kundravajtje ligjore ku vlera e kërkuar është afërsisht 8% e asaj të parashikuar dhe No. AL/IPA2019/1 ku vlera e kërkuar dhe paguar është afërsisht 15% e vlerës së parashikuar).

*Nga auditimi rezultoi problematikë mbi parashikimin dhe më tej miratimin e vlerës së TVSH-së për kontratat e binjakëzimit.*

- Së pari nga ana e CFCU është operuar me parashikim të vlerës së TVSH-së për kontratat tip t<sup>w</sup>inning ose t<sup>w</sup>inning light, në kundërshtim me Manualin e Binjakëzimit ku në Manualin e Binjakëzimit nuk është parashikuar pagesë TVSH-je për T<sup>w</sup>inning Contract (AL 20 IPA JH 01 21).

- Së dyti, nga ana e CFCU është aprovuar rimbursimi i vlerës së TVSH-së (projekti AL 20 IPA JH 01 21 me vlerë TVSH 852.44 Euro) në kushte jo të drejta, në kundërshtim të Manualit të Binjakëzimit, referuar kontratës mes palëve, kushteve të përgjithshme të saj, neni 6.2.15 parashtron se *...kostot indirekte mbulojnë 6% të shpenzimeve totale të eligible cost ndërkohë neni 6.2.1 General remarks parashtron se ... Duties, taxes and charges including VAT are not eligible under the T<sup>w</sup>inning Grant Contract...*

Nga auditimi u konstatua se, në 2 (dy) nga 8 (tetë) rastet e përzgjedhura për tu audituar transferta bankare është kryer më vonë nga afati i paracaktuar prej Fondit Monetar në shkresën e aprovimit, duke bërë që fondet të mbahen në llogari për më tepër se 24 orë dhe rritur kështu riskun e krijimit të interesave, sa më sipër në kundërshtim me Marrëveshjen e Implementimit mes NIPAC, NAO dhe CFCU neni 16 pika 4 që specifikon kryerjen e transaksionit brenda ditës së gjenerimit të fondeve në llogarinë bankare. Sa i takon kërkesave për fonde pranë FK, kjo çështje është trajtuar në material përgjatë pagesave të kryera për secilin projekt të përzgjedhur, duke nisur nga parafinancimi deri në financimin final. Në mënyrë të përmbledhur për secilin prej projekteve të analizuar, evidentohet:

#### *AL 20 IPA JH 01 21 A.O.B*

Parafinancimi referuar kërkesës për fonde nr.1 me vlerë 234,468.61 Euro, është bazuar në kërkesën nr 682 datë 04.07.2022 të dërguar nga shteti Austriak. CFCU ka kërkuar financim Fondit Monetar përmes kërkesës nr.689 prot., datë 05.07.22, miratuar nga Fondi Monetar me shkresën nr.13223/1 prot., datë 08.07.2022 protokolluar në CFCU me nr.689/1 datë 13.07.2022 Pagesa e kryer nga CFCU drejt shtetit përfitues, përmes A.B, me IBAN .....

Parafinancimi është paguar më datë 21.07.2022 bazuar në nenin 4.1 Special Condition të kontratës. Fondi Monetar ka miratuar pagesën më datë 08.06.2022 (me korrigjim muaji) dhe përcakton afat maksimal transferte datën 20.07.2022. Transferta bankare mban datë 21.07.2022 sa më sipër operuar në kundërshtim me Marrëveshjen e Implementimit mes NIPAC, NAO dhe CFCU neni 16 pika 4 ku specifikohet se transferta duhet kryer brenda ditës me qëllim mos mbajtjen e fondeve në llogari.

Financimi final referuar kërkesës për fonde të sjell nga shteti anëtar me shkresën nr.812 prot., dt 8.8.23 rezulton me vlerën 33,867.56 Euro, mbas kontrollit financiar CFCU ka kërkuar miratim Fondit Monetar përmes kërkesës nr.7 me nr.1169 prot, dt 5.12.23 me vlerë 33,015.12 Euro. Kjo diferencë ka ardhur për shkak të zbritjes së vlerës 852.44 Euro nga kontrolli financiar, e cila përfaqëson vlerën e TVSH që është kërkuar për zbritje.

Fondi Monetar ka miratuar pagesën më datë 11.12.2023 dhe përcakton afat maksimal transferte datën 20.12.2023, ndërsa transferta bankare mban datë 14.12.2023.

Pagesa finale referuar kontratës ishte parashikuar në vlerën 65,529.55 Euro, vlerë e cila është zbritur në vlerën 33,015.12 Euro. Pagesa është kryer nga CFCU drejt shtetit përfitues, përmes A.B, me IBAN .....

#### *AL 20 IPA HE 01 21 I.N.I.H*

Parafinancimi referuar kërkesës për fonde të ardhur me shkresën nr.468 datë 10.05.2022 me vlerë 195,742.14 Euro Kërkesa e dërguar nga shteti anëtar me nr.468 prot., datë 10.05.2022, nga ana e CFCU dërguar kërkesë Fondit Monetar me shkresën nr.509 prot., datë 19.05.2022. Miratuar nga ana e Fondit Monetar nr.9113/1 prot., datë 20.05.2022 dhe përcakton afat maksimal transferte datën 27.05.2022. Transferta bankare mban datë 27.05.2022, me IBAN .....

Parafinancimi është paguar më datë 27.5.2022 bazuar në nenin 4.1 Special Condition të kontratës. Financimi final referuar kërkesës për fonde të sjell nga shteti anëtar me shkresën nr. 1213/2 prot., dt 26.03.2023 rezulton me vlerën 47,816.18 Euro, mbas kontrollit financiar CFCU ka kërkuar financim Fondit Monetar përmes kërkesës nr.4 me nr.688 prot, dt 5.7.23 me vlerë 47,816.18 Euro. Fondi Monetar ka aprovuar me shkresën nr.12360/1 prot., datë 07.07.2023 protokolluar në CFCU me nr.688/1 prot., datë 07.07.2023 dhe përcakton afat maksimal transferte datën 14.07.2023. Transferta bankare mban datë 13.07.2023, me IBAN .....

#### *IPA2017/AL/10 EMA*

Parafinancimi referuar kërkesës për fonde nr.4 me vlerë 68,503.23 Euro, bazuar në listën CFCU i është drejtuar FM për fondet sipërcituar (bashkangjitur kërkesës për fonde nr.4/2021) me shkresën nr. 429 datë 20.04.2021. Parafinancimi është 78.91 % i shumës që financon BE (86,806.13 Euro). Parafinancimi është paguar më datë 28.04.2021 bazuar në nenin 4.1 Special Condition të kontratës. Fondi Monetar ka miratuar pagesën më datë 22.04.2021 dhe përcakton afat maksimal transferte datën 30.04.2021 Transferta bankare mban datë 28.04.2021.

Financimi final referuar kërkesës për fonde të sjell nga shteti anëtar me shkresën nr.812 prot., dt 8.8.23 rezulton të jetë parashikuar me vlerën 19,983.33 Euro, mbas kontrollit financiar CFCU ka kërkuar financim Fondit Monetar përmes kërkesës nr.14 me nr.988 prot, dt 5.10.23 me vlerë



14,572.06 Euro. (Shumës me kontributin e pastër të BE 83,075.29 Euro i zbritet parafinancimi 68,503.23 Euro dhe rezulton pagesa finale prej 14,572.06 Euro). Fondi Monetar ka miratuar pagesën më datë 20.10.2023 dhe përcakton afat maksimal transferte datën 20.10.2023. Transferta bankare mban datë 17.10.2023.

#### *AL 20 IPA EY 01 22 AEE*

Nga auditimi mbi dokumentacionin referuar pagesave të kryera, rezulton e finalizuar një pagesë (kjo për shkak se, sikundër sipërcituar është nën kontroll final):

Para financimi referuar kërkesës për fonde dërguar nga CFCU drejt FM me shkresën nr.809 prot., datë 07.08.2023 rezulton në vlerën 198,188.62 Euro.

Aprovimi i parafinancimit nga FM me shkresën nr.14709/1 prot., datë 10.08.2023 dhe përcakton afat maksimal transferte datën 25.08.2023. Transferta bankare mban datë 15.08.2023.

Parafinancimi është paguar në përputhje me Nenin 4 "Raportimi dhe pagesat" të Kushteve Specifike të Kontratës, pika 4.1.

Pjesa e mbetur e pagesës parashikuar në kontratë rezulton në shumën 51,811.38 Euro.

Nga auditimi rezultoi se, pagesa e parafinancimit në vlerën 198,188.62 Euro transferuar në U. IBAN ..... nga Autoriteti Kontraktor.

Totali i shpenzimeve rezultonte në 196,994.09 Euro, më pak se vlera e parafinancimit. Sa më sipër, parafinancimi ka mbuluar totalin e shpenzimeve dhe rezulton vlerë e papërdorur prej 1,194.53 Euro. Pas kontrollit financiar nga CFCU rezulton se, totali i shpenzimeve të njohura është 196,966.30 Euro, e cila përfaqëson edhe shumën e validuar. Referuar shumës së validuar dhe asaj të parashikuar rezulton diferenca kredituese në vlerë 1,222.32 Euro.

#### *NEAR/TIA/2023/EA-RP/0067*

Nga auditimi mbi dokumentacionin referuar pagesave të kryera, rezulton e finalizuar një pagesë (kjo për shkak se, sikundër sipërcituar është nën proces implementimi), *pra deri ne 30 Qershor 2024 është kërkuar vlera e parafinancimit në shumën 139,860.00 Euro.*

Para financimi referuar kërkesës për fonde dërguar nga CFCU drejt FM me shkresën nr.555 prot., datë 20.06.2024 rezulton në vlerë 139,860.00 Euro.

Aprovimi i parafinancimit nga FM me shkresën nr.8637/1 prot., datë 24.06.2024. Parafinancimi është paguar në përputhje me Nenin 29 "Raportimit dhe pagesat" të Kushteve të Veçanta të Kontratës pika 29.1.

Nga auditimi rezultoi se, pagesa e parafinancimit në vlerën 139,860.00 Euro transferuar në U. IBAN ..... nga Autoriteti Kontraktor.

#### *AL/IPA2019/1 S. O.S.F.A*

Mbështetur në kërkesën për fonde nga ana e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, me nr.1186 prot., datë 28.02.2022 protokolluar në CFCU 232 prot., dt 28.02.2022 është kërkuar pagesa e parë për të mbuluar periudhën shkurt 2022-shkurt 2023.

CFCU drejtuar FM me kërkesën për fonde me shkresën nr 250 prot., datë 07.03.2022, miratuar nga FM me nr.4470/1 prot., datë 10.03.2022 dhe përcakton afat maksimal transferte datën 21.03.2022. Transferta bankare mban datë 24.03.2022. sa më sipër operuar në kundërshtim me Marrëveshjen e Implementimit mes NIPAC, NAO dhe CFCU neni 16 pika 4, që specifikon kryerjen e transaksionit brenda ditës së gjenerimit të fondeve në llogarinë bankare.

Pagesa e parafinancimit në vlerën 748,926.23 Euro transferuar në A.B, IBAN ..... nga Autoriteti Kontraktor.

Nga ana e CFCU është kryer Parafinancimi i parë (further pre-financing):

Mbështetur në kërkesën për fonde nga ana e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, me nr.1319 prot., datë 11.04.2023 protokolluar në CFCU 401 prot., dt 12.04.2023 është kërkuar vlera prej 1,009,605.33 Euro për të mbuluar periudhën 12 shkurt 2023- 11 shkurt 2024.

Parafinancimi i parë (further pre- financing) (pas kalkulimeve dhe formulës së zbatuar) në mbështetje të nenit 15.1 të GC që është kërkuar për miratim nga CFCU pranë FM me shkresën nr. 842 prot., datë 21.08.2023 rezulton në vlerën 723,398.20 Euro. Me një vonesë nga ana e CFCU prej (4.2 muaj)

Miratimi i kësaj vlerë prej FM është kryer me shkresën nr.15269/1 prot., datë 29.08.2023. FM citon në shkresën miratuese se, vlera disponibël e fondeve për këtë program është më e ulët se ajo e kërkuar. Për të plotësuar vlerën e munguar FM ka nisur procedurën Bridge Financing. TVSH do të transferohet në momentin që likuiditetet do të jenë të disponueshme.

Vlera prej 723,398.20 Euro është transferuar në llogari të përfuturit me IBAN ..... më datë 03.10.2023

#### *AL/IPA 2017/12 IZHIQ*

Parafinancimi referuar kërkesës për fonde nr.4 me vlerë 54,955.05 Euro, bazuar në listën CFCU i është drejtuar FM për fondet sipërcituar (bashkangjitur kërkesës për fonde nr.4/2021) me shkresën nr. 429 datë 20.04.2021. Parafinancimi është paguar më datë 28.04.2021 bazuar në nenin 4.1 Special Condition të kontratës. Fondi Kombëtar ka miratuar pagesën më datë 22.04.2021 dhe përcakton afat maksimal transferte datën 30.04.2021, (pagesa e aprovuar në vlerë të plotë për fondet IPA). Transferta bankare mban datë 28.04.2021.

Financimi final referuar kërkesës për fonde të sjell nga shteti anëtar me shkresën dt 28.4.23 rezulton të jetë parashikuar me vlerën 13,449.44 Euro.

Kërkesa e CFCU drejtuar Fondit Monetar me shkresën nr.808 prot., datë 07.08.2023 në tabelën bashkangjitur “Kërkesë për fonde nr.13/2023” specifikon vlerën prej 26,252.25 Euro ku në listën e detajuar bashkangjitur përcaktohet vlera për projektin IZHIQ në shumën 10,942.96 Euro, mbas kontrollit. Aprovuar nga Fondi Monetar me shkresën nr.14710/1 prot., datë 11.08.2023 (pagesa e aprovuar në vlerë të plotë për fondet IPA) përcakton afat maksimal transferte datën 25.08.2023.

Mbas kontrollit financiar CFCU ka kërkuar financim Fondit Monetar përmes kërkesës nr.13 me nr.808 prot, dt 7.8.2023 me vlerë Euro. Transferta bankare mban datë 15.08.2023 dhe mban vlerën prej 10,942.96 Euro në llogari IBAN ..... Nga ana e CFCU është paguar vlera e TVSH-së prej 117,370.38 lekë me po të njëjtën transfertë në llogari IBAN .....

#### *AL/IPA 2017/6 ICLA*

Parafinancimi referuar kërkesës për fonde nr.4 me vlerë 428,890.04 Euro, bazuar në listën CFCU i është drejtuar FM për fondet sipërcituar (bashkangjitur kërkesës për fonde nr.15/2023 specifikohet vlera 60,860.80 Euro) me shkresën nr. 429 prot., datë 20.04.2021. Parafinancimi është paguar më datë 28.04.2021 bazuar në nenin 4.1 Special Condition të kontratës.

Fondi Kombëtar ka miratuar pagesën me shkresë nr.7178/1 prot., datë 22.04.2021 dhe përcakton afat maksimal transferte datën 30.04.2021, (pagesa e aprovuar në vlerë të plotë për fondet IPA). Transferta bankare mban datë 28.04.2021.

Financimi final referuar kërkesës për fonde të sjell nga shteti anëtar me shkresën dt 29.06.2023 me vlerën 15,215.20 Euro, Kërkesa e CFCU drejtuar Fondit Monetar me shkresën nr. 1097 prot., datë 06.11.2023 në tabelën bashkangjitur “Kërkesë për fonde nr.15/2023” specifikon vlerën prej 10,745.38 Euro. Aprovuar nga Fondi Monetar me shkresën nr.20246/1 prot., datë 09.11.2023 dhe përcakton afat maksimal transferte datën 17.11.2023, (pagesa e aprovuar në vlerë të plotë për fondet IPA). Transferta bankare mban datë 17.11.2023.

Transferta bankare mban datë 15.08.2023 dhe mban vlerën prej 10,745.38 Euro në llogari IBAN ..... Nga ana e CFCU është paguar vlera e TVSH-së prej 203,048.69 lekë me po të njëjtën transfertë në llogari IBAN .....

#### *AL 17 IPA FI 02 20 AEI*

Parafinancimi i është referuar kërkesës për fonde me nr. kërkesës për fonde nr. 3 me vlerë 312,643.29 Euro, bazuar në listën për IPA 2017, ku CFCU i është drejtuar FK për fondet sipërcituar me shkresën nr. 2754/1 prot., datë 18.12.2020, pasi me shkresën hyrëse nr. 2733 prot., datë 15.12.2020, AEI ka kërkuar lëvrimin e fondit të parafinancimit në vlerën 312,643.29 Euro për kontratën në fjalë. Referuar vlerës së parafinancimit shprehur në nenin 4.1 Reporting and Payment Arrangements të kontratës, parafinancimi është paguar më datë 29.12.2020. Transferta bankare mban datë 29.12.2020 në llogarinë bankare të AEI me nr. ....

Kërkesa e CFCU drejtuar Fondit Kombëtar me shkresën nr. 570 prot., datë 19.05.2022, kërkesë për fonde nr. 6, i referohet kërkesës për financim të pagesës së mbetur, ardhur në CFCU me shkresën e datës 17.01.2022 nga AEI, për pagesën prej 57,699.57 Euro. Përmes kërkesës drejt FK, CFCU ka kërkuar fondet në vlerën 57,699.57 Euro sipas Aneksit bashkëlidhur për kontratën AEI. FK ka miratuar kërkesën për fonde nr. 6/2022 me shkresën nr. 9114/1 prot., datë 20.05.2022 dhe ka përcaktuar si datë maksimale datën 27.05.2022.

CFCU me urdhër transfertën e datës 27.05.2022 ka kaluar në llogarinë bankare të AEI me nr. .... shumën prej 57,699.57 Euro. Ka një credit note për gabim në koston e tremujorit të parë në vlerën 57,709.02 Euro, pra në koston totale duhet të reflektohet 56,852.54 Euro. Referuar faturës nr. 94/2021 për Flesh Tirana, AEI ka rënë dakord që shuma prej 53.76 Euro të zbritet nga kërkesa fillestare e vlerës 57,699.75 Euro.

#### *AL/IPA2017/8 COSPE*

Para-financimi i është referuar kërkesës për fonde nr. 5/2021 me vlerë 68,371.22 Euro, bazuar në listën ku CFCU i është drejtuar FK për fondet sipërcituar (bashkangjitur kërkesës për fonde nr.5/2021) me shkresën nr. 488 prot., datë 05.05.2021 dhe kërkesës për pagesë nga COSPE me shkresën nr. 475 prot., datë 04.05.2021. Fondi Kombëtar ka miratuar pagesën më datë 07.05.2021 dhe përcakton afat maksimal transferte datën 14.05.2021, (pagesa e aprovuar në vlerë të plotë për fondet IPA). Transferta bankare mban datë 12.05.2021 drejt llogarisë bankare të COSPE me nr. ....

Me shkresën nr. 335/2 prot., datë 27.03.2023, COSPE ka paraqitur në CFCU kërkesën për pagesën finale në vlerë 17,092.80 Euro. Kërkesa e CFCU drejtuar Fondit Kombëtar me shkresën nr. 988 prot., datë 05.10.2023 në tabelën bashkangjitur “Kërkesë për fonde nr. 14/2023” specifikon vlerën prej 19,983.33 Euro ku në listën e detajuar bashkangjitur përcaktohet vlera për projektin COSPE në shumën 17,092.80 Euro, nga ku 5,411.27 Euro përballohen nga BE (*amount to be transferred to CFCU amount*). Sipas aprovimit nga Fondi Kombëtar me shkresën nr. 18283/1 prot., datë 11.10.2023 (pagesa e aprovuar në vlerë të plotë për fondet IPA) përcaktohet afat maksimal transferte data 20.10.2023. Transferta bankare mban datë 19.10.2023 dhe vlerën prej 5,411.27 Euro në llogarinë e COSPE me nr. ....

#### **Mbi monitorimin dhe kontrollin e ecurisë së kontratave, auditime dhe trajnime të kryera.**

##### *Mbi kontrollet “on the spot”*

Referuar informacionit dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezulton se përgjatë periudhës objekt auditimi nga ana e CFCU janë kryer kontrole “on the spot” për kontratat granti apo shërbime, në varësi të momentit të lidhjes së tyre.

Sa i takon vitit 2021, është miratuar Plani Vjetor për kontrollet “on the spot” me shkresën nr. 2821/1 prot., datë 30.12.2020 (dërguar edhe pranë MFE). Në të janë planifikuar 3 vizita për 3 kontrata nën IPA2014, 13 vizita për 13 kontrata nën IPA2015 dhe kontroll për 1 kontratë nën IPA2017 duke parashikuar për vizita ad-hoc nëse lind nevoja përgjatë vitit.

Ndërsa në muajin Maj, ky plan është rishikuar me shkresën nr.545/1 prot., datë 25.05.2021, me arsyetimet e mëposhtme:

- Lidhur me kontratën “Implementimi i reformës së shërbimit civil në administratën publike” është riskeduluar vizita pasi adendumi nr. 5 për zgjatje në kohë ka qenë në proces përgjatë muajit Prill 2021.

- Lidhur me kontratën “Ndërtimi i kapaciteteve të administratës publike shqiptare për lëvizjen e lirë dhe luftën kundër trafikut të paligjshëm të objekteve kulturore”, është riskeduluar një tjetër vizitë në Qershor-Korrik 2021, në vijim të zgjatjes së kohës së implementimit me adendumin nr. 3.

- Lidhur me kontratën e grantit me numër IPA 2015/AL/19 (A.E.I.NA), vizita on the site është riskeduluar pasi adendumi nr. 1 për zgjatje në kohë ka qenë në proces në muajin Shkurt 2021;

- Lidhur me skemën e grantit “Mbështetje për organizatat e shoqërisë civile për bashkëpunim të shtuar me institucionet shtetërore lidhur me procesin e integritit europian” nën IPA 2017, kontratat e grantit nuk ishin nënshkruar ende, ndaj është parashikuar kontrolli on the spot për 9 përfituesit e grantit (18 vizita).

Rezulton se sipas memos së datës 19.01.2022, sa i takon planit të vitit 2021, vizitat janë kryer, por referuar shpjegimeve në 5 raste janë shtyrë datat e vizitave, një vizitë nuk është kryer për arsye shëndetësore të stafit të OJQ-së, por është kërkuar informacion përmes email, dhe në 4 raste vizitat nuk janë kryer në terren, por në ambientet e CFCU për shkak të çështjeve logjistike.

Konstatohet se përgjatë vitit 2021, nuk janë realizuar praktikisht kontrollet në vend (“on the spot”) për të gjitha kontratat e parashikuara, pasi në 4 raste janë kryer takime pranë ambjenteve të CFCU, duke mos mundur kontrollin fizik në terren të ambjenteve dhe dokumentacionit, por duke u kufizuar në takime ku dokumentacioni limitohet në atë çka mund të sjellë vetë organizata përkatëse që po zbaton kontratën e grantit. Për më tepër, plotësimi i checklistave në rastet kur nuk ka kontroll në terren, por takim në zyrë, nuk përfshin në mënyrë të plotë dhe shteruese kontrollin në të gjithë konceptin e tij. Gjithashtu, për një takim në zyrë për kontratën “Mbështetje e organizatave të shoqërisë civile dhe përfaqësuesve të palëve të interesit me rekorde në mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin të mbetjeve” nuk ka plotësim të checklistës, por vetëm minuta takimi. Në këtë kuadër, konstatohet se CFCU nuk ka kryer në mënyrë të plotë e të thelluar kontrollet “on the spot” përforcuar nga fakti se disa takime janë kryer jo në terren por në zyra, referuar edhe gjithë shpjegimeve më sipër.

Përgjatë kontrolleve “on the spot” ka patur përdorim të checklistave të përditësuara sipas versionit nr. 3 të Manualit të Brendshëm të Procedurave të CFCU, edhe pse nuk janë miratuar zyrtarisht nga NAO, me argumentimin nga CFCU se janë përdorur për përmirësimin e vijueshëm të punës. Në mënyrë të përmbledhur nga dokumentacioni i kontrolleve “on the spot” përgjatë vitit 2021, janë evidentuar mosrakordime përgjatë dokumentit, pasi në disa raste sipas checklistave janë evidentuar vonesa në implementim apo mangësi të ndryshme, ndërsa përgjatë konkluzionit përcaktohet se nëse vijohet me implementimin në kohë, ecuria do të jetë e mirë.

Gjatë auditimit të kontrolleve “on the spot” për vitin 2022 ishin parashikuar 23 vizita nga të cilat 3 vizita u vendosën të mos kryheshin, 2 vizita u kryen jashtë afatit. Gjithashtu nuk janë pjesë e dosjes kontrollet e kryera në 4 prej kontratave.

Në vitin 2023 vihet re se ishin parashikuar 8 vizita on-site nga të cilat 4 u performuan sipas planifikimit (pra 50% e planit). Arsyet për mosrealizimin e vizitave ishin si më poshtë:

Shkurt 2023: Vizita on site për projektin “Pro-consumers, a step further towards EU requirements” u përfshi gabimisht si pjesë e planit duke qenë se periudha e implementimit përfundonte në 29 Janar 2023 ndërkohë që on-site parashikohej të kryhej në Shkurt 2023. Këtu kemi të bëjmë me planifikim të gabuar nga ana e CFCU.

Maj-Qershor 2023 “Support for the implementation of Population and Housing Census”: nuk u mbajt për shkak të hyrjes me vonesë të addendum nr.4 të kontratës. U vendos të performohen kontrollet në vizitën e dytë.

Shkurt 2023: “CSO as advocates for implementation of horizontal legislation at the local level-Vlora Region” dhe “Strengthening organizations in Albania on Consumer Protection”: nuk u mbajtën për shkak të punës së madhe dhe mungesës së stafit në sektorin e monitorimit. U vendos të performohet “desk based” në fazën e raportimit final.

Përsa i takon 6 mujorit të parë të vitit 2024, rezulton se janë parashikuar 5 vizita për 4 kontrata nën programet IPA 2014, IPA 2019 dhe IPA 2020, ku 3 kontrata janë kontrata granti dhe një kontratë është kontratë shërbimi. Duke qenë se viti 2024, mbulon vetëm 6 mujorin e parë të tij si periudhë objekt auditimi, nuk ka patur raport vjetor kontrolli lidhur me vizitat e kryera, megjithatë për vizitat e planifikuara përpara muajit Qershor 2024 (3 vizita të planifikuara në Mars dhe Maj-Qershor) nuk është paraqitur dokumentacion vërtetues mbi kryerjen e tyre pranë grupit të auditimit.

Shpjeguar sa më sipër, rezulton se kontrolli nuk është ezauruar në konceptin e plotë dhe shterues të tij përgjatë periudhës objekt auditimi lidhur me kontrollet “on the spot” të kryera për kontratat e granteve/shërbimeve.

#### Mbi kontrollet ex-ante dhe ex-post

Në programet IPA, procedurat e kontrollit ex-ante dhe ex-post, paraqesin momente të ndryshme të kontrollit, lidhur me momentin e inicimit të procedurës së prokurimit, nënshkrimit të kontratës, etj. Nën menaxhimin indirekt me kontrolle ex-ante ose ex-post, EUD ushtron kontrolle mbi procedurat dhe proceset e ndërmarra nga Autoriteti Kontraktor bazuar në marrëveshjet e vendosura. Në analizën sipas programeve përkatëse IPA, rezulton se ndarja e kontrolleve ex-ante dhe ex-post që nga implementimi i programit dhe deri në 30.06.2024, për vlerën e buxhetuar sipas Planit të Prokurimit, ka qenë si në vijim:

**Tabela:** Kontrollet ex-ante dhe ex-post për kontratat nën programet IPA sipas vlerës së buxhetuar në Planin e Prokurimit (në vlerë dhe përqindje)

*Në 000/Euro*

	IPA 2014		IPA 2015		IPA 2017		IPA 2019		IPA 2020	
<i>Ex-ante</i>	10,300	63%	12,000	70%	1,850	100%	2,000	100%	2,450	100%
<i>Ex-post</i>	6,000	37%	2,700	16%	-	0%	-	0%	-	0%

Burimi: Të dhënat nga CFCU. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Konstatohet se kontrollet ex-post kanë qenë prezente për kontrata nën programet IPA 2014 dhe 2015, duke u paraqitur në rënie, ndërsa për programet IPA 2017, 2019 dhe 2020 kontrollet kanë qenë vetëm të formës ex-ante. Lidhur me kontrollet ex-post dhe faktit se ato mbartin risqe më të larta sesa kontrollet ex-ante në kuptim të risqeve potenciale mbi refuzimin e lëvrimin final të fondeve apo mbi problematika të ngjashme, rezulton se për periudhën objekt auditimi (01.01.2021 – 30.06.2024):

- Për programin IPA 2014, të gjitha kontrollet ex-post u përkasin kontratave të lidhura dhe të përfunduara përpara periudhës objekt auditimi.
- Për programin IPA 2015, vetëm dy kontrolle ex-post u përkasin kontratave të përfunduara brenda periudhës objekt auditimi, përkatësisht për kontratën “Ekspertë (vlerësues) për të ndihmuar në vlerësimin e aplikimeve për grante të marra në kuadër të thirrjes për propozime sipas IPA 2015 dhe IPA 2017 NP (menaxhimi indirekt)”/“Mbështetje për Organizatat e Shoqërisë Civile për Implementimin e Veprimeve për Ngritjen e Kapaciteteve për Rritje Dialogu i Politikave dhe Ndërgjegjësimi për Integrimin Evropian” në vlerë 7,500 Euro dhe kontratën “Asistencë Teknike për të koordinuar dhe zbatuar reformën kombëtare në fushën e punësimit dhe aftësive (NESS)” e cila duhet të përfundonte në 29.03.2022, por AK e ka ndërprerë më 06.02.2019, pra përpara periudhës objekt auditimi.

### Mbi trajnimet e stafit

Referuar trajnimeve të vijueshme për rritjen dhe forcimin e kapaciteteve të stafit të punësuar pranë CFCU, për punonjësit e Drejtorisë së Menaxhimit të Prokurimeve dhe Kontraktimeve për fondet e BE-së, rezulton se për periudhën objekt auditimi janë kryer trajnimet e mëposhtme.

Përgjatë vitit 2021 janë realizuar 9 trajnime: 6 trajnime të ofruara nga ASPA dhe 3 trajnime të ofruara nga TA, ku në total janë trajnuar 20 punonjës.

Për vitin 2022, janë realizuar 10 trajnime: 5 trajnime ofruar nga ASPA, 1 trajnim ofruar nga GIZ, 3 trajnime ofruar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe 1 trajnim ofruar nga Ministria e Brendshme, ku janë trajnuar 8 punonjës.

Për vitin 2023, janë realizuar 6 trajnime: 2 trajnime ofruar nga TAIEX, 2 trajnime nga COWI & Expertise Advisors, 1 trajnim nga GIZ, 1 trajnim nga IPA, ku janë trajnuar gjithsej 21 punonjës.

Për 6 mujorin e parë të vitit 2024, janë realizuar 4 trajnime nga Bashkëpunimi Rajonal për Integrimin në Bashkimin Evropian, implementuar nga WYG Consulting LTD and GIZ GmbH, ku janë trajnuar 5 punonjës.

Në total nga trajnimet e listuara dhe pjesëmarrja e stafit, si dhe referuar të gjitha problematikave/mangësi të evidentuara në monitorimin e implementimit të kontratave deri në pagesën e tyre, evidentohet nevoja e trajnimeve të vazhdueshme për stafin e Drejtorisë, me qëllim forcimin e kapaciteteve në ndjekjen e procedurave përkatëse në trajtimin, monitorimin dhe kontrollin e projekteve.

### **Mbi raportin e progresit të zbatimit të projekteve për efekt të raportimit dhe konsolidimit të treguesve fiskalë.**

Në kuadër të raportimit lidhur me zbatimin e projekteve për efekt të raportimit dhe konsolidimit të projekteve, nga ana e përfaqësuesve të Drejtorisë së Menaxhimit të Prokurimeve dhe Kontraktimeve për fondet e BE-së, është sqaruar se kjo drejtori kryen raportime drejt Fondit Kombëtar, në kuptim të kërkesave për fonde rast pas rasti, lidhur me kontratat nën programet IPA. Ndërkohë, sa i takon marrëdhënies me Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit, nga drejtoria argumentohet se nuk dorëzohen raportime. Megjithatë, në treguesit fiskal të publikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit dhe Ministria e Financave përgjatë periudhës objekt auditimi, në çdo rast raportohet zëri i treguesit fiskal “Investime Kapitale” me nënzërin “Financim i Huaj”, pjesë e të cilit, në mënyrë analitike, janë projektet me financim të huaj në Republikën e Shqipërisë. Megjithatë, për sa sqaruar më sipër, nga Drejtoria e Menaxhimit të Prokurimeve dhe Kontraktimeve për fondet e BE-së nuk është vënë në dispozicion informacion apo dokumentacion mbështetës lidhur me raportime drejt Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, mbi projektet me financim të huaj nën programet IPA, për periudhën objekt auditimi. Për më tepër, në kontratat dhe

projektet e audituara sipas dosjeve përkatëse, rezultojnë se i përkasin outputit të llojit “shërbim” dhe jo “mallra”, ndaj për to nuk ka qenë e mundur përcaktimi i vlerave të shpenzimeve kapitale (investime) të cilat mund të jenë pjesë e treguesve fiskalë të mësipërm.

***Personat që mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre:***

Znj. V. K, në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm.

Znj. L. R, me detyrë Drejtorit i Drejtorisë për Menaxhimin Financiar IPA.

Znj. S. H, me detyrë Drejtorit i Drejtorisë për Menaxhimin e Kontratave IPA.

Znj. D. M, me detyrë përgjegjës për Sektorin për Monitorimin e Zbatimit të kontratave.

Për sa është trajtuar në Projektraportin e auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me Nr.53/1 Prot dhe datë 06.01.2025, protokolluar në KLSH me Nr.1097/5 Prot., datë 10.02.2025, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit: I.** Në vijim lutem gjeni informacion të përditësuar mbi masat e marra për plotësimin e vendeve vakante të krijuara rishtazi.

**Spektori për Kontrollin e Cilësisë** është i përbërë nga përgjegjësi i sektorit dhe katër specialistë. Aktualisht në këtë sektor është vakant vetëm një pozicion specialist, për të cilin në bashkëpunim me DAP ka filluar procesi i rekrutimit (shpallja nr. 6766).

**Spektori për Përgatitjen e Dokumenteve të Prokurimit** është i përbërë nga përgjegjësi i sektorit dhe katër specialistë. Për shkak të nevojave të punës përgjegjësi i sektorit është transferuar në Sektorin për Kontrollin e Cilësisë. Aktualisht sektori mbulohet nga katër specialistë, dy me emërim të përhershëm, një me transferim të përkohshëm nga brenda Drejtorisë së Menaxhimit të Kontratave IPA (urdhri i DAP nr. 4969/1, datë 20.09.2024), si dhe një me kontratë një vjeçare nga skema e praktikave të punës. Ndërkohë në bashkëpunim me DAP pozicioni i Përgjegjësit të sektorit dhe dy pozicionet vakant specialist janë aktualisht në proces rekrutimi me shpalljet nr.6766 dhe 6897.

**Spektori për Monitorimin e Kontratave** është i përbërë nga përgjegjësi i sektorit dhe pesë specialistë. Aktualisht puna mbulohet nga dy specialist me emërim të përhershëm dhe një me kontratë të përkohshme pune. Shpallja e vendeve vakante parashikohet të bëhet në qershor 2025.

**Spektori për Vlerësimin dhe Kontraktimin e IPA** është i përbërë nga përgjegjësi i sektorit dhe pesë specialistë. Aktualisht në këtë sektor është vakant vetëm një pozicion specialist, për të cilin në bashkëpunim me dap ka filluar procesi i rekrutimit (shpallja nr. 6766). Ndërkohë që për vakancën e përkohshme të krijuar nga një specialist me lejë lindje është marrë masa e mbulimit nga një specialist me kontratë të përkohshme.

**Në Sektorin për Kontrollin Financiar, në Drejtorinë për Menaxhimin Financiar IPA,** janë bërë shpalljet për dy pozicione vakant specialist, me numër shpallje 6767. CFCU angazhohet të vijojë bashkëpunimin me DAP për të marrë masa për plotësimin e vendeve vakante në strukturën organizative.

**II.** Aktualisht Rregullorja e Brendshme e CFCU është në proces rishikimi dhe do të merren masat e nevojshme për finalizimin e saj brenda muajit mars 2025.

**III.** CFCU ka përmbushur në mënyrë të vazhdueshme udhëzimet dhe afatet e përcaktuara në Manualin e Binjakëzimit, duke siguruar përgatitjen e Fishës së Binjakëzimit dhe lidhjen e kontratave brenda afateve kontraktuale. Duhet mbajtur në konsideratë se kontratat e binjakëzimit kërkojnë pjesëmarrjen e administrative shtetërore të vendeve anëtare, të cilat në periudhat e pushimeve verore dhe dimërore mund të mos jenë të vëmendshme ndaj publikimit. Fleksibiliteti i përdorur në rastin e konstatuar është bërë për të siguruar nivelin e duhur të vizibilitetit dhe konkurueshmërisë pikërisht duke marrë në konsideratë periudhën e shpalljes (pushimet

verore/dimërore). Kjo qasje është plotësisht në përputhje me standardet të Bashkimit Evropian dhe rekomandimet e Delegacioni i Bashkimit Evropian (EUD), përgjegjës për aprovimin paraprak të çdo faze të procesit. Në këto kushte, me gjithë angazhimin tonë për përmirësim të vazhdueshëm të proceseve në tërësi, identifikimi i masave konkrete për adresimin i rekomandimit në formën e dhënë është i përcaktueshëm. Sa i përket mungesave të CV-ve të komisioneve të përzgjedhjes në kontratat e binjakëzimit, jemi të paqartë për kontratat specifike ku janë evidentuar këto mungesa. CV-të e komisioneve të përzgjedhjes në kontratat e binjakëzimit vlerësohen dhe janë kusht për ngritjen e Komisionit dhe miratimin e tij nga EUD. Lutem referoni rastin konkret në mënyrë që t'ju sigurojmë dokumentacionin përkatës.

**IV.** CFCU prej marrjes në disponim të ambienteve të arkivimit në fillim të vitit 2024, ka nisur procesin e inventarizimit të dokumentacionit të dosjeve, si dhe arkivimin e tyre në përputhje me normat tekniko-profesionale, në bashkëpunim dhe asistim edhe nga Arkiva e Shtetit. Për shkak të volumit të lartë të dokumentacionit, inventarizimi dhe arkivimi është ende në proces.

CFCU angazhohet të bëjë përpjekjet maksimale për të adresuar rekomandimin brenda periudhës së referuar dhe në vijimësi.

**V.** Në lidhje me kontratën e binjakëzimit "Mbështetje për Institucionin e Avokatit të Popullit dhe promovimi i të drejtave të njeriut në Shqipëri" Rikualifikimi i aktivitetit të ToT në "trajtime të gjithë stafit" është shpjeguar në raportin final. Shteti Anëtar ka argumentuar se, pas analizës së nevojave dhe konsultimeve me BC-të, seminari i propozuar për trajnim të trajnerëve ishte i pamjaftueshëm dhe u zgjerua për të përfshirë të gjithë stafin, për të arritur një kuptim të përbashkët të mandatit dhe për të përmirësuar efektivitetin e institucionit. Ky zgjerim është mbështetur me pyetëtorin dhe analizën përkatëse të nevojave për trajtime. Shteti Anëtar realizoi një trajnim dy ditor në prill 2024, të mbështetur nga listat e pjesëmarrësve. Ky nuk është një ndryshim objektivi, por një zgjerim i target grupit, i cili është në përputhje me natyrën dinamike të kontratës dhe miratimin e institucionit përfitues. Aktivitetet janë realizuar brenda objektivave të projektit.

Referuar kontratës së grantit "Fuqizimi i organizatave të mbrojtjes së konsumatorit në Shqipëri", aktivitetet që janë konsideruar të palidhura me projektin janë nëntema të moduleve specifike të trajnuara, të cilat janë të lidhura me integrimin evropian, siç evidentohet në axhendat dhe raportin final të kontratës.

Për kontratën e binjakëzimit "Mbështetje për Administratën Doganore Shqiptare", aktivitetet janë përshtatur për shkak të pandemisë dhe kufizimeve të Covid-19 në përputhje edhe me rekomandimet e Delegacionit të BE-së në Shqipëri për lehtësimin e masave në kontekst të Covid-19, duke ruajtur objektivat e kontratës, të cilat janë miratuar nga institucioni përfitues. Raportimi narrativ dhe financiar shoqërohet në çdo rast me dosje të aktiviteteve, dosje të prokurimeve dhe dosje financiare. Në praktikën e punës dhe në respektim të manualeve të brendshme të procedurave, është i pamundur miratimi i raporteve finale pa pasur dokumentacion suportues për secilin aktivitet të implementuar në kuadër të një kontrate. Nëse konstatohet mungesë e dokumentacionit justifikues për realizimin e aktiviteteve, shpenzimet e deklaruara për kryerjen e këtyre aktiviteteve konsiderohen të panjohura për financim nga IPA.

CFCU së bashku me institucionet përfituese kryen monitorimin e plotë të aktiviteteve të përcaktuara në kontratë dhe në planet Roll Up si pjesë e proceseve normale të punës. Ky proces është në vijim dhe në përmbushje edhe të rekomandimit do të vijojmë përpjekjet për evidentimin e qartë të ndikimit të ndryshimeve të objektivave apo planeve gjatë kohëzgjatjes së kontratës, duke siguruar që çdo ndryshim të dokumentohet dhe të pasqyrohet në mënyrë transparente. Po ashtu, do të merremi me plotësimin e dosjeve me të gjithë dokumentacionin justifikues të nevojshëm dhe të domosdoshëm, për të garantuar përputhshmërinë dhe transparencën e proceseve.



**VI.** Stafi pjesëmarrës në vizitat on the spot, në bazë të monitorimit të vazhdueshëm të kontratës, mbi bazën e gjykimit profesional është në gjendje të vlerësojë nëse ndonjë problematikë apo vonesë e hasur përgjatë implementimit të kontratës mundet të çënojë apo jo vazhdimësinë e saj. Në bazë të këtij gjykimi stafi pjesëmarrës sugjeron zgjidhjet e duhura procedurale apo operacionale që do të mundësonin tejkalimin e pengesave. Problematikat e evidentuara, të cilat janë të pashmangshme në rrjedhën disa vjeçare të implementimit të një kontrate jo domosdoshmërisht çënojnë ecurinë e saj dhe konstatimet në raportet e on siteve nuk duhet të interpretohen si mosrakordim. Autoriteti Kontraktor, me qëllim përmirësimin e cilësisë së monitorimit të kontratave, përgjatë 4 vjecarit të fundit ka zgjedhur të shkojë përtej pragjeve të përcaktuara në manualin e procedurave të CFCU në lidhje me vizitat vjetore on the spot dhe ka zgjedhur të përfshijë në planet vjetore kontrole për të gjitha kontratat nën implementim (me përjashtim të kontratave të binjakëzimit). CFCU angazhohet vijojë marrjen masave të nevojshme për kryerjen e kontrolleve “on the spot” në mënyrë të plotë dhe pranë ambienteve përkatëse në terren.

**VII.** Trajnimi për stafin e CFCU bëhet në bashkëpunim me ASPA duke u bazuar në nevojat për trajnim të stafit të rekrutuar rishtazi dhe stafit ekzistues si dhe asistencave të huaja teknike. Në kuadrin e rritjes së kapacitetit institucional, administrativ dhe teknik të institucioneve shqiptare për të planifikuar, programuar, përgatitur dhe menaxhuar asistencën IPA nën menaxhimin indirekt, CFCU aktualisht përfiton nga asistenca e huaj teknike nëpërmjet projektit të Bashkimit Evropian “Support to EU Financial Management Assistance in Albania” 2024-2027 nëpërmjet ofrimit të 25 trajnimeve të parashikuara për vitet 2025-2026. Procesi i trajnimit të strukturave të përfshira në menaxhimin e projekteve të financuara me fonde IPA nën menaxhimin indirekt koordinohet nga drejtoria mbështetëse e ZKA-së. CFCU angazhohet të sigurojë pjesëmarrjen e stafit në të gjitha trajnimet e mundshme kombëtare dhe ndërkombëtare lidhur me tematikat e procedurave të tenderimit dhe monitorimit të kontratës për fondet IPA, me qëllim rritjen dhe forcimin e kapaciteteve të stafit të angazhuar në këto procedura.

**VIII.** Autoriteti Kontraktues angazhohet të marrë masa për të dhënë orientimet e nevojshme për njësitë IPA për të bashkëlidhur versionin final të raportimit në aprovimet e tyre, me qëllim ruajtjen e një gjurme auditimi.

**IX.** CFCU është e detyruar të përdorë mekanizmin e ndërprerjes/pezullimit të pagesave sa herë që konstatohen kushtet e ndërprerjes të parashikuara në Nenin 15.5 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës. Gjithsesi në vijimësi do të shtohen përpjekjet për komunikim sistematik me përfituesit në mënyrë të tillë që të ulen rastet e mosplotësisë së dokumentacionit mbështetës e cila rrjedhimisht con në uljen e rasteve të ndërprerje/pezullime.

**X.** Sipas udhëzimeve të manualeve tona të punës, garancia për cilësinë e aktiviteteve dhe rezultateve përkatëse, në terma teknike, përcillet zyrtarisht nga institucioni përfitues. Vetëm pas kësaj, Autoriteti Kontraktues miraton Raportin Final, në përputhje me parashikimet kontraktuale dhe manualët përkatëse të procedurave.

Kontrollet e CFCU për ecurinë së aktiviteteve, bazohen në procedurat e miratuara dhe synojnë sigurimin e përputhshmërisë me kërkesat kontraktuale. Vlerësimi i riskut është i rëndësishëm në situatat kur paraqiten diferenca të konsiderueshme, por në kushte normale duhet marrë në konsideratë domosdoshmëria e një niveli të arsyeshëm fleksibiliteti për të siguruar implementimin e kontratatave.

CFCU në kuadër të përmirësimit të proceseve të punës, duke marrë në konsideratë edhe rekomandimin e dhënë, do të marrë masat e nevojshme për identifikimin e procedurës së

nevojshme për identifikim dhe vlerësimin e ndryshimeve të qenësishme në vlerën e kërkuar për pagesë duke siguruar dokumentimin, përshkrimin dhe arsyetimin e ndryshimit të vlerës.

**XI.** Procesi i zbatimit të kontratave është dinamik dhe çdo rast i paparashikuar vlerësohet individualisht nga Autoriteti Kontraktues. Parashikimet kontraktuale dhe manualet nuk ofrojnë një listë shteruese të rasteve të paparashikuara dhe në rastin e identifikuar, përdorimi i fondit të kontigjencës është vlerësuar si i domosdoshëm për të siguruar udhëtimet e ekspertëve dhe për të ruajtur vazhdimësinë e aktiviteteve të projektit. Gjithsesi në vijimësi, për kërkesat mbi përdorimin e fondeve të kontigjencës, Autoriteti do të marrë parasysh edhe rekomandimin tuaj në vlerësimin e rasteve ku kërkohet miratimi i përdorimit të fondit të kontigjencës.

**XII.** Qarkullimi i lartë i stafit krijon pashmangshmërisht pasoja sidomos për procese të lidhura me monitorimin individual të implementimit të kontratave. CFCU angazhohet të vijojë marrjen e marrjen masat e nevojshme për të siguruar një kalim të organizuar të përgjegjësive, duke minimizuar gjithashtu rreziqet e mundshme që lindin nga ndryshimi i shpeshhtë i menaxherit.

**XIII.** CFCU ka marrë dhe do të vijojë të marrë masa që transfertat bankare të kryhen në kohë, menjëherë pas marrjes së njoftimit nga Drejtoria e Fondit Kombëtar. Por në çdo rast duhet mbajtur në konsideratë se në rastin e marrjes së njoftimit në përfundim apo jashtë orarit zyrtar të administratës apo të Bankës operuese, kalkulimi i afatit prej 24 orësh nuk mund të bëhet nga data e indikuar në shkresë, por nga data pasardhëse e cila është në fakt dita më e parë e operative. Në terma absolute afati 24 orësh është respektuar pavarësisht se veprimet mbajnë data të ndryshme hyrje-daljeje dhe krijohet perceptimi se është shkelur afati 24 orësh.

**XIV.** CFCU në vijimësi angazhohet për marrjen e të gjitha masave të nevojshme për sigurimin e një procesi sa më real të planifikimit të pagesave të TVSH në përputhje me përcaktimet e marrëveshjeve të aplikueshme.

**XV.** Bazuar në Aneksin A7 të Kontratës të Twinning Grant, Pika 3, nënpika 3.1 citohet shprehimisht “*Shtetet Anëtare këshillohen të bëjnë pyetje të kujdesshme dhe të bashkëpunojnë me Delegacionin e BE-së (EUD) para se të angazhohen në ndonjë blerje të lidhur me projektin në vendin përfitues që mund të përfshijë pagesën e TVSH-së ose ndonjë takse tjetër, pasi disa shtete kanë një mekanizëm të vendosur me Ministrinë e Financave lokale për të trajtuar rimbursimin e TVSH-së dhe taksave të tjera për projektet e financuara nga BE*”. Mbështetur sa më sipër, si dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 6 datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, Neni 63, pika 2, kontraktorët duhet të përfitojnë rimbursimin e TVSH-së, kur zbatohen procedurat e rimbursimit. Referuar zbatimit të kontratave twining nën programin kombëtar IPA 2020, Autoritetit Kontraktor ju kërkua zyrtarisht nga përfaqësuesi i shtetit anëtar, rimbursimi i TVSH për fatura të lëshuara brenda territorit shqiptar. Rimbursimi i TVSH për këtë kontratë lidhet me rastet e paraqitura sipas pikës 4.4.2 të Seksionit G, Manualit të brendshëm.

**XVI.** Parashikimet kontraktuale sipas udhëzimeve të PRAG janë të përcaktuara në mënyrë të detajuar dhe kanë natyrën e tyre standarde të miratuar nga Komisioni Europian, të cilat nuk mund të ndryshohen. Në çdo rast, pagesat realizohen vetëm pas miratimit nga institucioni përfitues dhe kryerjes së plotë të kontrolleve të raporteve narrative dhe financiare, duke siguruar kështu përputhshmërinë e plotë me detyrimet dhe kushtet e kontratave.

Ndryshimi i formatit të kontratës dhe shtesa e një seksioni specifik ku parashikohen penalitete për mosrealizimin e detyrave për palët e nënkontraktuara nuk mund të parashikohen në kontratat aktuale sepse Autoriteti Kontraktor është i detyruar të përdorë formatin (template) e kontratave në përputhje me formatet e PRAG. Për më tepër, nuk ka asnjë referencë ligjore mbi të cilën të

mbështesim aplikimin e penalteteve kundrejt palëve të nënkontraktuara jo drejtpërdrejtë nga Autoriteti Kontraktor.

Në rastin në diskutim, Prishja e kontratës është bërë me rënien dakord të të dyja palëve dhe për këtë arsye nuk është mbajtur penaltet, pasi eksperti ka lajmëruar paraprakisht për arsyet. Pra palët kanë rënë dakord ndërmjet tyre për zgjidhjen me dakordësi dhe vijueshmërinë e kryerjes së detyrimeve, rrjedhimisht Autoriteti Kontraktor nuk mund të aplikojë penaltet në rast të prishjes së njëanshme nga pala e nënkontraktuar e cila nuk ka asnjë marrëdhënie juridike të lindur me Autoritetin Kontraktor. Kontrata ka përfunduar më 28.03.2023 dhe CFCU e ka të pamundur të sigurojë angazhimin e MEPJ për të rivlerësuar arritjen e objektivave të kontratës në bazë të vlerësimit të proporcionalitetit dhe relevancës së mosrealizimit të plotë të një aktiviteti të një kontrate shërbimi brenda kontratës së grantit.

**XVII.** Në përputhje me parashikimet e Nenit 9 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës, përfituesi i grantit ka detyrimin e njoftimit për rialokimet buxhetore të ndodhura gjatë implementimit të projektit menjëherë ose maksimalisht në raportimin e rradhës, i cili për rastin në fjalë ka qenë raporti final. Referuar raportit financiar final, për linjën buxhetore 5.7.5.2 e cila lidhet me aktivitetin 3.2.2 ka rezultuar me kursim në vlerën 1,000 Euro kjo për shkak se aktiviteti nuk është kryer nga personi i kontraktuar por grupi punës së projektit, bazuar kjo në deklaratën e përfituesit dhe dokumentet suportues të cilat sigurojnë produktin/aktivitetin e kryer. Në raportin final përfituesi ka deklaruar se shuma e kursyer prej 935.92 euro është rialokuar në zërat buxhetor të burimeve njerëzore, përkatësisht në katër zëra buxhetor. Në përfundim të kontrolleve të kryera pavarësisht rialokimeve, CFCU bazuar në dokumentacionin suportues ka aplikuar zbritje në kostot e deklaruara. Për sa më sipër, duke qenë se aktiviteti është realizuar dhe gjithashtu shuma e kursyer është rialokuar në përputhje me parashikimet e Nenit 9 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës, dhe justifikuar me dokumentacion të plotë, efektiviteti i përdorimit të fondeve është vlerësuar gjatë kontrollit të raportit narrativ dhe financiar para kryerjes së pagesës finale. Në çdo rast, pagesat realizohen vetëm pas miratimit nga institucioni përfitues dhe kryerjes së plotë të kontrolleve të raporteve narrative dhe financiare, duke siguruar kështu përputhshmërinë e plotë me detyrimet dhe kushtet e kontratave. Kontrata ka përfunduar në vitin 2023 dhe CFCU e ka të pamundur të sigurojë angazhimin e MEPJ për të rivlerësuar arritjen e objektivave të kontratës grant, në bazë të vlerësimit të proporcionalitetit dhe relevancës së mosrealizimit në mënyrë të plotë të një aktiviteti brenda një kontrate shërbimi në raport me kontratën e grantit në tërësi. Në këto kushte, Autoriteti kontraktor nuk ka bazë ligjore për të inicuar procedurë rikuperimi të fondeve të Komisionit Evropian për t'ja kthyer më pas këtij të fundit.

**XVIII.** Sipas udhëzimeve të manualeve tona të punës, garancia për cilësinë e aktiviteteve dhe rezultateve përkatëse, në terma teknike, përcillet zyrtarisht nga institucioni përfitues. Vetëm pas kësaj, Autoriteti Kontraktues miraton Raportin Final, në përputhje me parashikimet kontraktuale dhe manualët përkatëse të procedurave. Në çdo rast, pagesat realizohen vetëm pas miratimit nga institucioni përfitues dhe kryerjes së plotë të kontrolleve të raporteve narrative dhe financiare, duke siguruar kështu përputhshmërinë e plotë me detyrimet dhe kushtet e kontratave. Konkretisht, referuar kontratës AI/IPA2017/06 (CSO si avokat për implementimin e legjislacionit mjedisor horizontal në nivel lokal-Vlorë, me institucion përfitues ICLA, përfituesi në përputhje me parashikimet e Nenit 9 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës, ka pasur detyrimin e njoftimit për rialokimet buxhetore të ndodhura gjatë implementimit të projektit menjëherë ose maksimalisht në raportimin e rradhës, i cili për rastin në fjalë ka qenë raporti final. Për ekspertin E.H, Autoriteti Kontraktues ka siguruar aktivitetin e bërë nga eksperti në fazën e miratimit të raportit narrativ me institucionin përfitues, si dhe gjithashtu ka siguruar që ekspertit ti njihet vetëm vlera e 7 ditë pune

në vlerën 1,400 Eur ndryshe nga ajo e kontraktuar në vlerën 2,400 Euro. Dokumentacioni suportues si kontrata e punës ndërmjet ICLA dhe E.H si dhe deklaratat e paraqitura në letrat e punës për 7 ditë pune të kryera, shoqëruar me raportin narrativ të miratuar nga përfituesi mbi aktivitetet, kanë qenë baza për njohjen e shpenzimit për ekspertin E.H. Referuar kontratës AL/IPA2017/8 me përfitues COSPE, amendimi i kontratës miratuar nga CFCU dhe Delegacioni i BE-së në Shqipëri i hyrë në fuqi në datën 21.02.2022 ka ligjëruar rialokimin e fondeve nga linja buxhetore 6 “Other” në linjën buxhetore 1 “Human Resources” duke shtuar dy linja të reja buxhetore në vlerë totale 4,142.16 Euro.

Pas miratimit nga institucioni përfitues dhe kryerjes së plotë të kontrolleve të raporteve narrative Autoriteti Kontraktor mbështetur në raportin narrativ të miratuar të aktiviteteve si dhe dokumentacionin justifikues financiar të dorëzuar nga përfituesi i grantit ka validuar:

- për zërin buxhetor 1.1.1.2 - shuma e validuar 1,810.26 EUR
- për zërin buxhetor 1.1.1.4 - shuma e validuar 2,331.90 EUR
- për zërin buxhetor 2.2.1 - shuma e validuar 4483.06 EUR

Në total vlera e validuar rezulton në shumën 8,625.22 Euro për të cilën Autoriteti Kontraktor ka siguruar përputhshmërinë e plotë me detyrimet dhe kushtet e kontratave si dhe ligjshmërinë e shpenzimeve.

**XIX.** Sipas udhëzimeve të manualeve tona të punës, garancia për cilësinë e aktiviteteve dhe rezultateve përkatëse, në terma teknikë, përcillet zyrtarisht nga institucioni përfitues. Vetëm pas kësaj, Autoriteti Kontraktues miraton Raportin Final, në përputhje me parashikimet kontraktuale dhe manualët përkatëse të procedurave. Kontrollat e CFCU për ecurinë e aktiviteteve, bazohen në procedurat e miratuara dhe synojnë sigurimin e përputhshmërisë me kërkesat kontraktuale duke marrë në konsideratë domosdoshmërinë e një niveli të arsyeshëm fleksibiliteti për të siguruar implementimin e kontratave. Autoriteti Kontraktor për vlerën e validuar në shumën 8,625.22 Euro ka siguruar përputhshmërinë e plotë me detyrimet dhe kushtet e kontratave si dhe ligjshmërinë e shpenzimeve. Kontrata ka përfunduar në vitin 2023 dhe CFCU e ka të pamundur të sigurojë angazhimin e MEPJ për të rivlerësuar arritjen e objektivave të kontratës grant, në bazë të vlerësimit të proporcionalitetit dhe relevancës së mosrealizimit në mënyrë të plotë të një aktiviteti brenda një kontrate shërbimi në raport me kontratën e grantit në tërësi. Në këto kushte, Autoriteti kontraktor nuk ka bazë ligjore për të inicuar procedurë rekuperimi të fondeve të Komisionit Evropian për t’ja kthyer më pas këtij të fundit.

**Qëndrimi i grupit të auditimit: 1.** *Sa i takon diferencave kohore të konstatuara për qarkullimin e fishave të kontratave të binjakëzimit, grupi i auditimit sqaron se mangësia konsiston në mungesën e argumentimit të këtyre zgjatjeve në kohë për qarkullimin e fishave, pasi edhe në Manualin e Binjakëzimit citohet se “Autoriteti Kontraktor mund të konsiderojë vendosjen e një deadline më të gjatë në raste të justifikuar”. Megjithatë, në rastet e evidentuara nuk është konstatuar argumentim i vendosjes së këtyre afateve. Ndaj, sa më sipër, gjetja e grupit të auditimit qëndron dhe observacioni nuk merret në konsideratë.*

**2.** *Lidhur me gjetjen e grupit të auditimit mbi parregullsitë në mbajtjen e dosjeve dhe arkivimin e tyre, observacioni i përcjellë nga subjekti nuk e kundërshton gjetjen e grupit të auditimit, por argumenton angazhimin për përpjekjet e ardhshme për adresimin e rekomandimit.*

**3.** *Lidhur me gjetjen e grupit të auditimit mbi kontratën e binjakëzimit “Mbështetje për Administratën Doganore Shqiptare”, gjetja e grupit të auditimit konsiston në faktin se angazhimi i ndryshëm nga kushtet e kontratës nuk është përkthyer në ndryshim të objektivave apo*

komponentëve të aktiviteteve, pavarësisht se ka aktivitete që nuk janë mbuluar me ditë angazhimi sipas progres raporteve, përpos 6 Side Letters, si dhe këto ndryshime nuk janë evidentuar nga CFCU përgjatë monitorimit. Në këtë kuadër, referuar edhe argumenteve të paraqitur në observacion nga CFCU, grupi i auditimit i qëndron gjetjes së auditimit, dhe observacioni nuk merret në konsideratë, pasi nuk paraqet dokumentacion apo argumente shtesë nga ato tashmë të paraqitura.

4. Sa i takon vizitave on the spot, grupi i auditimit sqaron se referuar dokumentacionit të shqyrtuar përgjatë auditimit, si dhe argumenteve të subjektit, parregullsitë e evidentuara për kontrollin “on the spot”, qëndrojnë veçanërisht në ezaurimin e kontrollit në konceptin e plotë të tij, me qëllim monitorimin e plotë të kontratave, ecurisë së tyre dhe evidentimit në kohë të parregullsive apo mangësive përgjatë implementimit/pagesave si dhe plotësimin të checklistave në linjë me kontrollin e kryer dhe monitorimin. Për më tepër, observacioni nuk sjell argumente apo informacione të reja, përpos parashtrimit të masave të marra nga CFCU lidhur me kryerjen e kontrolleve në mënyrë të plotë në terren, ndaj gjetja e grupit të auditimit qëndron dhe observacioni nuk merret në konsideratë.

5. Referuar gjetjes së grupit të auditimit lidhur me trajnimet për rritjen dhe forcimin e kapaciteteve të stafit të punësuar pranë CFCU, për punonjësit e Drejtorisë së Menaxhimit të Prokurimeve dhe Kontraktiveve për fondet e BE-së, observacioni i përcjellë nga subjekti nuk e kundërshton gjetjen e grupit të auditimit, por argumenton angazhimin për përpjekjet e ardhshme për adresimin e rekomandimit.

6. Referuar gjetjes së grupit të auditimit lidhur me miratimin nga njësia IPA (MEPJ) i raportit përfundimtar narrativ, observacioni i përcjellë nga subjekti nuk e kundërshton gjetjen e grupit të auditimit, por argumenton angazhimin për përpjekjet e ardhshme për adresimin e rekomandimit.

7. Referuar gjetjes së grupit të auditimit lidhur me ndryshimet e menaxherit të projektit përgjatë implementimit të kontratave, observacioni i përcjellë nga subjekti nuk e kundërshton gjetjen e grupit të auditimit, por argumenton arsyet e ndodhjes dhe angazhimin për përpjekjet e ardhshme për adresimin e rekomandimit.

8. Referuar përgjigjes së dhënë përmes observacioneve të fazës së Projekt Raportit të Auditimit në lidhje me rekomandimet nr.3.2, 11.1, 15.1, 16.1, 16.2, 17.1, 17.2, 17.3, 18.1, 19.1, 20.1, 21.1, 22.1, në kushtet e mungesës së dokumentacionit të ri justifikues i cili do të ndryshonte qëndrimin e grupit të auditimit, vijon të mbahet i njëjti qëndrim. Sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.

9. Referuar argumentimit të dhënë nga ana juaj, përmes observacioneve të sjella, sa i takon vijueshmërisë në të ardhmen, në kushtet kur parashikimet kontraktuale sipas udhëzimeve të PRAG janë të përcaktuara dhe miratuara nga Komisioni European, e në kuadër të të mirës së përbashkët, observacioni pranohet pjesërisht. Vetëm për pjesën e kontratës së mbyllur, ndërsa për të ardhmen të vijohet me kontrole të imtësishme dhe të detajuara në ndërveprim institucional mes jush dhe MEPJ-së.

10. Lidhur me kontratën AL/IPA2017/8 me përfitues COSPE, grupi i auditimit sqaron se që në fazën e Projekt Raportit të Auditimit është evidentuar amendimi i kontratës dhe vlerën totale të validuar nga CFCU. Megjithatë, në linjën e gjetjes së auditimit, sqarojmë se në buxhetin fillestar ishte kryer parashikim në dy linja buxhetore kontraktimi i ekspertëve lokalë për 2 (dy) aktivitete të ndryshme ndërkohë, në buxhetin e amenduar janë buxhetuar dy nënlinja të njëjta për aktivitete të ndryshme. Referuar aktiviteteve të përmendura në material, nga grupi i auditimit është evidentuar se dokumentacioni nuk ka qenë i plotë, siç është sqaruar përgjatë Raportit të Auditimit. Sa i takon përfundimit të kontratës në vitin 2023, grupi i auditimit thekson se përsa kohë gjetja qëndron, nevojiten të merren masa për përmbushjen e rekomandimit. Për më tepër, observacioni

*nuk sjell informacione apo argumente të reja dhe gjetja e auditimit nuk ndryshon, ndaj observacioni nuk merret në konsideratë.*

#### **IV. REKOMANDIME**

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

##### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se në projektin "Peripatetic advisor to provide on-job regulatory and supervisory support and guidance to AFSA", me përfitues AMF, në kontratën me konsulentin e dytë "A. K. A", në objektivat e parashikuara është reduktuar objektivi "Inception report I", i cili është i përfituar në kontratën e ndërprerë. Gjithashtu është reduktuar edhe "Task 2 - Gap analysis from project deliverables and recommendation of best solutions or changes, as well as other professional assistance as per requirement", detyrë kjo e cila është parashikuar në kontratën fillestare por që nuk është realizuar, veprim i cili nuk është argumentuar nga përfituesi. Nga ana e strukturave përgjegjëse të CFCU nuk rezulton të jetë identifikuar, raportuar apo të jenë marrë masat lidhur me këto mangësi të konstatuara gjatë kësaj kontrate dhe në tërësi për objektivat e projektit.

*(Më hollësisht trajtuar në Drejtimin 1, faqe 20-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1 Rekomandimi:** Strukturat përgjegjëse të CFCU të marrin masat për të garantuar që përfituesi të dokumentojë dhe të argumentojë qartë çdo ndryshim ose reduktim të detyrave ose objektivave midis kontratës fillestare dhe kontratave pasuese, për të garantuar që objektivat fillestare të kontratës të realizohen në mënyrë efektive dhe të shmangen mungesat ose mospërputhjet në dokumentacion.

Nga ana e CFCU të ndërmerren veprime për të rivlerësuar objektivat e pa përmbushura të kontratës fillestare (p.sh. Inception report dhe Task 2 - Gap analysis) dhe të sigurohet integrimi i tyre në kontratat ekzistuese ose në një plan pune të rishikuar.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se në projektin "Peripatetic advisor to provide on-job regulatory and supervisory support and guidance to AFSA", me përfitues AMF, me shkresën nr.799, datë 10.08.2022, CFCU i është drejtuar konsulentit A. K. A. duke i komunikuar zgjidhjen e kontratës ku i referohet kërkesës së bërë nga konsulenti për ndërprerje kontrate. Nga verifikimi i praktikës e cila gjendet në dosje konstatohet se kjo vendimarrje nuk është e dokumentuar, në kundërshtim me manualin e auditit të brendshëm, i cili parashikon dokumentimin e të gjitha veprimtarive, proceseve dhe transaksioneve për të siguruar gjurmën e auditimit për vijueshmërinë dhe monitorimin. Gjithashtu nuk është kryer inventarizimi i dosjes së këtij projekti sipas ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "*Për Arkivat*" neni 30, "Inventari i brendshëm i dosjes".

*(Më hollësisht trajtuar në Drejtimin 1, faqe 20-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1 Rekomandimi:** Nga ana e CFCU të bëhet dokumentimi i plotë dhe transparent i komunikimeve, duke siguruar që çdo vendim i marrë për zgjidhjen e një kontrate të bazohet në një dokumentim të plotë dhe të qartë të komunikimeve zyrtare me konsulentët. Çdo kërkesë ose komunikim që lidhet me ndërprerjen e një kontrate duhet të dokumentohet si pjesë e dosjes me qëllim krijimin e gjurmës së auditimit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të detyrimeve të konsulentit, parashikuar në seksionin 4 “*Reporting, Schedule of Deliverables and Timing*” të kontratës e cila është firmosur në datën 24.05.2021 midis konsulentit dhe AMF, rezulton se konsulenti nuk ka zbatuar detyrimet për raportim sipas afateve të parashikuara për realizimin e detyrave, për të cilat nga ana e CFCU nuk rezultojnë të jenë identifikuar dhe marrë masat për këto problematika.

*(Më hollësisht trajtuar në Drejtimin 1, faqe 20-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1 Rekomandimi:** CFCU të sigurojë ndjekjen rigorozë të afateve të përcaktuara në kontratë për raportimin e detyrave nga konsulente dhe çdo vonesë të identifikohet menjëherë duke marrë masat e përshtatshme. Në kontratat e ardhshme të parashikohen penalitete financiare për rastet kur konsulenti dështon të përmbushë detyrimet brenda afateve të përcaktuara, masa këto që do të inkurajojë respektimin e afateve dhe do të shmangë vonesat.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të ndjekura nga CFCU për prokurimin dhe zbatimin e projekteve, u konstatua se materialet dhe detyrat të cilat konsulentët duhet të përgatisin dhe të implementojnë kërkohen të jenë vetëm në gjuhën angleze, në kundërshtim me VKLA Nr.4, datë 19.6.2017 "Për miratimin e rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të RSH", neni 4, pika 9, ku citohet se "*Në rastin e komunikimit me institucione apo individë të huaj, dokumentet mund të përpilohen edhe në gjuhë të huaj. Në këtë rast nuk është nënshkruar kopja e dokumentit edhe në shqip si variant origjinal, fraksion i së cilës protokollohet kopja në gjuhë të huaj*".

*(Më hollësisht trajtuar në Drejtimin 1, faqe 20-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1 Rekomandimi:** CFCU të sigurohet që të gjitha dokumentet zyrtare, përfshirë materialet dhe detyrat e përgatitura nga konsulentët, të jenë të disponueshme edhe në gjuhën shqipe. Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të përkthehen dhe të nënshkruhen në gjuhën shqipe si variant origjinal, dhe në kontratat me konsulentët të specifikohet qartë detyrimi për të dorëzuar materialet dhe raportet në dy gjuhë: shqip dhe anglisht.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se për projektin “**Zhvillimit të kontabilitetit në Sektorin Publik**”, ku përfitues është Ministria e Financave në kontratën e lidhur me konsulentin E. B, me objekt: “*The Translation of the International Accounting Standards for Public Sector*”, pagesa është realizuar jashtë afateve të përcaktuara në seksionin D të kontratës ku parashikohet se pagesa do të bëhet brenda 30 ditëve nga data e dorëzimit të materialit nga konsulenti, duke shtuar riskun për aplikimin e penaliteteve nga ana e përfituesve për pagesa të vonuara.

*(Më hollësisht trajtuar në Drejtimin 1, faqe 20-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.1 Rekomandimi:** CFCU të sigurojë zbatimin e rreptë të afateve të pagesave të përcaktuara në kontratë, ku pagesat të kryhen brenda 30 ditëve nga data e dorëzimit të materialit, siç përcaktohet në seksionin D të kontratës.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se për fazën e dytë të implementimit të projektit “**Zhvillimit të kontabilitetit në Sektorin Publik**”, me përfitues Ministria e Financave, nuk është plotësuar kushti 2.3 i kontratës për detyrën: "*Deliver the training on IPSAS deep dive and training of trainers (120 hours for 25 person)*". Në dosjes e paraqitur si dhe në materialet të cilat gjenden në CD nuk gjendet listëprezenca e pjesëmarrësve më nënshkrimin përkatës, konkretisht:

- Për fazën e tretë të implementimit të projektit u konstatua se nuk është plotësuar kushti 3.3 i kontratës për detyrën "Train 100 public accountants from central government (4 groups with 25 persons, 80 hours each group)".

- Për fazën e pestë të implementimit të projektit u konstatua se nuk është plotësuar kushti 5.2 i kontratës për detyrën "5 day training with focus in financial reporting and IPSAS with a train of trainer approach for 10 persons" dhe kushti 5.3 i kontratës për detyrën "10 day training with focus in financial reporting and IPSAS with a train of trainer approach for the assigned staff of Accounting Department in the UT and UBT".

(Më hollësisht trajtuar në Drejtimin 1, faqe 20-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6.1 Rekomandimi:** CFCU të sigurojë që të gjitha detyrat dhe fazat e implementimit të projektit të përmbushen në përputhje me kushtet e kontratës, duke përfshirë dorëzimin e trajnimeve të specifikuar dhe dokumentimin e pjesëmarrësve. Çdo fazë e projektit duhet të verifikohet përpara se të kalojë në fazën tjetër dhe për çdo trajnim të zhvilluar të ruhet një dokumentacion i plotë që përfshin listën e pjesëmarrësve me nënshkrimin përkatës, si dhe çdo material tjetër të rëndësishëm që provon realizimin e detyrave të kontratës.

**6.2 Rekomandimi:** CFCU të marrë masat, që për fazat ku kushtet e kontratës nuk janë përmbushur, t'i realizojë ato sërish, më qëllim përmbushjen e kërkesave kontraktuale, duke përfshirë dorëzimin e listës së pjesëmarrësve dhe nënshkrimin përkatës.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi është konstatuar se pavarësisht se projekti i "Zhvillimit të kontabilitetit në Sektorin Publik", ku përfitues është Ministria e Financave, i cili ka filluar procedurën e prokurimit në 17.05.2018, është parashikuar të përfundojë në 30.06.2020, por është shtyrë me amendamentin nr.615, datë 20.10.2021 dhe ka përfunduar në dhjetor 2022, për të cilin janë lidhur gjithsej 5 kontrata ku implementimi i tyre ka përfunduar brenda vitit 2022, përgjatë fazës së auditimit në terren (dhjetor 2024), **rezulton se ende nuk ka një produkt final për implementim dhe zbatimin në praktik të Standarteve të Kontabilitetit në Sektorin Publik.** Nga ana e strukturave përgjegjëse të CFCU nuk rezultojnë të jenë identifikuar parregullsitë për mungesën e realizimit të produkteve të pritura, apo të jenë adresuar dhe eliminuar pengesat që kanë ndikuar në dështimin e implementimit të Standarteve të Kontabilitetit në Sektorin Publik. (Më hollësisht trajtuar në Drejtimin 1, faqe 20-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**7.1 Rekomandimi:** Përfituesi, Ministria e Financave, të ndërmarrë masa të menjëhershme për të finalizuar dhe dorëzuar produktin final të projektit, duke siguruar që Standartet e Kontabilitetit në Sektorin Publik të zbatohen plotësisht dhe të implementohen në praktikë.

*Menjëherë*

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i strukturës organizative të CFCU për drejtoritë e lidhura me menaxhimin e IPA-s, rezultoi se Sektori "Për monitorimin e kontratave" përbëhet nga Përgjegjësi i Sektorit dhe 1 specialist dhe 4 vende të tjera janë vakante. Në Sektorin për Përgatitjen e Dokumenteve të Prokurimit për fondet e BE-së që prej miratimit të strukturës së re, për një periudhë kohore më të gjatë se 6 muaj dhe 4 specialistë, pozicioni i Përgjegjësit të Sektorit është vend vakant. Vakanca të tjera rezultojnë dhe: Në Sektorin për Vlerësimin dhe Kontraktimin e IPA me 1 specialist; Në Drejtorinë për Sigurimin e Cilësisë dhe Kontrollin e Brendshme, me 1 specialist në Sektorin për Kontrollin e Brendshëm dhe çështjet ligjore dhe 2 specialistë në Sektorin për Kontrollin e Cilësisë; Në Drejtorinë për Menaxhimin Financiar IPA, me 1 specialist. Rrjedhimisht, për vitin 2024 rezulton se Drejtoria e Menaxhimit të Prokurimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së operon me 14 punonjës më pak. Numri relativisht i lartë i vakancave (konkretisht 30% e



stafit total të drejtorive IPA) çënon ngarkesën e drejtë për secilin nëpunës, sigurimin e mbarëvajtjes së punës në këtë drejtori si dhe arritjen e objektivave të saj.

Drejtoria për Zbatimin e Projekteve të Bankës Botërore dhe të Donatorëve të tjerë është e ndarë në dy sektorë: Sektori i Menaxhimit të Prokurimeve, në përbërje të të cilit janë katër specialist dhe një përgjegjës sektori dhe Sektori i Menaxhimit Financiar dhe Kontabilitetin, në përbërje të të cilit janë dy specialist dhe një përgjegjës sektori nga ku rezulton se një vend specialisti është vakant. Vakanca e pozicionit të përgjegjës të specialistit nuk garanton ngarkesën e drejtë për secilin nëpunës, sigurimin e mbarëvajtjes së punës në këtë drejtori si dhe arritjen e objektivave të saj.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Urdhrin nr. 59, datë 18.04.2024, ku përcaktohet se numri total i punonjësve të CFCU do të ishte 48 veta.

*(Më hollësisht trajtuar në Drejtimin 1, faqe 20-34 dhe Drejtimin 2, faqe 36-91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**8.1. Rekomandimi:** CFCU, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, të marrë masa për plotësimin e vendeve vakante në strukturën organizative.

### **Menjëherë**

**9.1 Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se përgjegjësitë e punës për administrimin e burimeve njerëzore i mbulon një specialiste pranë Drejtorisë për Sigurimin e Cilësisë dhe Kontrollin e Brendshëm në Sektorin për Kontrollin e Brendshëm dhe Çështjet Ligjore, detyrim i cili buron nga përshkrimet e punës, konkretisht formulari i përshkrimit të punës, Sektori për Kontrollin e Brendshëm dhe Çështjet Ligjore pika V, c.7, c.8, c.9, d, d.1. Përgjegjësitë e pozicionit të punonjësit të protokollit në këtë drejtori mbulohet nga një punonjës me kontratë pune, sipas VKM-së nr. 39, datë 24.01.2024 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2024, në njësitë e qeverisjes qendrore”. Sipas kësaj VKM për CFCU janë parashikuar 3 Specialistë me kohë mesatare/ditore 6 orë në ditë.

Në Urdhrin nr. 213, datë 30.07.2018 të Ministrit të Financave “Për funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, Drejtorisë së përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktiveve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorë të tjerë si dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të taksës së Pasurisë”, thuhet se “Të gjithë shërbimet mbështetëse dhe transaksionet financiare të tyre do të mbulohen nga aparati i MFE, deri në krijimin e njësisë së shërbimeve mbështetëse në strukturat organike të këtyre drejtorive”. Deri në përfundim të periudhës së auditimit, 6 vite pas urdhrin të sipërcituar, nuk rezulton të jetë krijuar kjo strukturë pranë CFCU. Shërbimet mbështetëse dhe transaksionet financiare kryhen ende nga MF, në kundërshtim me VKM nr. 893 datë 17.12.2014 “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishtme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm” e ndryshuar me VKM 520 datë 07.09.2023, pika 27, “Në çdo institucion i cili ka të paktën 15 pozicione pune duhet të ketë të paktën një pozicion të dedikuar për funksionet e lidhura me financat e institucionit”.

**9.2 Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezulton se ndryshimet e sipërcituara nuk janë reflektuar në Rregulloren e Brendshme të Institucionit miratuar me Urdhër nr.146 datë 11.06.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktiveve për fondet e BE, BB dhe donatorëve të tjerë”. Gjithashtu përshkrimet e punës janë sipas rregullores së mëparshme dhe nuk gjejnë reflektim pozicionet e reja të krijuara sipas strukturës së re, veprime në kundërshtim me Ligjin nr.10296 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 9 pika 4 a dhe f.

*(Më hollësisht trajtuar në Drejtimin 2, faqe 34-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**9.1. Rekomandimi:** CFCU të marrë masa për të plotësuar pozicionin e dedikuar për funksionet e lidhura me financat e institucionit.

**9.2. Rekomandimi:** CFCU të marrë masa për përditësimin e Rregullores së Brendshme të Institucionit, me qëllim përfshirjen e ndryshimeve të vendosura me urdhrat e brendshëm të institucionit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dosjeve të projekteve nën fondet IPA, rezultojnë mangësitë si në vijim:

- Nga auditimi konstatohet se fisha e binjakëzimit për projektin “Mbështetje për Institucionin e Avokatit të Popullit dhe promovimi i të drejtave të njeriut në Shqipëri” është publikuar në Europe Aid Website në datën 26.10.2021, dhe në 28.10.2021 CFCU ka dërguar e-mailin për qarkullimin e fishës, ku afati përfundimtar i dërgimit të propozimeve është 7 Janar 2022, në kundërshtim me pikën 2.2 të Manualit të Binjakëzimit ku thuhet se: *Në princip, shtetet anëtare kanë 8 javë kohë për të përgatitur propozimet e tyre me një deadline konkret të specifikuar në momentin e qarkullimit të fishës. Autoriteti Kontraktor mund të konsiderojë vendosjen e një deadline më të gjatë në raste të justifikuara.* E njëjta situatë, me një diferencë kohore rreth 9 javë për qarkullimin e fishës, në mungesë të argumenteve të justifikuara, konstatohet edhe në rastin e fishës së binjakëzimit “Mbështetje për Administratën Doganore Shqiptare në lidhje me zbatimin e kodeve doganore europiane dhe rritjen e kapaciteteve operationale në fushën e mallrave të falsifikuara”, me përfitues AEI, nga dërgimi i fishës përmes email (datë 29.05.2020) deri në afatin e dorëzimit të propozimeve (datë 29.07.2020).

- Nga auditimi konstatohet se mbledhja e Komisionit të Përzgjedhjes për projektin “Mbështetje për Institucionin e Avokatit të Popullit dhe promovimi i të drejtave të njeriut në Shqipëri” me institucion përfitues Avokatin e Popullit, është realizuar në datat 2 dhe 3 Shkurt 2022, gati 4 javë pas afatit të fundit për propozimet (që ishte në 7 Janar 2022), në kundërshtim me Manualin e Binjakëzimit, pika 2.4.2.2 ku përcaktohet se: *Mbledhja e komitetit të përzgjedhjes lejon Përfituesin të vlerësojë plotësisht cilësinë e propozime të ofruara në mënyrë që të mund të zgjedhë partnerin më të përshtatshëm. Duke ndjekur ftesat formale të Autoritetit Kontraktor, mbledhja drejtohet nga këta të fundit. Nuk duhet të zërë vend më vonë se 2 javë pas afatit të fundit për propozimet.*

- Nga auditimi konstatohen mungesa në dosjet e procedurave të dokumentacioneve të stafit të përzgjedhur si pjesëmarrës, qoftë në grupet për përgatitjen e dokumentacionit, ashtu si dhe në Komisionin Përzgjedhës sa i takon jetëshkrimeve (CV) që duhet të dorëzohen.

*(Më hollësisht trajtuar në Drejtimin 2, faqe 34-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**10.1. Rekomandimi:** CFCU të marrë masa për përmirësimin e procedurave të ndjekura që nga hartimi i fishës së binjakëzimit deri në nënshkrimin e kontratës së binjakëzimit, me qëllim shmangien e vonesave në afate apo devijimin nga përcaktimet e Manualit të Binjakëzimit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dosjeve fizike të projekteve të përzgjedhura nën programet IPA dhe atyre të BB dhe donatorëve të tjerë u konstatua se në tërësi këto dosje mbartnin parregullsi në mënyrën e mbajtjes së tyre, si dhe mungonte fleta e inventarit për çdo dosje respektive, e për pasojë nuk është bërë numërimi i fletëve dhe inventarizimi/numërimi total i tyre sipas ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” neni 30, “Inventari i brendshëm i dosjes” që për shkak të sensitivitetit të informacionit, gjykohet si risk i shtuar dhe duhet vlerësuar nga CFCU. *(Më hollësisht trajtuar në Drejtimin 2, faqe 34-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**11.1. Rekomandimi:** CFCU të marrë masa për inventarizimin dhe numërimin e plotë të dokumentacionit të dosjeve, si dhe arkivimin e tyre në përputhje me normat tekniko-profesionale, me qëllim ruajtjen e informacionit dhe gjurmës së auditimit.

*Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2025*

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se:

- Në 1 (një) nga projektet e përzgjedhura për tu audituar, konkretisht në kontratën e binjakëzimit “Mbështetje për Institucionin e Avokatit të Popullit dhe promovimi i të drejtave të njeriut në Shqipëri” me përfitues institucionin e Avokatit të Popullit, rezultoi se në raportin narrativ final komponenti “numri i nëpunësit civil të trajnuar si trajnerë” nuk është realizuar. Objektivi i porealizuar, nuk është shoqëruar me zbritjen e ditëve të punës respektive të dedikuara për të dhe rrjedhimisht nuk është pasqyruar në raport.

-Në kontratën e tipit grant “Fuqizimi i organizatave të mbrojtjes së konsumatorit në Shqipëri” me institucion përfitues EMA, vihen re mungesa të theksuara të cilat janë dhe në formën e përfshirjeve të shkresave që vërtetojnë kryerjen e aktiviteteve të cilat nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë, me projektin si psh: Course II “Potential and challenge of integration in a troubled Europe”: Eu enlargement and regional cooperation in Western Balkan; Course III “Albania and the trends of European Integration” : Covid 19-s impact on the Welfare state and EU enlargement and regional cooperation in WB.

- Në 1 (një) nga projektet e përzgjedhura për tu audituar, konkretisht në kontratën e binjakëzimit “Mbështetje për Administratën Doganore Shqiptare në lidhje me zbatimin e kodeve doganore europiane dhe rritjen e kapaciteteve operacionale në fushën e mallrave të falsifikuara” me përfitues AEI, u konstatua se duke krahasuar kontratën me raportet e ndërmjetme dhe raportet finale, ndërthurur me Planet Roll Up 1 dhe 2, janë evidentuar aktivitete të cilat nuk janë të paraqitura në raportin final apo të mbuluara me ditë-ekspert. Gjithashtu, nga krahasimi i ditë ekspert sipas kontratës dhe ditë-ekspert sipas raporteve, vihet re angazhim me më shumë ditë për aktivitete të caktuara dhe angazhim më i ulët në të tjera, sipas parashikimit në kontratë, referuar edhe Planeve Roll Up 1 dhe 2. Për më tepër, u konstatua se angazhimi i ndryshëm nga kushtet e kontratës nuk është përkthyer në ndryshim të objektivave apo komponentëve të aktiviteteve, pavarësisht se ka aktivitete që nuk janë mbuluar me ditë angazhimi sipas progres raporteve, përpos 6 Side Letters përmes së cilave është rialokuar buxhetin ndërmjet zërave, si aktiviteti 1.1.1 dhe aktiviteti 2.4. Për këtë kontratë ka patur 6 side letters për rialokime buxhetore brenda zërave të buxhetit në vlerë totale 33,599.33 EUR ose 8.93% të vlerës totale të kontratës. Këto ndryshime nuk janë evidentuar nga CFCU përgjatë monitorimit të implementimit të kontratës së binjakëzimit, apo nga monitorimi i pagesave financiare, pavarësisht se referuar Rregullores dhe Kontratës së Binjakëzimit, CFCU është autoriteti mbikqyrës për monitorim të kontratës.

*(Më hollësisht trajtuar në Drejtimin 2, faqe 34-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**12.1. Rekomandimi:** CFCU të marrë masa për monitorimin e plotë të aktiviteteve të përcaktuara në kontratë dhe në planet Roll Up, duke evidentuar qartësisht ndikimin e ndryshimeve të objektivave apo planeve përgjatë kohëzgjatjes së kontratës, si dhe plotësimin e dosjeve me të gjithë dokumentacionin justifikues të nevojshëm dhe të domosdoshëm.

*Në vijimësi*

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me kontrollet “on the spot”, u konstatua se sa i takon planit të vitit 2021, vizitat janë kryer, por referuar shpjegimeve, në 5 raste janë shtyrë datat e vizitave, një vizitë nuk është kryer për arsye shëndetësore të stafit të OJQ-së,

por është kërkuar informacion përmes email, dhe në 4 raste vizitat nuk janë kryer në terren, por në ambientet e CFCU për shkak të çështjeve logjistike.

Konstatohet se përgjatë vitit 2021, nuk janë realizuar praktikisht kontrollet në vend (“on the spot”) për të gjitha kontratat e parashikuara, pasi në 4 raste janë kryer takime pranë ambienteve të CFCU, duke mos mundur kontrollin fizik në terren të ambienteve dhe dokumentacionit, por duke u kufizuar në takime ku dokumentacioni limitohet në atë çka mund të sjellë vetë organizata përkatëse që po zbaton kontratën e grantit. Për më tepër, plotësimi i checklistave në rastet kur nuk ka kontroll në terren, por takim në zyrë, nuk përfshin në mënyrë të plotë dhe shteruese kontrollin në të gjithë konceptin e tij. Gjithashtu, për një takim në zyrë për kontratën “Mbështetje e organizatave të shoqërisë civile dhe përfaqësuesve të palëve të interesit me rekorde në mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin të mbetjeve” me përfitues SH.Q.S.N.NJ.N Fushë-Arrëz nuk ka plotësim të checklistës, por vetëm minuta takimi.

Përgjatë kontrolleve “on the spot” ka patur përdorim të checklistave të përditësuara sipas versionit nr. 3 të Manualit të Brendshëm të Procedurave të CFCU, edhe pse nuk janë miratuar zyrtarisht nga NAO, me argumentimin nga CFCU se janë përdorur për përmirësimin e vijueshëm të punës. Në mënyrë të përmbledhur nga dokumentacioni i kontrolleve “on the spot” përgjatë vitit 2021, janë evidentuar mosrakovime përgjatë dokumentit, pasi në disa raste sipas check-listave janë evidentuar vonesa në implementim apo mangësi të ndryshme, ndërsa përgjatë konkluzionit përcaktohet se nëse vijohet me implementimin në kohë, ecuria do të jetë e mirë.

Për vitin 2022 ishin parashikuar 23 vizita nga të cilat 3 vizita u vendosën të mos kryheshin, 2 vizita u kryen jashtë afatit. Gjithashtu nuk janë pjesë e dosjes kontrollet e kryera në 4 prej kontratave.

Në vitin 2023 vihet re se ishin parashikuar 8 vizita on-site nga të cilat 4 u performuan sipas planifikimit (pra 50% e planit). Arsye për mosrealizimin e vizitave ishin: përfshirje gabimisht si pjesë e planit, hyrjes me vonesë të mendimit të kontratës, për shkak të ngarkesës së punës dhe mungesës së stafit në sektorin e monitorimit.

Përsa i takon 6 mujorit të parë të vitit 2024, rezultojnë se janë parashikuar 5 vizita për 4 kontrata nën programet IPA 2014, IPA 2019 dhe IPA 2020, ku 3 kontrata janë kontrata granti dhe një kontratë është kontratë shërbimi. Duke qenë se viti 2024, mbulon vetëm 6 mujorin e parë të tij si periudhë objekt auditimi, nuk ka patur raport vjetor kontrolli lidhur me vizitat e kryera, megjithatë për vizitat e planifikuara përpara muajit Qershor 2024 (3 vizita të planifikuara në Mars dhe Maj-Qershor) nuk është paraqitur dokumentacion vërtetues mbi kryerjen e tyre pranë grupit të auditimit.

Për sa më sipër, rezultojnë se kontrolli nuk është ezauruar në konceptin e plotë dhe shterues të tij përgjatë periudhës objekt auditimi lidhur me kontrollet “on the spot” të kryera për kontratat e granteve/shërbimeve.

*(Më hollësisht trajtuar në Drejtimin 2, faqe 34-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**13.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Monitorimit pranë CFCU, të marrë masa për kryerjen e kontrolleve “on the spot” në mënyrë të plotë dhe pranë ambienteve përkatëse në terren, me qëllim garantimin e një kontrolli shterues i cili do të përmirësonte në tërësi monitorimin e ecurisë së kontratave dhe do të shërbente si indicie për evidentimin e problematikave apo mangësive të mundshme përgjatë implementimit.

*Në vijimësi*

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i trajnimeve të vijueshme për rritjen dhe forcimin e kapaciteteve të stafit të punësuar pranë CFCU, për punonjësit e Drejtorisë së Menaxhimit të Prokurimeve dhe Kontraktiveve për fondet e BE-së, rezultojnë se përgjatë vitit 2021 janë realizuar

9 trajnime: 6 trajnime të ofruara nga ASPA dhe 3 trajnime të ofruara nga TA, ku në total janë trajnuar 20 punonjës.

Për vitin 2022, janë realizuar 10 trajnime: 5 trajnime ofruar nga ASPA, 1 trajnim ofruar nga GIZ, 3 trajnime ofruar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe 1 trajnim ofruar nga Ministria e Brendshme, ku janë trajnuar 8 punonjës.

Për vitin 2023, janë realizuar 6 trajnime: 2 trajnime ofruar nga TAIEX, 2 trajnime nga COWI & Expertise Advisors, 1 trajnim nga GIZ, 1 trajnim nga IPA, ku janë trajnuar gjithsej 21 punonjës.

Për 6 mujorin e parë të vitit 2024, janë realizuar 4 trajnime nga Bashkëpunimi Rajonal për Integrimin në Bashkimin Evropian, implementuar nga WYG Consulting LTD and GIZ GmbH, ku janë trajnuar 5 punonjës.

Referuar të gjitha problematikave/mangësi të evidentuara në monitorimin e implementimit të kontratave deri në pagesën e tyre, pavarësisht trajnimeve dhe pjesëmarrja e stafit të realizuara gjatë viteve, evidentohet nevoja e trajnimeve të vazhdueshme për stafin e Drejtorisë, me qëllim forcimin e kapaciteteve në ndjekjen e procedurave përkatëse në trajtimin, monitorimin dhe kontrollin e projekteve.

*(Më hollësisht trajtuar në Drejtimin 2, faqe 34-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**14.1. Rekomandimi:** CFCU të marrë masa për kryerjen në vijimësi të trajnimeve kombëtare dhe ndërkombëtare për stafin lidhur me tematikat e procedurave të tenderimit dhe monitorimit të kontratës për fondet IPA, me qëllim rritjen dhe forcimin e kapaciteteve të stafit të angazhuar në këto procedura.

*Në vijimësi*

**15. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, sa i takon miratimit të raporteve narrative, në rastet e granteve të përzgjedhura për tu audituar, miratimi nga njësia IPA (MEPJ) i raportit përfundimtar narrativ, nuk është shoqëruar bashkëngjitur shkresës përcjellëse, duke operuar kështu jo në përputhje me nenin 7, pika d të Marrëveshjes Operacionale IPA II midis NIPAC, Njesisë IPA dhe CFCU e cila përcakton se “Njësitë IPA në Ministrinë e Linjës/Autoritetet Përfituese do të kenë përgjegjësinë për kryerjen e detyrave të mëposhtme: ... miratimin e raporteve të kontraktorëve/përfituesve të granteve (“lexuar dhe miratuar”) dhe nënshkrimin e fletëve kohore të dorëzuar nga ekspertët e kontraktorëve brenda afateve të përcaktuara nga CFCU. ... Miratimin dhe nënshkrimin e pranimit paraprak dhe atij final. ...”

*(Më hollësisht trajtuar në Drejtimin 2, faqe 34-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**15.1 Rekomandim:** Nga CFCU të merren masa për të siguruar se procesi i miratimit të raporteve narrative është në përputhje të plotë me kërkesat e Marrëveshjes Operacionale IPA II dhe çdo parregullsi të identifikohet dhe korrigjohet në kohë, me qëllim rritjen e transparencës dhe efikasitetit në menaxhimin e granteve si dhe sigurimin e përputhshmërisë së plotë me kërkesat e legjislacionit dhe marrëveshjeve ndërkombëtare.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**16. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se për shkak të vonesave në procedurat e aprovimit të raporteve finale narrative, si rezultat i pezullimeve nga ana e CFCU përpara miratimit të vlerave financiare të njohura, periudha për të cilën ishte planifikuar pagesa shtyhet për vitin e ardhshëm, duke sjellë si pasojë:

- Thyerjen e afateve të pagesave kontraktuale, për shkak të ndryshimit në kohën e miratimit të raporteve narrative, krahasuar me kushtet/afatet kohore të paracaktuara në kontratë.

- Mosrealizim të fondeve të TVSH-së për vitin sipas së cilit janë buxhetuar, për rastet kur këto pagesa nuk realizohen sipas planifikimit të duhur, duke mos mundësuar rialokimin e fondeve të për pagesa apo investime të tjera.

*(Më hollësisht trajtuar në Drejtimin 2, faqe 34-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**16.1 Rekomandim:** Nga CFCU të merren masa që të zhvillohet një mekanizëm për të siguruar menaxhimin më me efikasitet të tyre, duke shmangur mos realizimin e fondeve të planifikuara për TVSH dhe mundësuar përdorimin e tyre për pagesa dhe investime të tjera brenda periudhës buxhetore.

**16.2 Rekomandim:** Të mbahet korrespondencë e vazhdueshme me përfituesit në mënyrë të tillë që të shmanget plotësim i pjesshëm i dokumentacionit mbështetës, që rrjedhimisht çon në ndërprerje/pezullime.

*Në vijimësi*

**17. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi pagesat e kryera (parafinancim dhe financim final) rezulton se, në 5 (pesë) nga 10 (dhjetë) rastet e përzgjedhura (të cilat kishin përfunduar pagesat në të dy fazat), vlera e kërkuar për pagesë finale nga ana e përfituesit ishte më e vogël se sa ajo e parashikuar në kontratë. Në asnjë rast nuk rezultonte prania e një analize apo argumentimi të identifikimit të shkaqeve të kërimit të këtyre vlerave më të ulëta.

- Nga ana e sektorit për monitorimin e kontratave, si strukturë përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të kontratave dhe ndjekjen rregullisht të zbatimit të tyre, nuk rezulton të jetë kryer një analizë / apo vlerësim mbi impaktin në outputin final, se si është arritur ai, në zbatim dhe reflektim të ndryshimeve të ndodhura krahasuar me zërat e parashikuar. Përthithja më pak nga kontraktimi, mbart në vetvete riskun e mos kryerjes së plotë të aktiviteteve sikundër parashikuar.

*(Më hollësisht trajtuar në Drejtimin 2, faqe 34-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**17.1 Rekomandim:** Sektori i monitorimit të implementimit pranë CFCU të marrë masat për një vlerësim të vazhdueshëm dhe të rregullt të impaktit që mund të ketë ndryshimi i vlerës së pagesës finale mbi zbatimin e aktiviteteve dhe arritjen e outputeve të parashikuara. Ky vlerësim duhet të përfshijë edhe një reflektim të mundshëm për ndryshimet në zërat buxhetorë dhe sigurimin që aktivitetet janë kryer në përputhje me kontratën.

**17.2 Rekomandim:** Nga ana e CFCU të zhvillohet një mekanizëm për menaxhimin e riskut që lidhet me mundësinë e mos realizimit të aktiviteteve të parashikuara në kontratë, në rastet kur kërkohet një pagesë më e ulët se ajo e parashikuar.

**17.3 Rekomandim:** Nga ana e CFCU të sigurohet që çdo ndryshim në vlerën e kërkuar për pagesë të dokumentohet dhe të jetë i qartë për të gjitha palët e përfshira, duke përfshirë një përshtatje të plotë të arsytimit për uljen e vlerës.

*Në vijimësi*

**18. Gjetje nga auditimi:** Në 1 (një) rast nga 10 (dhjetë) rastet e përzgjedhura për tu audituar rezultoi se, nga ana e CFCU-së është miratuar përdorimi i Fondit të Kontigjencës, fond i cili është përdorur për të mbuluar kostot shtesë të fluturimit të RTA drejt vendit përfitues për shkak të ndryshimit të çmimit të biletave, konkretisht për projektin AL 20 IPA JH 01 21 ( Mbështetje ndaj Avokatit të Popullit për promovimin e të drejtave të Njeriut në Shqipëri, me institucion përfitues Avokati i Popullit). Fondi i kontigjencës është një rezervë financiare që përdoret për të përballuar ngjarje të papritura, shpenzime të paplanifikuara, ose situata emergjente që kërkojnë financim të menjëhershëm, pra fonde të destinuar për t'u përdorur në rrethana specifike dhe emergjente, dhe nuk janë të përshtatshme për financimin e shpenzimeve të zakonshme ose operacioneve rutinë që nuk lidhen me situata kritike.

Veprimet e mësipërme në kundërshtim me twinning Manual, paragrafi 6.2.10 dhe 6.1.2 dhe 2.4

*(Më hollësisht trajtuar në Drejtimin 2, faqe 34-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**18.1 Rekomandim:** Nga ana e CFCU, të merren masa për të siguruar që çdo përdorim i fondeve të kontigjencës të miratohet dhe të zbatohet në përputhje me kërkesat e Twinning Manual,

veçanërisht për sa i përket justifikimit dhe procedurave të miratimit të kostove shtesë, në mënyrë të tillë që të jetë tërësisht i justifikuar dhe në përputhje me rregullat dhe parimet e caktuara.

*Në vijimësi*

**19. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se për dy projekte ka ndryshim të projekt menaxherit të drejtorisë së menaxhimit të fondeve të BE, konkretisht:

- Për kontratën IPA 2017/AL/6 (projekti “CSO si avokat për implementimin e legjislacionit mjedisor horizontal në nivel lokal-Vlorë”, me institucion përfitues ICLA është ndryshuar 3 (tre) herë, për intervalin kohor 31.03.2021 deri më 11.04.2022.

- Për projektin “ECO friends - miqtë e mjedisit dhe klimës operative”, me përfitues COSPE, është ndryshuar 2 (dy) herë, për intervalin kohor 31.03.2021 deri më 25.06.2021.

Këto ndryshime riskojnë realizimin e suksesshëm të projekteve dhe përdorimin e fondeve në mënyrë efektive, kjo pasi ndryshimi i shpeshtë mund të shkaktojë humbje të vazhdimësisë në menaxhimin e projekteve dhe në koordinimin ndërmjet palëve të përfshira; humbje të njohurive dhe eksperiencës të grumbulluar nga menaxherët e mëparshëm, si dhe vonesa në ekzekutimin e aktiviteteve të projektit, për shkak të nevojës për kohë për t'u njohur me projektin dhe përshtatur procedurat dhe planifikimet e mëparshme.

*(Më hollësisht trajtuar në Drejtimin 2, faqe 34-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**19.1 Rekomandimi:** Nga ana e CFCU për rastet kur ndryshimi është i paevitueshëm të merren masa për të minimizuar ndikimet negative të këtyre ndryshimeve, duke mbajtur në konsideratë hartimin e një plani të detajuar të kalimit, sigurimin e dokumentimit të plotë të aktivitetit, dhe minimizuar rreziqet e mundshme që lidhen me ndryshimin e shpeshtë të menaxherit.

*Në vijimësi*

**20. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, në 2 (dy) nga 8 (tetë) rastet e përzgjedhura për t'u audituar (përfunduar cikli i plotë i pagesave) transferta bankare është kryer më vonë nga afati i paracaktuar prej Fondit Monetar në shkresën e aprovimit, duke bërë që fondet të mbahen në llogari për më tepër se 24 orë dhe rritur kështu riskun e krijimit të interesave, sa më sipër në kundërshtim me Marrëveshjen e Implementimit mes NIPAC, NAO dhe CFCU neni 16 pika 4 që specifikon kryerjen e transaksionit brenda ditës së gjenerimit të fondeve në llogarinë bankare.

*(Më hollësisht trajtuar në Drejtimin 2, faqe 34-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**20.1 Rekomandimi:** Nga ana e CFCU të merren masa që transfertat bankare të kryhen në kohë reale (sipas parimit just in time) me qëllim shmangien e riskut të krijimit të interesave të panevojshëm në llogari bankare dhe përdorimin e këtyre vlerave për alokim në aktivitete të tjera të projektit.

*Menjëherë*

**21. Gjetje nga auditimi:** Nga krahasimi i vlerave të parashikuara nga CFCU mbi nivelin e pagesave në nivel projekti dhe përlllogaritjeve të TVSH-ve respektive si dhe nivelin e realizimit të pagesave faktike për TVSH e çdo projekti, rezultoi se:

- Planifikimi i kryer nga ana e CFCU është jo realist, kjo për vet faktin se, nga njëra anë mbështetet mbi totalin e vlerës (në parashikimin e këtyre vlerave nuk është marrë në konsideratë vlerën e zbritshme e pagesës së parafinancimit) dhe nga ana tjetër operohet në fazë të hershme, mbi një formulë matematikore që të nxjerr në vlera të përafërta.

Në kushtet kur ky parashikim do të shërbejë si informacion kryesor për Drejtorinë e Fondit Kombëtar për të përcaktuar vlerat e fondeve të TVSH-së për fondet IPA, të cilat duhet të përfshihen në buxhetet përkatëse të institucioneve përfituese të projekteve, planifikimi jo realist në nivele disa herë më të larta se realizimi faktik, ndikon në djegie të fondeve të dedikuara për TVSH-në në

buxhetet përkatëse; (AL 20 IPA JH 01 21 projekti me emër "Mbështetje për Zyrën e Avokatit të Popullit dhe promovimin e të drejtave të njeriut në Shqipëri" me përfitues Avokatin e Popullit, parashikim në kundravajtje ligjore ku vlera e kërkuar është afërsisht 8% e asaj të parashikuar dhe No. AL/IPA2019/1 me projekt "BE për mësimdhënien gjithëpërfshirëse" kontraktor F.SH.A.SH Shqipërinë dhe përfitues Ministrinë e Arsimit ku vlera e kërkuar dhe paguar është afërsisht 15% e vlerës së parashikuar).

*(Më hollësisht trajtuar në Drejtimin 2, faqe 34-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**21.1 Rekomandimi:** Nga ana e CFCU, përkatësisht Sektori i Menaxhimit Financiar të marrë masa për kryerjen e përlogaritjeve sa më reale mbi vlerën e pagesave të kontratave, në mënyrë që të shmangët praktika e përfshirjes në pagesat e ndërmjetme edhe e vlerës së parapagesës që duhet të zbritet në faturat e periudhës objekt planifikimi, me qëllim kryerjen e një procesi sa më real të planifikimit të pagesave të TVSH krahasuar me realizimin faktik të tyre.

*Në vijimësi*

**22. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi problematikë mbi parashikimin dhe më tej miratimin e vlerës së TVSH-së për kontratat e binjakëzimit.

- Së pari nga ana e CFCU është operuar me parashikim të vlerës së TVSH-së për kontratat tip *twinning* ose *twinning light*, në kundërshtim me Manualin e Binjakëzimit ku në Manualin e Binjakëzimit nuk është parashikuar pagesë TVSH-je për *Twinning Contract* (AL 20 IPA JH 01 21, CSO si avokat për implementimin e legjislacionit mjedisor horizontal në nivel lokal-Vlorë, me institucion përfitues ICLA.

- Së dyti, nga ana e CFCU është aprovuar rimbursimi i vlerës së TVSH-së (projekti AL 20 IPA JH 01 21 me vlerë TVSH 852.44 Euro) në kushte jo të drejta, në kundërshtim të Manualit të Binjakëzimit, referuar kontratës mes palëve, kushteve të përgjithshme të saj, neni 6.2.15 parashtron se "...kostot indirekte mbultojnë 6% të shpenzimeve totale të eligible cost ndërkohë neni 6.2.1 Shënime të përgjithshme parashtron se ... Detyrimet, taksat dhe tarifatat përfshirë TVSH-në nuk janë të pranueshme sipas Kontratës së Grantit *Twinning*...".

*(Më hollësisht trajtuar në Drejtimin 2, faqe 34-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**22.1 Rekomandimi:** Nga ana e CFCU të merren masa që mbi planifikimin e vlerave të TVSH-së, të përmbushen në mënyrë të plotë kërkesat e Manualit të Binjakëzimit, ku çdo parashikim i TVSH-së për kontratat "*twinning*" dhe "*twinning light*" duhet të bëhet në përputhje të plotë me dispozitat e Manualit, i cili nuk parashikon pagesë TVSH-je për këto tipologji të kontratave.

*Në vijimësi*

## **B. MASA PËR ELIMINIMIN E PALIGJSHMËRIVE NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se për projektin "Peripatetic advisor to provide on-job regulatory and supervisory support and guidance to AFSA", me përfitues AMF, janë ndërprerë dy kontrata të një pas njëshme pa realizuar detyrat e përcaktuara nga donatori për të marrë produktin përfundimtar nga përfituesi, i cili në këtë projekt është AMF, për të cilat është kryer likuidimi pas konfirmimit të marrjes së produktit të fazës së parë, sipas kushteve të kontratës për vlerën totale në shumat 10,051 \$ dhe 23,272 Euro. Duke u nisur nga vetë natyra e kontratës dhe shërbimit që do të përfitohet, detyrat e përcaktuara nëse nuk realizohen në tërësi, konsiderohen të paimplementueshme duke çuar dështimin e përfitimit të produktit final. Nga sa më sipër rezulton se CFCU, si institucion përgjegjës për monitorimin dhe realizimin e projektit, nuk ka parashikuar



në kushtet e kontratës, seksionin e penaliteteve për mosrealizimin e kontratës sipas të gjitha përcaktimeve të saj, dhe kjo ka sjellë **shpenzime pa efektivitet në shumën totale prej 10,051 \$ dhe 23,272 Euro.**

*(Më hollësisht trajtuar në Drejtimin 1, faqe 20-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1 Rekomandimi:** CFCU të marrë masa të përfshijë në të gjitha kontratat një seksion specifik që parashikon penalitete për mosrealizimin e detyrave dhe objektivave të kontratës sipas kushteve të përcaktuara, të cilat të jenë të qarta, proporcionale dhe lehtësisht të zbatueshme, duke vendosur që likuidimet për fazat e mëparshme të jenë të kushtëzuara nga përmbushja e plotë e detyrave të mëparshme dhe aprovimi i përmbajtjes së tyre nga donatori dhe përfituesi. CFCU të kryejë një analizë të plotë për të identifikuar arsyet e mosrealizimit të objektivave të kontratave dhe të zbatojë masa për të shmangur raste të ngjashme në të ardhmen.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**1.2 Rekomandimi:** CFCU të marrë masat për shqyrtimin e problematikave të trajtuar më sipër dhe mundësisë ligjore për vlerësimin e efektivitetit të përdorimit të fondeve në vlerën 10,051 \$ dhe 23,272 Euro.

*Brenda 3 muajve*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se për projektin “Internacional Consultancy Firm to provide training services on capital market regulations” dhe projektin “Strengthening AFSA’S regulatory and supervisory function and Support in its Capital Market Development Efforts”, me përfitues AMF, në nenin 3. “Payment” të kontratës është parashikuar se klienti do t’i paguajë konsulentit për këtë shërbim shumën e cila nuk duhet të kalojë 72,030 \$, ku në këtë shumë do përfshihen të gjitha kostot dhe fitimet e konsulentit si dhe çdo detyrim tatimor që mund t’i lindë konsulentit. Nga auditimi rezulton se CFCU nuk ka bërë ndalesën e shumës së TVSH-së nga klienti, por e ka paguar jashtë vlerës së parashikuar në këtë kontratë, **duke sjellë shpenzime pa efektivitet në shumën totale prej 14,436 \$.**

*(Më hollësisht trajtuar në Drejtimin 1, faqe 20-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1 Rekomandimi:** CFCU të ndjekë me rigozitet përcaktimet e kontratave, duke siguruar që çdo pagesë të jetë brenda kufijve të parashikuar dhe të përfshijë të gjitha detyrimet, përfshirë tatimet dhe TVSH-në. CFCU duhet të krijojë dhe zbatojë një procedurë standarde për të siguruar që ndalesat tatimore dhe përfshirja e TVSH-së të llogariten dhe zbatohen siç duhet përpara kryerjes së pagesave.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**2.2 Rekomandimi:** CFCU të marrë masat për shqyrtimin e problematikave të trajtuar lidhur me ndalesën e shumës së TVSH-së nga klienti trajtuar sa më sipër dhe mundësisë ligjore për vlerësimin e efektivitetit të përdorimit të fondeve në vlerën prej 14,436 \$ që është paguar jashtë parashikimeve të kontratës.

*Brenda 3 muajve*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi pagesën e kryer për efekt të projektit AI/IPA2017/06 (CSO si avokat për implementimin e legjislacionit mjedisor horizontal në nivel lokal-Vlorë, me institucion përfitues I.N.L.SH) rezultoi se:

- Në 9 (nëntë) raste në zëra përbërës të buxhetit u konstatua tejkalim i vlerës krahasuar buxhetit fillestar, në total vlera e validuar është më e vogël se vlera e parashikuar në buxhet. Në vijim të konstatimit, nga ana e përfituesit nuk rezulton të jetë argumentuar nevoja për rialokim në moszbatim me pikën 2.1.5 të Manualit PRAG.

- Referuar raportit financiar, rezulton se linja buxhetore 5.7.5.2 e cila lidhet me aktivitetin 3.2.2 ka rezultuar me kursim në nivelin 83.3% apo në terma absolute 1,000 Euro kjo për shkak se aktiviteti nuk është kryer nga personi i kontraktuar por grupi punës.

- Nga ana e CFCU është kryer pagesa e ekspertit për 7 ditë pune megjithëse largimi i tij ka thyer kontratën e lidhur mes palëve. Neni 6 i kontratës parashikon se: “... *Pagesa do të kryhet bazuar në kërkesën për pagesë nga eksperti (kërkesa datë 22.06.2022) pasi të jetë ofruar shërbimi kontraktuar*”, proces i cili nuk ka ndodhur e nga ana e CFCU.

- Nga auditimi i dosjes rezultoi përdorimi i fondeve për mbështetje dhe zhvillimin të këtij projekti **pa efektivitet në vlerën 1,000 Euro.**

*(Më hollësisht trajtuar në Drejtimin 2, faqe 34-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1 Rekomandimi:** CFCU të marrë masa të kryejë një analizë të plotë për të identifikuar arsyet e mosrealizimit të objektivave të kontratave dhe të zbatojë masa për të shmangur raste të ngjashme në të ardhmen.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**3.2 Rekomandimi:** CFCU të marrë masat për shqyrtimin e problematikave të trajtuar më sipër dhe mundësisë ligjore për vlerësimin e efektivitetit të përdorimit të fondeve në vlerën prej 1,000 Euro.

*Brenda 3 muajve*

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi dokumentacionin mbështetës të pagesave të kryera për efekt të projekteve IPA2017/AL/6 (projekti “CSO si avokat për implementimin e legjislacionit mjedisor horizontal në nivel lokal-Vlorë”, me institucion përfitues ICLA dhe AL/IPA2017/8, me institucion përfitues COSPE, rezultoi se dokumentacioni justifikues i kryerjes së aktiviteteve është i pjesshëm si dhe në mospërputhje me deklaratat e paraqitura në “letrat e punës” të kryqëzuara mes eksperteve respektiv dhe grupit të punës.

- Për projektin IPA 2017/AL/6 projekti “CSO si avokat për implementimin e legjislacionit mjedisor horizontal në nivel lokal-Vlorë”, me institucion përfitues ICLA në buxhet ishte kryer parashikim në dy linja buxhetore me vlerë totale 2,400 Euro dhe kontraktimi i ekspertëve për 2 (dy) aktivitete të ndryshme ku në realizimin faktik të dy këto linja ishin bashkuar në një me vlerë të validuar 1,000 Euro.

- Për projektin “ECO friends miqtë e mjedisit dhe klimës operative”, me institucion përfitues COSPE në buxhetin fillestar ishte kryer parashikim në dy linja buxhetore kontraktimi i ekspertëve lokalë për 2 (dy) aktivitete të ndryshme ndërkohë, në buxhetin e amenduar janë buxhetuar dy nënlinja të njëjta për aktivitete të ndryshme.

Referuar analizës financiare të vënë në dispozicion nga CFCU, lidhur me këto tri linja, rezulton se në total vlera e buxhetuar pas amendimit rezulton në 12,943.6 Euro dhe vlera e validuar rezulton në 8,625.25 Euro.

Për sa më sipër, nga këto dy projekte, gjykohet se nga CFCU nuk është shqyrtuar **efektiviteti i përdorimit të fondeve në vlerën totale prej 9,625.22 Euro**, vlerë e cila nuk rezulton të jetë justifikuar me dokumentacion të plotë vërtetues për kryerjen e aktiviteteve.

*(Më hollësisht trajtuar në Drejtimin 2, faqe 34-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1 Rekomandimi:** Nga CFCU në bashkëpunim me përfituesit e granteve me të merren masa që pagesat të bëhen vetëm pasi shërbimi i kontraktuar të jetë ofruar plotësisht, duke përfshirë verifikimin e shërbimeve të ofruara përpara kryerjes së pagesës, me qëllim sigurimin e transparencës dhe minimizimin e riskut të abuzimeve dhe gabimeve në menaxhimin e fondeve.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**4.2 Rekomandimi:** CFCU të marrë masat për shqyrtimin e problematikave të trajtuar më sipër dhe mundësisë ligjore për vlerësimin e efektivitetit të përdorimit të fondeve në vlerën prej 9,625.22 Euro.

*Brenda 3 muajve*

## **C. MASA DISIPLINORE**

### **C.1 Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil.**

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, gjerat “b”, “c” dhe “ç”; bazuar në nenin 57, 58 dhe 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” të ndryshuar, si dhe në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandohet Titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve për fondet e BE, BB dhe donatorëve të tjerë vlerësimi i problematikave dhe shkeljeve të përshkruara në mënyrë të detajuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe të nisin procedurat për dhënien e masave disiplinore nga “Vërejtje” deri “Largim nga shërbimi civil”, për të gjithë punonjësit e konstatuar me përgjegjësi sipas çështjeve të trajtuara.

## **D. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL**

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Drejtoria e Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve për fondet e BE, BB dhe donatorëve të tjerë, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

- a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.
- b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

Për sa më sipër, paraqitet ky Raport Përfundimtar i Auditimit.

## **KONTROLI I LARTË I SHTETIT**